

KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel 12.10 2011

SEC (2011) 1203

DOKUMENT PUNE I SHËRBIMEVE TË KOMISIONIT

RAPORT I PROGRESIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË

VITIN 2011

në shtojcë të

**KUMTESËS SË KOMISIONIT PËR
PARLAMENTIN EVROPIAN DHE PËR
KËSHILLIN**

Strategjia për zgjerim dhe sfidat kryesore 2011-2012

{KOM(2011) 666}

Sekretariati për Çështje Evropiane intervevoi në tekst, duke e zëvendësuar referencën "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" me emrin kushtetues "Republika e Maqedonisë".

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
1.1 PARATHËNIE	3
1.2.KONTEKSTI.....	3
1.3.MARRËDHËNIET MES BE-SË DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	3
2. KRITERET POLITIKE	5
2.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I SË DREJTËS	5
2.2.TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTA E PAKICAVE.....	13
2.3.ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE	19
3. KRITERET EKONOMIKE.....	21
3.1. EKZISTIMI I EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT	21
3.2. KAPACITETI PËR BALLAFAQIM ME PRESIONIN KONKURRUES DHE FORCAT E TREGUT NË UNION.....	25
4. AFTËSIA E MARRJES SË OBLIGIMEVE NGA ANËTARËSIMI	27
4.1. KREU 1: QARKULLIMI I LIRË E MALLRAVE	27
4.2. KAPITULLI 2: QARKULLIMI I LIRË E PUNËTORËVE	29
4.3. KAPITULLI 3: E DREJTA E THEMELIMIT DHE LIRIA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE	29
4.4. KREU 4 QARKULLIMI I LIRË E KAPITALIT	30
4.5. KREU 5 FURNIZIME PUBLIKE	31
4.6. KREU 6: E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE.....	32
4.7. KREU 7 E DREJTA E PRONËSISË INTELLEKTUALE.....	33
4.8. KREU 8 POLITIKA E KONKURENCËS	34
4.9. KREU 9 SHËRBIMET FINANCIARE	35
4.10. KREU 10: SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIET.....	36
4.11. KREU 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL	37
4.12. KREU 12 SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE.....	39
4.13. KREU 13: PESHKATARIA	41
4.14. KREU 14: POLITIKA E TRANSPORTIT.....	41
4.15. KREU 15 ENERGETIKA	43
4.16. KREU 16: TATIMIMI	44
4.17. KREU 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE	45
4.18. KREU 18: STATISTIKA.....	46
4.19. KREU 19: POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI	47
4.20. KREU 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE	48
4.21. KREU 21: RRJETET TRANSEUROPIANE	49
4.22. KREU 22: POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE	50
4.23. KREU 23 GJYQËSIA DHE TË DREJTAT THEMELORE	51
4.24. KREU 24 - DREJTËSIA , LIRIA DHE SIGURIA	56
4.25. KREU 25 SHKENCA DHE HULUMTIMI.....	57
4.26. KREU 26 ARSIMI DHE KULTURA	61
4.27. KREU 27 MJEDISI JETËSOR	62
4.28. KREU 28 :MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE MBROJTJA SHËNDETËSORE.....	64
4.29. KREU 29 : UNIONI DOGANOR	65
4.29. KREU 29 : MARRËDHËNIET E JASHTME	66
4.29. KREU 29 : POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE MBROJTJES	66
4.30. KREU 30 : KONTROLLI FINANCIAR	67
4.30. KREU 30 : DISPOZITA FINANCIARE DHE BUXHETORE.....	68
ANEKSI STATISTIK	69

1. HYRJE

1.1 Parathënie

Nga marsi 2002, Komisioni rregullisht i ka informuar Këshillin dhe Parlamentin për progresin e arritur të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky raport i progresit të arritur nga Republika e Maqedonisë në përgatitjet për anëtarësim në BE, në masë të madhe, e ndjek strukturën e njëjtë, si në vitet paraprake. Raporti:

- shkurtimisht i përshkruan marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Unionit;
- e analizon situatën në Republikën e Maqedonisë lidhur me kriteret politike për anëtarësim;
- e analizon situatën në Republikën e Maqedonisë në bazë të kriterëve ekonomike për anëtarësim;
- e shqyrton kapacitetin e Republikës së Maqedonisë për përmbushjen e obligimeve nga anëtarësimi, përkatësisht nga *acquis-i* i paraqitur në marrëveshje, legjisllacionin sekondar dhe politikat e Unionit.

Ky raport e përfshin periudhën nga tetori 2010 deri në shtator 2011. Progresi matet në bazë të vendimeve të miratuara, legjisllacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Sipas rregullës, nuk janë marrë parasysh legjisllacioni ose masat që janë në përgatitje ose presin miratim nga Kuvendi. Kjo qasje siguron trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informatat e grumbulluara dhe të analizuara nga Komisioni. Gjithashtu, janë përdorur shumë burime, duke i përfshirë edhe kontributet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, vendet anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informatat nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni përpilon konkluzione të detajuara lidhur me Republikën e Maqedonisë në dokumentin e vet të veçantë për zgjerim, të bazuar në analizën teknike të përmbajtur në këtë raport.

1.2. Konteksti

Këshilli Evropian në dhjetor 2005 i ndau Republikës së Maqedonisë statusin e vendit kandidat. Marrëveshja për stabilizim dhe asocim (MSA) ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së u nënshkrua në prill 2011 dhe hyri në fuqi në prill 2004. Në shkurt 2008, Këshilli e miratoi Partneritetin për anëtarësim të vendit, që i përfshin prioritetet kryesore për reforma. Në tetor 2009, Komisioni i rekomandoi Këshillit që të fillojë negociatën me vendin, si dhe të kalojë në fazën e dytë të zbatimit të MSA-së. Këto rekomandime u përsëritën edhe në vitin 2010. Këshilli ende nuk ka marrë qëndrim lidhur me propozimet e Komisionit.

1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Republikës së Maqedonisë

Republika e Maqedonisë merr pjesë në procesin e stabilizimit dhe asocimit.

Lidhur me **Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim** (MSA) me BE-në, vendi po i realizon të gjitha obligimet e marra me Marrëveshjen, që paraqet prioritet kryesor në Partneritetin për anëtarësim, duke i përfshirë të gjitha obligimet e parapara në fazën e parë të zbatimit të Titullit V (Qarkullimi i punëtorëve, themelimi, sigurimi i shërbimeve, kapitali). Propozimi i Komisionit nga viti 2009, për kalim në fazën e dytë të asocimit, ishte objekt shqyrtimi nga Komisioni, në pajtim me nenin 5 të MSA-së

Strukturat e MSA-së vazhduan të shërbejnë si bazë për **dialog të rregullt politik dhe ekonomik**

ndërmjet BE-së dhe vendit. Nga tetori 2010, ekspertët e të dyja palëve kanë mbajtur takime së paku një herë në vit në shtatë nënkomitete dhe grup të posaçëm. Takimet e trupave të përbashkëta më të larta, gjegjësisht Komitetit për stabilizim dhe asocim dhe Këshillit për stabilizim dhe asocim, janë caktuar në vijimësi për tetor dhe dhjetor 2011. Përveç kësaj, vazhdoi dialogu multilateral ekonomik ndërmjet Komisionit, BE-së, vendeve anëtare dhe vendeve kandidatë në kontekst të mbikëqyrjes fiskale paraaderuese, duke përfshirë edhe takimin në nivel ministrash të mbajtur në maj në Bruksel. Këto takime janë të fokusuar në sfidat kryesore të vendosura me kriteret politike dhe ekonomike të Kopenhagës dhe në shqyrtimin e progresit të arritur për përmbushjen e prioritetëve të Partneritetit për anëtarësim.

BE-ja u siguroi autoriteteve udhëzime për prioritetet e reformave nëpërmjet Partneritetit për anëtarësim nga shkurti 2008. Progresi i këtyre prioritetëve të reformave stimulohet dhe mbikëqyret përmes trupave të themeluara në kuadër të MSA-së. Në bazë të Partneritetit për anëtarësim dhe Raportit të progresit për vitin 2010, Qeveria në dhjetor 2010 e miratoi Programin e reviduar vjetor nacional për miratimin e acquis-it. **Liberalizimi i vizave** për qytetarët të cilët udhëtojnë në zonën e Shengenit hyri në fuqi më 19 dhjetor 2009. Rregullat për regjim pa viza respektohen nga shumica e udhëtarëve. Me qëllim që të sigurohet realizim i vazhdueshëm i obligimeve, u themelua mekanizmi për ndjekjen e gjendjes pas liberalizimit të vizave, në aspekt të rritjes së numrit të personave të cilët kërkojnë azil nga rajoni. Në qershor 2011, Komisioni ia prezantoi raportin e parë për ndjekjen Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Në janar 2008, hyri në fuqi marrëveshja për readmision me Bashkimin Evropian.

Ndihma Financiare u siguroi përmes Instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA). Në vitin 2011, menaxhimi me IPA-n u decentralizua autoritete vendore. Dokumenti shumëvjeçar për planifikim indikativ për vitet 2011-2013 siguron kontribut të përgjithshëm prej 305 milionë eurosh dhe sjellë qasje të bazuar në sektor. Përveç kësaj, vendet vazhdojnë të kenë dobi nga programet e ndryshme rajonale dhe horizontale. Bashkëpunimi tejkuftar, gjithashtu shfrytëzohet për avancimin e ndërtimit të kapaciteteve dhe dialogut ndërmjet autoriteteve lokale dhe rajonale të vendeve fqinje, gjegjësisht Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Kosovës.

Nga viti 2007, Komisioni ndau shumë prej mëse 288 milionë euro për realizimin e projekteve në vend, duke përfshirë edhe 92 milionë euro në vitin 2010. Portofoli me ndihmë financiare nga BE-ja me të cilin menaxhon Delegacioni i BE-së në Shkup, është 115 milionë euro. Deri më qershor 2011, 85% nga kjo shumë e përgjithshme janë lidhur në marrëveshje, ndërsa më tepër se nga 60% u paguan. Kjo ndihmë fokusohet në përforcimin e kapacitetit administrativ me theks të veçantë në sektorin e sundimit të së drejtës dhe sektorët e administratës publike, reformat tatimore dhe doganore, përmirësimi i infrastrukturës lokale për zhvillim socio-ekonomik, si dhe aftësinë për përmbushjen e obligimeve nga anëtarësimi në BE. Përveç kësaj, është përkrahur realizimi i Strategjisë nacionale dhe Planit aksional të dekadës për inkluzionin e romëve dhe i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Në kontekst të paraadimit, BE-ja tanimë e ka bartur menaxhimin me katër prej pesë komponentëve të IPA-s dhe autoriteteve nacionale sipas sistemit të decentralizuar për realizim (DIS). Akoma nevojitet adaptimi i mëtejshëm i sistemeve për menaxhim dhe kontroll me qëllim që të sigurohet kualitet më i lartë i standardeve gjatë realizimit të kësaj përgjegjësie.

Shoqëria qytetare mori përkrahje të madhe financiare nga BE-ja në kuadër të IPA-s për ndihmë të shoqërisë qytetare dhe programeve nacionale, si dhe nëpërmjet Instrumentit evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut. Qëllimi i ndihmës, përfshin inkluzion më të madh të shoqërisë qytetare në miratimin e vendimeve dhe rritje të kapacitetit të organizatave të pavarura të shoqërisë qytetare. Programet nacionale të cilat realizohen për momentin sigurojnë përkrahje të konsiderueshme për përmirësimin e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë qytetare.

dhe për ndërtimin e mëtejshme të kapaciteteve të seksionit të Qeverisë për bashkëpunim me OJQ-të. Sipas DIS-it, shoqëria qytetare mund të fillojë të përfshihet në ndjekjen e realizimit të plotë të ndihmës nga BE-ja.

Republika e Maqedonisë merr pjesë në këto **programe të BE-së**: "Programi për sipërmarrësi dhe inovacione" (PSI) nga "Programi kornizë për konkurrencë dhe inovacione", "Programi i shtatë kornizë për hulumtim", "Përparimi", "Kultura", "Evropa e qytetarëve", "Fiskalis 2013" dhe "Dogana 2013".

2. Kriteret politike

Kjo nënpjesë e shqyrton progresin e arritur nga ana e Republikës së Maqedonisë në përmbushjen e kriteve politike të Kopenhagës, që presupozojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokraci, sundim të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektim dhe mbrojtje të pakicave. Gjithashtu, ndiqet bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e përfshira në procesin e zgjerimit dhe vendet anëtare, si dhe respektimi i obligimeve ndërkombëtare, siç është bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (GJNPJ).

2.1. Demokracia dhe sundimi i së drejtës

Kuvendi

Dialogu ndërmjet forcave politike, që paraqet prioritet kryesor të partneritetit për anëtarësim, u ndërpre përkohësisht me bojkotin parlamentar gjatë vitit. Kjo përfundoi me zgjedhjet e parakohshme që sollën përbërje të re parlamentare.

Kuvendi punoi deri më janar 2011 në bazë të dialogut ndërmjet partive politike. U miratuan disa ligje të rëndësishme lidhur me acquis-in e BE-së.

Komisioni për Çështje Evropiane dhe Këshilli Nacional për Eurointegritet, me të cilin kryeson opozita, vazhduan të mbajnë mbledhje të rregullta. Konkretisht, ata debatuan për Raportin e progresit të vitit 2010, Planin aksional lidhur me të dhe revizionin vjetor të Programit nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA), si dhe për zbatimin e tij. Komisioni i shqyrtoi të gjitha projekt-ligjet sipas Programit nacional për miratimin e së drejtës së BE-së.

Vazhduan përpjekjet për përforcimin e kapacitetit institucional të Kuvendit në pajtim me Ligjin për Kuvendin nga viti 2009. Më tutje u mbajtën me sukses pesë debate publike mbikëqyrëse dhe Qeveria i ka realizoi konkluzionet nga ato. Buxheti për funksionimin e Kuvendit u rrit për 40%. Kjo mundësoi krijimin e tridhjetë vendeve të përhershme të punës në kuadër të shërbimit të Kuvendit, si dhe renovimin e ndërtesës së Kuvendit.

U realizuan ndryshimet e Rregullores të miratuara në vitin 2010, të cilat kanë për qëllim përforcimin e bashkëpunimit parlamentar. E drejta e opozitës që të vendosë çështje në rend të ditës në Kuvend u vërtetua në praktikë. Të gjitha shtatë pikat e rendit të ditës të propozuara nga opozita u diskutuan në seancë plenare.

Zbatimi i Ligjit për gjuhët vazhdon më tej. Projekt-ligjet dhe propozimet tjera në Kuvend janë të përkthyer në gjuhën shqipe. Gjuha shqipe në procedurë gojore vazhdon të përdoret në komisione dhe në debate, duke përfshirë edhe kryesuesin, si dhe në seancë plenare. Kanali televiziv i Kuvendit interpretohet në gjuhën shqipe. Ndryshimet e propozuara në korrik mundësojnë që të gjithë funksionarët e zgjedhur ose emëruar nga Kuvendi të mund ta përdorin gjuhën shqipe kur e marrin fjalën në Kuvend dhe në trupat e tij.

Qasja e përmirësuar e të gjithë anëtarëve të Komisionit të Kuvendit për Marrëdhënie ndërmjet

Bashkësive mundësoi mbajtjen e tre mbledhjeve para shpërndarjes së Kuvendit.

Megjithatë, në fund të janarit, partia kryesore opozitare *Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë* (LSDM), bojkotoi Kuvendin bashkë me shumicën e partive opozitare. LSDM-ja theksoi se proteston kundër qeverisjes jodemokratike. Kjo përfshin aksionin e autoriteteve, për shkak të akuzave për fshehjen e tatimit, kundër kanalit televiziv i njohur me qëndrime kritike kundrejt qeverisë. Bojkoti vazhdoi deri në zgjedhjet e parakohshme në qershor. Me caktimin e disa takimeve të liderëve të partive politike, Presidenti i Republikës së Maqedonisë tentoi të ndërmjetësojë për zgjidhje, por pa sukses.

Koalicioni qeveritar i Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (VMRO-DPMNE) dhe Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), i cili kishte shumicën e dy të tretave dhe "Shumicën e Badenterit", kishin mundësi të vazhdojnë me miratimin e ligjeve edhe krahas bojkotit. Ndryshimet në Kushtetutë, Kodin zgjedhor dhe Ligjin për lustrim ishin në mesin e 200 akteve të miratuara pa opozitën.

Instituti parlamentar, funksioni i të cilit është që të mundësohet qasje më e mirë e të gjitha partive deri në informatat dhe analizat akoma nuk është funksional dhe personeli i tij akoma nuk është angazhuar. Kjo është shumë e rëndësishme për mundësinë e deputetëve në Kuvend që ta kryejnë rolin e tyre në mënyrë të drejtë.

Mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve për zbulim dhe kundërzbulim mbetet e dobët. Në vitin 2010, u caktua vetëm një mbledhje e Komisionit të Kuvendit. Ekziston bashkëpunim i pamjaftueshëm ndërmjet Komisionit të Kuvendit dhe Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim.

Zbatimi i ligjit për lobim vazhdon të krijojë qasje selektive në krijimin e politikave nga grupet e interesuara.

Lobimi mund të merret vetëm me ftesë të trupit ligjvënës relevant dhe lejohet për shoqëri qytetare, por jo edhe për fondacione. Derimëtani nuk është regjistruar asnjë lobist.

Komisioni anketues për incidentin në Kuvend në korrik 2010, nuk e ka kryer punën e tij para shpërndarjes së Kuvendit dhe nuk u qartësuan përgjegjësitë. Nuk u morën hapa praktikë për pengimin e dukurive të ngjashme në të ardhmen. Nuk është miratuar Kodeksi etik për deputetët në Kuvend.

Kuvendi votoi për shpërndarjen e tij më 14 prill, 34 muaj nga mandati i vet 4 vjeçar dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare u shpallën për 5 qershor. U arrit marrëveshje ndërpartiake për kodeks për sjellje gjatë zgjedhjeve. Zgjedhjet parlamentare rezultuan me fitore të tretë të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja (56 mandate deputetësh), pas së cilës vijojnë: koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja (42), BDI-ja (15), PDSH-ja (8) dhe RDK-ja (2).

Konstatimi i misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR për zgjedhjet ishte se zgjedhjet ishin konkurrencte, transparente dhe të realizuara mirë në tërë vendin. Në ditën e zgjedhjeve, votuesit kishin mundësi të votojnë lirisht, në atmosferë të qetë në zgjedhje të ndryshme dhe pluraliste të kandidatëve. U respektua edhe liria e shprehjes, qarkullimit dhe tubimit. Mediet siguruan mbulim të gjerë të fushatës, duke mundësuar që votuesit të zgjedhin në bazë të informimit. Numri i femrave të cilat ishin bartëse të listës u rrit nga gjashtë në vitin 2008 në 15 në vitin 2011. Prej gjithsej 1679 kandidatë, 34% ishin femra. Pjesëmarrja e votuesve ishte e lartë me 63%. Partitë politike në masë të madhe i pranuan rezultatet e zgjedhjeve dhe LSDM-ja u kthye në Kuvend. Disa ankesa zyrtare u parashtruan në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Pesë paditë e parashtruara në Gjykatën Administrative u hodhën poshtë.

Megjithatë, mbeten zbrazëtira dhe paqartësi, sidomos lidhur me dispozitat për ankesa, votimi jashtë vendit dhe përdorimi i resurseve të administratës. ODIHR informoi për pohimet autentike për ndarje të pamjaftueshme ndërmjet shtetit dhe partisë politike, si dhe për presionin mbi nëpunësit shtetërorë. Partitë politike kanë udhëhequr fushatë pothuajse ekskluzivisht sipas linjave etnike, duke e reflektuar polarizimin etnik të shoqërisë. Servisi publik radiodifuziv gjatë mbulimit të fushatës, në kundërshtim me obligimet ligjore dhe mandatit publik, e favorizonte Qeverinë dhe fuqishëm e kritikonte opozitën.

Disa nga rekomandimet e ODIHR nga viti 2009 u morën parasysh para zgjedhjeve. Sidomos, Kodi i ndryshuar zgjedhor mundësoi që Këshilli për radiodifuzion të mund të miratojë rregullore për sjelljen e radiodifuzorëve; rregullat për financim të fushatës u shtrënguan; procesi i numërimit u përmirësua. Kodi zgjedhor u ndryshua me shumicë të vogël dhe vetëm dy muaj para zgjedhjeve, që nuk është në përputhje me praktikën e mira. Gjithashtu, nuk u realizua rekomandimi për revizion thelbësor të Listës zgjedhore. Lista përmban më shumë se 1.8 milionë votues për popullsi prej 2.05 milionë banorë dhe mbetet brengosja se lista është stërzmadhuar. Mbeten çështjet për organizimin e votimit jashtë shtetit.

Kuvendi i ri, akoma me Qeveri teknike, miratoi me procedurë të shkurtuar ndryshimet e Ligjit për përdorimin e flamujve të bashkësive, për gjuhët, për Këshillin për radiodifuzion, për Këshillin Qjyqësor, për Këshillin e Prokurorëve Publikë dhe miratoi interpretim autentik të Ligjit për amnisti.

Në përgjithësi, ekziston progres në realizimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet ishin konkurrencte dhe të realizuara mirë në tërë shtetin. Është e nevojshme që Qeveria plotësisht t'i zbatojë konkluzionet dhe rekomandimet e misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR për zgjedhjet. Progres i caktuar është arritur në reformat e Kuvendit. Më tej vazhdoi zbatimi i Ligjit për gjuhët dhe Rregullorja, ndërsa buxheti për funksionimin e kuvendit u rrit. Megjithatë, nevojitet përforsimi i dialogut politik për zgjidhjen e problemeve në kuadër të institucioneve. Bojkoti i opozitës e pengoi funksionimin e Kuvendit.

Qeveria

Koalicioni i ri qeveritar në mënyrë aktive e çon përpara procesin e reformave lidhur me BE-në, duke i dhënë stimulim të ri atij. Zgjedhjet e parakohshme kontribuan për vonesa gjatë miratimit të masave të caktuara. Versioni i reviduar i Programit nacional për miratimin e së drejtës së BE-së (NPAA) u miratua në dhjetor 2010. Megjithatë, në NPAA nuk ka afate të caktuara, kërkesa lidhur me punësimet e reja dhe implikimet buxhetore.

Partnerët e koalicionit e miratuan ligjin e ndjeshëm për regjistrim në nëntor 2010. Pas vendimit që të mbahen zgjedhjet e parakohshme, koalicioni u morë vesh që ta prolongojë regjistrimin nga muaji prill në muajin tetor. U prolongua edhe arritja e marrëveshjes ndërmjet partnerëve të koalicionit lidhur me vendimin që ka të bëjë me përbërjen etnike të ekipeve të regjistruarëve.

Raportet në koalicion ishin në pikëpyetje, me ndërtimin e muzeut-kishë në Kalanë e Shkupit, në mjedis të përzier historik dhe etnik. Protestat kundër ndërtimit sollën në përlëshje etnike.

Koalicioni i ri qeveritar u formua menjëherë pas zgjedhjeve dhe ai dha betimin më 28 korrik. Programi qeveritar për punën 2011-2015 i ruajti prioritetet e njëjta si të qeverisë paraprake: rritja ekonomike, integrimi në BE dhe NATO, lufta kundër korrupsionit dhe krimi ekonomik, mbajtja e raporteve të mira ndëretnike në bazë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, investime në arsim dhe shkencë dhe shoqri e cila bazohet në dije.

Vazhdoi decentralizimi i pushtetit, i cili është parim themelor i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. U miratuan edhe plane aksionale për zbatimin e decentralizimit deri në vitin 2013. Edhe 5 komuna shtesë hynë në fazën e dytë dhe të fundit nga procesi i decentralizimit fiskal (duke u rritur numri deri 79 nga gjithsej 85 komuna), që siguron bartje më të konsiderueshme të kompetencave dhe menaxhimit financiar në nivel lokal. Sipas Ligjit për financimin e njësive të vetadministrimit lokal, pjesa e TVSH-së e bartur për komunat u rrit për 3.7% në vitin 2011.

Ligji për menaxhim me tokë ndërtimore u miratuar dhe hyri në fuqi në korrik 2011. Po realizohen programe për ndërtimin e kapaciteteve që të përforsohet kapaciteti i komunave në sferën e realizimit të tatimit mbi pronën, resurseve njerëzore dhe kontrollit financiar. Në tri komuna shtesë janë themeluar njësi për çështje financiare; në 52

komuna u themeluan njësi për revizion të brendshëm, ndërsa në 46 komuna tashmë funksionon revizori i brendshëm. U trajnuan mbi 1000 nëpunës shtetërorë komunalë dhe u arrit progres lidhur me zbatimin e programeve vjetore për trajnim.

Megjithatë, katër nga gjashtë komunat që mbetën në fazën e parë të procesit të decentralizimit kanë borxhe të konsiderueshme, ndërsa dy prej tyre kanë mungesë të kapacitetit për menaxhim financiar. Nevojiten përpjekje plotësuese që të përgatiten për të kaluar në fazën e dytë. Llogaritë e bllokuara edhe më tej janë problem për komunat edhe nga faza e parë edhe nga faza e dytë. Mekanizmat për menaxhim me ndryshimet e konsiderueshme në sigurimin e shërbimeve publike janë të kufizuara dhe veçanërisht komunat rurale dhe ato më të vogla janë në pozitë të pavolitshme. Disa komuna mbetën me sukses të dobët gjatë ndjekjes dhe zbatimit të grumbullimit të tatimit mbi pronën.

Megjithatë, progresi në arritjen e qëllimeve të decentralizimit duhet të përshpejtohet me stimulim nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (MVL). Ministria e Financave, gjithashtu, duhet ta përforcojë kapacitetin e vet që të zhvillojë politikë për çështjet lidhur me buxhetin e vetëqeverisjes lokale. Komiteti Ndërmintor për ndjekjen e financimit të bashkësive mbledhet jorregullisht. Ekziston mungesë e transparencës dhe koordinimit të financimit qendror për projekte në komuna, veçanërisht në aspekt të projekteve infrastrukturore.

Grykat e ngushta administrative edhe më tej e pengojnë hapjen e shkollave të reja. Shërbimet e mbrojtjes sociale edhe më tej menaxhohen nga qendra nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe ato duhet të decentralizohen fillimisht. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet kadastrës, regjistrit të qytetarëve, Drejtorisë së të Hyrave Publike dhe komunave fillimisht duhet të forcohen në suaza të sistemit unik për të dhëna.

Nevojiten përpjekje të konsiderueshme plotësuese në nivel qendror dhe lokal që të përforcohet kapaciteti administrativ i disa komunave, sidomos lidhur me çështjet për kontroll financiar, planifikim strategjik, menaxhim me resurse njerëzore dhe zhvillim ekonomik. Enti Shtetëror i Revizionit paraqiti mangësi të shumta të MVL-ja në zbatimin e standardeve për kontroll financiar dhe rregullat për furnizim, si dhe veprim të pamjaftueshëm sipas rekomandimeve paraprake.

Përgjithësisht, koalicioni qeveritar tejkaloi pengesa të caktuara dhe e përforcoi bashkëpunimin e brendshëm. Qeveria e re i dha stimulim të ri procesit të reformave lidhur me BE-në. Nevojitet stimulim më i fortë për avancimin e procesit të decentralizimit. Sidomos, korniza financiare duhet të jetë më transparente dhe më e drejtë për sigurimin e shërbimeve publike.

Administrata publike

Është arritur progres lidhur me kornizën për administratë publike, që paraqet prioritet kryesor nga Partneriteti për anëtarësim. Përgjegjësia politike për administratë publike mbetet në kompetencë të Komitetit të lartë për reforma në administratën publike, të cilin e kryeson Kryetari i Qeverisë. Në gusht, u emërua përbërja e re e Komitetit të Lartë. Grupi special për reforma në administratën publike në mënyrë të rregullt takohet me shërbimet e BE-së. Qeveria miratoi strategji të re për reforma në administratën publike për periudhën 2010-2015, si dhe vlerësim financiar dhe plan aksional për zbatimin e saj.

Përgjegjësia udhëheqëse dhe funksionale për administratën e përgjithshme publike i është ndarë Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA). Agjencia për Nëpunës Shtetërorë u transformua në Agjenci për Administratë (AA) me kompetenca të ruajtura për mbikëqyrje. Në përgjithësi, organika e re institucionale siguron pikënisje të mirë për zbatimin e suksesshëm të reformave për administratën publike. Kapacitetet buxhetore, hapësinore dhe administrative të MSHIA nuk janë të mjaftueshme, veçanërisht lidhur me inspeksionin administrativ.

Ligji për nëpunës publikë hyri në fuqi në prill 2011, e më vonë u ndryshua dhe harmonizua me Ligjin për nëpunës shtetërorë. MSHIA e miratoi pjesën më të madhe të akteve relevante nënligjore për shërbimin publik dhe shtetëror. Ligji për nëpunës shtetërorë

u ndryshua për futjen e elementeve të reja lidhur me rregullat për selektim dhe avancim. Por, këto ndryshime nuk sigurojnë zgjidhje strategjike për të gjithë sfidat ekzistuese. Korniza juridike e zbatueshme për nëpunësit shtetërorë dhe publikë mbetet e fragmentuar, duke lejuar që institucione të caktuara të rregullohen në mënyrë të ndryshme, edhe në pjesën e dispozitave të cilat kanë të bëjnë me rrogat. Mangësitë kryesore mbeten edhe më tej, veçanërisht në aspekt të rregullave për punësim, vlerësim dhe avancim; emërimin e personave më të lartë udhëheqës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Nevojiten përmirësime plotësuese të ligjeve kyçe me qëllim që të sigurohet vendosja në komizën juridike e parimeve të transparencës, apolitikës dhe meritave lidhur me punësimet dhe avancimet në administratë.

U ndryshua Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, me qëllim që të rritet përgjegjësia me orientimin e procedurave administrative dhe ankimore, duke i përfshirë procedurat për themelimin dhe funksionimin e komisioneve të shkallës së dytë për ankesa. U themelua Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurën për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë. Megjithatë, në përgjithësi, ndryshimet e ligjit nuk i përmirësuan të gjithë mangësitë e tij. Ligji nuk e definon të drejtën e ankesës administrative si parim me përjashtime të definuara qartësisht. Parimi "heshtja është miratim" i është nënshtruar një procedure të ndërlikuar për ankesë, që në esencë e prish zbatimin e parimit në praktikë. Për vendosjen e ndryshimeve sistematike, nevojitet ligj i ri, bashkëkohor dhe i strukturuar mirë.

Nuk është funksional regjistri i nëpunësve shtetërorë, i cili është paraparë me Ligjin për nëpunës shtetërorë me qëllim që të bashkohen të gjithë të dhënat për nevojat, kërkesat dhe procedurat lidhur me kuadrin në një bazë unike të të dhënave. Si organ i shkallës së dytë, Agjencia për Administratë filloi me vendosjen për kundërshtimet e nëpunësve publikë. Edhe krahas asaj që kapacitetet administrative të njësive për resurse njerëzore në disa ministri janë rritur, një numër i madh i këtyre njësive në nivel lokal dhe qendror mbeten me numër të pamjaftueshëm të të punësuarve. Akoma ekziston kapaciteti i pamjaftueshëm për zbatimin e vlerësimeve të drejta të kuadrit.

Edhe krahas asaj që Qeveria ndërmerr hapa për pengimin e shfrytëzimit tejmase të personave të punësuar përkohësisht, shumë çështje mbeten të hapura. Një pjesë e madhe e vendeve të përkohshme u transformuan në pozicione të përhershme në periudhën për të cilën njoftohet, ndërsa një numër i madh i vendeve përsëri mbeten të përkohshme; megjithatë, edhe krahas kërkesave oficiale, nuk u siguruan numra oficiale për vendet ekzistuese ose të transformuara nga ana e autoriteteve. Në shumë raste, u shënuar konsistencë e pamjaftueshme gjatë zbatimit të kushteve lidhur me arsimin ose përvojën; kushte të caktuara si të ishin bërë enkas për kandidatë të caktuar. Ngjashëm me këtë, angazhimi i kuadrit të ri të angazhuar përkohësisht në shumë raste nuk përkonte me procedurat e përcaktuara me ligj. Akumulimi i shembujve të këtyre shpie në brengosje serioze se parimi për angazhim i bazuar në merita dhe pa ndikim politik nuk realizohet mjaftueshëm.

Sistemi i rrogave në administratën publike mbetet i fragmentuar, që ndikon në unitetin dhe mobilitetin e shërbimit publik dhe shtetërorë. Praktika e ad hok kompensimeve të nëpunësve publikë për ndërmarrjen e detyrave të caktuara në suaza të pozicioneve të tyre të punës mbetet me transparencë të pamjaftueshme dhe pa arsyetim adekuat.

Nga shkurti 2011, afër 1600 nëpunës shtetërorë nga bashkësitë joshumicë u pranuan në shërbimin shtetërorë, për shkak të harmonizimit me parimin për përfaqësim të drejtë. Megjithatë, vazhdon trendi i angazhimit të personave të këtyre bashkësive në bazë kuantitative, pa përkuar me nevojat e vërteta të institucioneve. Praktika tregon nivel të pamjaftueshëm të koordinimit për planifikimin e përfaqësimit të drejtë ndërmjet MSHIA dhe Sekretariatit për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë së Ohrit. Procedura për punësim mbetet nën ndikimet joadekuate politike.

MSHIA ndërmerr hapa praktike për përmirësimin e shërbimeve të cilat ua ofron qytetarëve. Është vendosur sistem njësportel për shkëmbim elektronik të dokumenteve ndërmjet institucioneve kyçe. U vendos sistem i ri me pajisje për vlerësim nga ana e qytetarëve në institucionet

e dhëna. Qeveria e miratoi Kodeksin etnik për bashkëpunim me organizatat e qytetarëve. Njohja dhe shfrytëzimi i Regjistrit të qytetarëve në publik mbetet i pamjaftueshëm.

Në aspekt të menaxhimit financiar, përgjegjësia e udhëheqësisë duhet të lidhet nga fillimi me kontrollin financiar të brendshëm publik. Raportet e Entit Shtetëror për Revizion vazhduan të potencojnë mangësi të shumta lidhur me zbatimin e standardeve për kontroll financiar të brendshëm, rregullat për furnizime publike dhe politikën për resurse të njerëzve. Nuk është i mjaftueshëm kualiteti i planifikimit strategjik në organet qendrore dhe lokale dhe ai akoma është i kufizuar në planifikim buxhetor. Sekretariati gjeneral i Qeverisë nuk kryen rol efikas në menaxhimin e administratës. Vlerësimi i ndikimit të rregullativës nuk zbatohet në mënyrë sistematike.

Për procedurat ankimore, u themelua Gjykata Supreme Administrative (*të shihet pjesa për "sistemin e jurisprudencës"*).

Trupat publikë i pranuan rekomandimet e Avokatit të popullit në 80% të rasteve. Edhe më tej rekomandimet më së paku i marrin parasysh komisionet qeveritare të shkallës së dytë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, pas tyre vijojnë Ministria e Financave dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Gjykata Supreme e rriti numrin e anulimit të legjislacionit të ri për 5% në afër 30% të rasteve të ligjeve të kontestuara. Kjo shpie në shqetësim lidhur me kualitetin e përpilimit të ligjeve nga ana e pushtetit qendror dhe lokal.

Numri i ankesave të pranuar në Komisionin nacional për mbrojtjen e qasjes në informata u rrit për dy të tretat në vitin 2010.

Më shumë se gjysma e numrit të ankesave të pranuar është i suksesshëm. Por, puna e Komisionit nacional u pengua me shkurtimet në buxhet dhe mungesën e bashkëpunimit nga ana e organeve të caktuara shtetërore. Informatat lidhur me shpenzimet publike vazhduan të jenë pjesërisht të kapshme për publikun.

Me hyrjen në fuqi të Aktit për sistematizim, ekziston progres i caktuar lidhur me reformat në policisë. Ai siguron bazë për përforcimin e efikasitetit të policisë, megjithatë, janë të nevojshme resurse njerëzore plotësuese për zbatimin e tij. Pas zbatimit të procesit të vlerësimit të mundësive, u vendos sistem për avancim i bazuar në merita dhe vlerësim. Njëkohësisht, një pjesë e madhe e vendeve u plotësuan shpallje paraprake të vendit të lirë të punës që nxit dyshime për proces transparent të bazuar në merita.

Përgjithësisht, ekziston progres lidhur me reformat në administratën publike, gjegjësisht nëpërmjet koordinimit të politikave dhe zgjidhjeve të reja ligjvënëse. U themelua ministri e cila është përgjegjëse për reformat në administratën publike, dhe u ndryshua edhe Ligji për procedurë të përgjithshme administrative. Ndërmjet më shumë institucioneve, u fillua edhe sistemi për interoperabilitet në suaza të E-qeverisë. Progresi në zbatimin e reformave ishte i kufizuar. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme plotësuese me qëllim që të sigurohet transparencë, profesionalitet dhe pavarësi në administratën publike në praktikë. Nevojiten përmirësime plotësuese në kornizën ligjore ekzistuese, veçanërisht në aspekt të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Sistemi i jurisprudencës (Shih edhe Kreun 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale

U bënë ndryshime plotësuese të kornizës ligjore, që është prioritet kryesor për Partneritetin për anëtarësim.

Të drejtat e votimit të ministrit të Drejtësisë në Këshillin Gjyqësor iu hoqën në pajtim me standardet evropiane dhe u ndërpre pjesëmarrja e tij me detyrë zyrtare në Këshillin e prokurorëve publikë.

U miratua pakoja për reforma në sistemin e jurisprudencës i cili përbëhet nga Ligji i ri për procedurë penale dhe nga ndryshimi i Ligjit për gjykata, Ligjit për Këshillin Gjyqësor, Ligjit për

procedurë administrative, Ligjit për buxhetin gjyqësor dhe Ligjit për shërbim gjyqësor, dhe hynë në fuqi edhe ndryshimet e Ligjit për procedurë kontestimore.

Qëllimi i Ligjit të ri për procedurë penale është që të përmirësohet zbatueshmëria e procedurës për kundërvajtje me përforsimin e rolit të prokurorit publik, me vendosjen e teknikave të reja hetuese. Ai ka për qëllim që në masë të konsiderueshme të përmirësohet kapaciteti për menaxhim me krimin kompleks dhe të organizuar dhe rastet e korrupsionit. Filloi trajnimi i përmbaaruesve, prokurorëve dhe gjykatësve për zbatimin e dispozitave të reja, edhe pse ekziston brengosje se aranzhmanet institucionale dhe organizative për reformën e këtillë të madhe nuk janë të avancuara mjaftë. Korniza e re do të zbatohet nga nëntori 2011.

Në shtator 2011 hynë në fuqi ndryshimet e Ligjit për procedurë kontestimore, duke e vendosur shërbimin elektronik të dokumenteve, audio-incizimet e debateve, afate më rigorozë për procedurat, shfrytëzimi i debatit përgatitor dhe obligimi i gjykatave që t'i informojnë palët për mundësinë e ndërmjetësimit. Ndryshimet kanë për qëllim që ta përmirësojnë procedurën qytetare për shkurtimin e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, si dhe stimulimin e zgjidhjes alternative të kontesteve.

Ligji për konteste administrative është ndryshuar me qëllim që të themelohet Gjykatë e Lartë Administrative, me kompetencë që të vendosë për ankesat kundër vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që i shqyrton ankesat kundër vendimeve të komisioneve kundërvajtëse në organet administrative, komisioneve të shkallës së dytë të Qeverisë dhe aktet e organeve të vetadministrimit lokal. Gjykata filloi me punë më qershor të viti 2011. U emëruan 15 gjykatës, u punësuan kuadra në shërbimin gjyqësor dhe u siguruan pajisje dhe lokale përkuatëse.

Ndryshimet e Ligjit për buxhetin gjyqësor sollën rritje në shpërndarjen e mjeteve të buxhetit shtetëror prej 0,4% deri 0,8% nga PBV, që gradualisht do të vendosen deri në vitin 2015. Ekziston, gjithashtu, edhe dispozitë për mbrojtjen e buxhetit gjyqësor në raste të rebalancit të buxhetit nacional dhe kërkesë se së paku 2,5 % doemos duhet të shpenzohet për aftësim profesional të gjykatësve dhe nëpunësve gjyqësorë. Megjithatë, në praktikë, financimi jo adekuat i gjykatave e pengon progresin e mëtejshëm.

Me ndryshimet e Ligjit për Gjykata dhe Ligjit për Kshillin Gjyqësor u pastruan ose u vendosën masa që të sigurohet kompetenca e gjykatësve, duke përfshirë edhe kërkesat minimale arsimore dhe profesionale, testimet psikologjike dhe etike dhe kriteret për vlerësim vjetore. Janë përmirësuar mekanizmat për ankesa në disponim të palëve në procedura gjyqësore, që të dyja në kompetencë të Gjykatës Supreme (në rast të zgjatjes joracionale të procedurave) dhe të Këshillit Gjyqësor (në rast të punës së parregullt të gjykatësve). Janë vendosur masa me të cilat avancohet transparencja dhe debati publik. Megjithatë, hyrja në fuqi e kërkesave të reja minimale për përvojë gjyqësore të gjykatësve nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme është prolonguar deri në mesin e vitit 2013 dhe bazat e reja për shkarkimin e gjykatësve, lidhur me suksesin e dobët ose realizimin e punës mund të kenë ndikim negativ mbi pavarësinë në marrjen e vendimeve.

Në vitin 2010, Këshilli Gjyqësor emëroi 43 gjykatës të shkallës së parë dhe 27 gjykatës të shkallës më të lartë. Është ruajtur parimi i përfaqësimit të barabartë, si dhe i baraspeshës gjinore. Në periudhën e njëjtë, Këshilli i Prokurorëve Publikë emëroi 23 prokurorë publikë.

Kuvendi në prill e shkarkoi ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, pasi Gjykata Supreme, me ankesë, i përcaktoi konstatimet e Komisionit për lustrim, se ai ka bashkëpunuar me shërbimet e fshehta të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Akademia për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve (ATGJP) vazhdon të japë kontribut thelbësorë për profesionalizmin dhe kompletimin e gjykatës. Gjenerata e tretë e kandidatëve në mënyrë të suksesshme e kreu trajnimin e vet fillestar në fund të vitit 2010, ndërsa filloi me trajnim edhe gjenerata e katërt. ATGJP-ja vazhdoi të sigurojë trajnim të kontinuar gjatë shërbimit.

Megjithatë, resurset njerëzore dhe lokalet në ATGJP duhet të përmirësohen, duke marrë parasysh numrin e madh të aktiviteteve për trajnim që i zbaton Akademia çdo vit.

Nevojiten përpjekje më të mëdha që të sigurohet punësimi në bazë të meritave, të tërhiqen studentë të diplomuar të kualifikuar nga ATGJP, se sa nga vendet tjera. Njëzet e dy (22) nga kandidatët për gjykatës dhe prokurorë, të cilët kanë diplomuar në 3 vitet e fundit ende nuk janë punësuar. Më tej, pragu rjedhës i punësimit të studentëve të padiplomuar në vendet e punës në gjykata në shkallë të parë (50%) dukshëm u tejkalua edhe në periudhën kalimtare, sipas të cilit të gjithë gjykatësit e sapoemëruar në shkallë të parë medoemos duhet të jenë studentë të diplomuar nga ATGJP, u vazhdua deri në janar të vitit 2013.

Përgjithësisht, u bënë ndryshime plotësuese në kornizën juridike lidhur me pavarësinë, suksesin dhe transparencën e jurisprudencës. Pakoja për reformë të sistemit gjyqësor u miratua në nëntor, ndërsa në korrik ministrit të Drejtësisë iu hoq e drejta e votimit në Këshillin Gjyqësor. Megjithatë, tani nevojiten përpjekje më të rëndësishme që të përforcohet kualiteti i drejtësisë, veçanërisht nëpërmjet trajnimit të përhershëm dhe procedurave të punësimit të bazuara në merita dhe që të ruhet pavarësia e gjykatësve në kuptim të procedurave për vlerësim dhe shkarkim. Nevojitet koordinim plotësues organizativ dhe institucional, që të sigurohet zbatimi i papenguar i kornizës së re ligjore dhe strukturave të vendosura me Ligjin për procedurë penale.

Politika kundër korrupsionit (Shih edhe Kreu 23 - Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale

U bënë ndryshime plotësuese të kornizës ligjore, që është prioritet kryesor për Partneritetin për anëtarësim.

U miratuan ndryshimet ligjore me qëllim që të zbatohen rekomandimet e GREKO-s nga faza e tretë për inkriminimin dhe transparencën e financimit të partive politike. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor e përpunon fushëveprimin e inkriminimit për ryshfet dhe tregti me ndikim dhe e vendos përgjegjësinë penale për mosparaqitjen e mjeteve të shfrytëzuara në fushatat zgjedhore. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor vendosën kërkesë për parashtrimin e raporteve financiare për të gjithë fushatat zgjedhore te organet kompetente. Ligji i ri për procedurë penale, i cili do të zbatohet nga nëntori 2012, e përforcon rolin e prokurorit publik në procedurën parahetuese dhe vendos masa të shumta speciale hetuese. Megjithatë, mbetet të ndryshohet Ligji për financimin e partive politike.

Më vitin 2010, Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme parashtrori kallëzime penale kundër 29 nëpunësve policorë për kundërvajtje penale, duke përfshirë edhe 16 raste gjoja për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Pesë policë nga një vendkalim kufitar u akuzuan si pjesë e operacioni të vetëm. Gjithsej, numri i rasteve të korrupsionit ndërmjet policisë kufitare u zvogëluar si rezultat i programeve për antikorrupsion, trajnimeve për antikorrupsion, simeve për video-mbikëqyrje dhe rritjes së rrogave. Drejtoria doganore duhet të jetë prioritare, si rrezik i lartë korruptiv në zhvillim dhe zbatimi i programeve të ardhshme për antikorrupsion.

Rasti me korrupsionin në nivel të lartë që ka të bëjë me ish-drejtorin e Drejtorisë së të hyrave publike ka përfunduar kur aktgjykimi u vërtetua në Gjykatën Supreme. Katër rastet tjera të korrupsionit në nivel të lartë, ku të akuzuarit (duke e përfshirë edhe ish- kryeministrin, ish-ministrin e Mbrojtjes dhe ish-guvernatorin e Bankës Popullore) paraprakisht u dënuan me burg, janë ndërprerë pas ankesës dhe janë kthyer në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, për shkak të hetimit të pamjaftueshëm të fakteve. Kapaciteti i gjykatës që të ballafaqohet me rastet e ndjeshme të korrupsionit në nivel të lartë mbetet i dobët.

Mungesa e kontrollit sistematik të përmbajtjes së listave anketuese të gjendjes pronësore dhe deklaratat për konflikt të interesave e pengojnë suksesin e obligimit për njoftim në drejtim të kthimit të praktikave të korrupsionit në administratën publike. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në bashkëpunim me një numër të madh të institucioneve të tjera vendosi metodologji për zbatimin e verifikimit të fletëve anketuese të gjendjes pronësore; përçindja duhet të avancohet nga fillimi. Akoma janë të nevojshme ndryshime ligjore para se të zbatohen kontrollat sistematike të përmbajtjes së deklaratave për konflikt të interesave. Konfliktet e

Interesave në praktikë nuk janë sanksionuar.

Korniza ligjore dhe masat e ndërmarra në aspekt të financimit të partive politike janë të pamjaftueshme. Partitë në koalicionin qeveritar kanë shpenzuar më shumë për zgjedhjet në vitin 2011, se sa janë paraqitur të ardhurat e tyre. U ngritën edhe çështje rreth ligjshmërisë së financimit të fushatës së LSDM-së. Megjithatë mbeten të paqarta struktura institucionale për rregullimin e financimit të fushatave dhe sistemi i sanksionit.

Transparenca e të shpenzimeve publike mbetet e pakënaqshme. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e korrupsionit rekomandoi kallëzime penale për keqpërdorimin e mjeteve publike, por asnjë nga rastet e kthyer më vitin 2009 dhe 2010 në Prokurorinë Publike nuk u zgjidh. Legjislacioni ekzistues për qasje në informatat me karakter publik nga fillimi duhet të ndryshohet me qëllim që të sigurohet transparencë e plotë. Akoma janë të dobëta mekanizmat për kontroll të brendshëm në administratën publike. Mbrojtja ligjore dhe institucionale e "pëshpëritësve" edhe më tej është problematike dhe e pamjaftueshme, duke e çinkurajuar paraqitjen e rasteve të dyshimta.

Organet kompetente të ngarkuara për luftë kundër korrupsionit vazhdojnë me mungesë të të ardhurave proaktive dhe nuk arritën që t'i hedhin poshtë akuzat e përhapura gjerësisht për korrupsion në sferat kruesore të brengosjes, siç janë furnizimet publike dhe financimi i partive politike. Duhet nga fillimi të vendoset evidencë bindëse për akuza dhe aktgjykime. Dispozitat e Kodit të ri zgjedhor për konfiskimin e zgjeruar, pasurimin e paligjshëm dhe përgjegjësinë penale të personave juridikë duhet të zbatohen nga fillimi.

Komisioni Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), Seksioni për antikorrupsion në suaza të Seksionit për krim të organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Themelore Publike për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit mbeten pa numër të mjaftueshëm të kuadrit dhe pa mjete të mjaftueshme financiare. Mbetet i pamjaftueshëm specializimi i organeve për zbatim të ligjit dhe jurisprudencës në nivel lokal, veçanërisht në sferën e korrupsionit të imët.

Ligji për parandalimin e korrupsionit është ndryshuar që ta bartë statusin profesional të KSHPK-së; megjithatë, besimi publik në pavarësinë e tij mbetet i brishtë. U ngritën çështje për kriteret e shfrytëzuara nga ana e Kuvendit në zgjedhjen e shtatë anëtarëve të rinj të KSHPK-së në prill. Vetë KSHPK-ja në raportin e vet vjetor për vitin 2010 konkludoi se shkurtimi në masë të konsiderueshme i buxhetit dhe mandatit e vuri në pah vullnetin politik për luftë të suksesshme kundër korrupsionit.

Duhet të përforcohet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, KSHPK-së dhe organeve për zbatimin e ligjit. Nga fillimi duhet të zbatohet analizë e rëndësishme për nivelin dhe llojin e korrupsionit në sfera të ndryshme. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave relevante për matjen e shkallës dhe natyrës së korrupsionit, si dhe zbatueshmëria e masave kundër korrupsionit mbeten të pakompletuara. Korrupsioni edhe më tej brengos seriozisht.

Përgjithësisht, U bënë ndryshime plotësuese të kornizës ligjore, që është prioritet kryesor i Partneritetit për anëtarësim. Rekomandimet e GREKO-s u morën parasysh dhe korniza ligjore u avancua. Progresi i kufizuar është arritur. Nga fillimi duhet të vendoset evidencë për menaxhim me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Verifikimi i fletëve anketuese të gjendjes pronësore dhe deklaratave për konfliktin e interesave duhet të sistematizohen dhe të institucionalizohen. Transparenca e shpenzimeve publike dhe financimi i partive politike mbeten të paplota. Nevojitet bashkëpunim më i madh proaktiv ndërinstitucional. Korrupsioni është i përhapur në shumë sfera dhe vazhdon të paraqesë problem serioz.

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave (shih kreun 23- Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale)

Respektimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Nuk është arritur progres lidhur me ratifikimin e **instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**. Ende nuk është ratifikuar **Karta Evropiane për gjuhë rajonale ose të pakicave**.

Gjatë periudhës raportuese, **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)** miratoi tetë aktgjykime se Republika e Maqedonisë i ka shkelur të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (EHCR). Gjithsej 374 parashtresa të reja të dërguara deri te trupi për vendimmarrje u paraqitën nga tetori 2010. Në shtator 2011, 1111 parashtesa lidhur me Republikën e Maqedonisë ishin në procedurë në Gjykatë.

Është bërë progres i kufizuar lidhur me **avancimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut**. Zbatimi i kornizës juridike ishte i pabarabartë, ndërsa organika institucionale u zgjerua me themelimin e paradokohshëm të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Tri seksione të reja në zyrën e Avokatit të Popullit qëndrojnë pa resurse njerëzore, me tre të punësuar në secilin seksion.

Në nëntor 2010 vendi e përfundoi kryesimin e vet në Komitetin e ministrave të Këshillit të Evropës. Programi i shtetit u fokusua në tri prioritetet: përforcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, stimulimi i integritimit me respektimin e dallimeve dhe avancimi i pjesëmarrjes së të rinjve.

Të drejtat qytetare dhe politike

Lidhur me parandalimin e **torturës dhe sjelljes degraduese** dhe luftës kundër mosdënimit, dispozitat ligjore në këtë sferë duhet të nga fillimi të barten në praktikë konzistente dhe gjithëpërfshirëse. Mangësitë sistematike ngelin lidhur me luftën kundër mosdënimit me organet për zbatimin e ligjit. Vazhdojnë supozimet për sjelljen degraduese nga ana e njësisë speciale policore mobile "Alfat", e cila tani për tani vepron vetën në Shkup. Anëtar i kësaj njësie është i akuzuar për vrasjen e një personi të ri gjatë tubimit paszgjedhor në qendër të Shkupit, më 6 qershor. Kjo i rriti apelet që të shpërbëhet njësia "Alfat".

Suksesi i prokurorëve dhe gjykatësve për marrjen e veprimeve përkatëse kur ka indikacione për sjellje degraduese nga ana e policisë mbetet shqetësuese. Sistemi i ankesave ende është i dobët, ndërsa sistemi për grumbullimin e të dhënave është i varfër. Numri i provave të pavërtetuara në aspekt të sjelljes degraduese ose përdorimit të mjeteve për mbajtjen e personave në paraburgim mbetet i lartë. Në vitin 2010, 238 ankesa u paraqitën te Avokati i Popullit lidhur me sjelljen policore, prej të cilave 23% lidhur me sjellje degraduese. Ekziston numër i konsiderueshëm i stacioneve policore me qeli substandarde.

Njohja e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane ndërmjet nëpunësve policorë është e ulët dhe nuk janë zbatuar në mënyrë adekuate masat mbrojtëse nga sjellja e degraduar në stacionet policore. Ende nuk janë zbatuar masat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kërkojnë mekanizëm të pavarur për mbikëqyrje të policisë, në kuptim të sjelljes së degraduar ndaj popullatës romë. Sjellja e degraduar ndaj romëve edhe më tutje është brengosëse.

Në sferën e reformave të **sistemit të burgjeve**, Qeveria miratoi program vjetor për ndërtim, rinovim dhe mirëmbajtje të burgjeve për vitin 2011. U rinovuan pjesë të burgjeve në të cilat kishte kushte degraduese dhe johumane, përfshirë edhe seksionin gjysmë të hapur të burgut të Idrizovës.

Vendi duhet të zhvillojë strategji nacionale efektive për sistemin e burgjeve. Stërmbushja dhe mbrojtja e ulët shëndetësore edhe më tutje është brengosëse. Shumica e burgjeve nuk kanë mjete të mjaftueshme, personel, dhe nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet themelore për mirëmbajtje. Megjithatë, kushtet në disa prej burgjeve, veçanërisht seksioni i mbyllur i burgut në Idrizovë, mbeten nën standardet e nevojshme. Kushtet në Shtëpinë ndëshkuese-përmirësuese në Tetovë për rehabilitim të të miturve edhe më tutje seriozisht brengos. Nevojitet mekanizëm inspektues i pavarur efektiv për mbrojtje nga cenimi i të drejtave të njeriut në burgje.

Ende nuk iu është përgjigjur rekomandimit të Parlamentit Evropian nga viti 2007 për ndjekjen e rastit të paraburgimit jashtëgjyqësor të Kaled El Masrit.

Viti i parë nga zbatimi i Ligjit për ndihmë juridike ndihmoi në përmirësimin e **qasjes në drejtësi**. Janë siguruar dy lloje të ndihmës juridike: këshilli juridik inicial nga ana e njësive rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe organizatat e regjistruara të shoqërisë qytetare, dhe ndihma juridike në procedura gjyqësore dhe administrative. Megjithatë, vetëm dy organizatat të shoqërisë qytetare mund të regjistroheshin si ofrues të ndihmës juridike. Gjithashtu, nuk u sigurua ndihmë juridike për azilkërkuesit.

Korniza e përgjithshme juridike dhe kushtetuese për mbrojtjen e **lirisë së të shprehurit** në mënyrë të përgjithshme u vendos, por nevojitet kujdes që të sigurohet zbatimi i saj konsekuent dhe transparent, në pajtim me praktikën gjyqësore nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Lidhur me mediet, u themelua edhe sindikata e parë e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve të medimeve me qëllim të përmirësimit të kushteve për punë. Shkalla e arkëtimit të taksës mujore radiodifuzive u zmadhua, për shkak të përforcimit të qëndrueshmërisë financiare të servisit publik radiodifuziv. Megjithatë, nevojiten përpjekje plotësuese që të sigurohet financimi i tij i qëndrueshëm, si dhe i Këshillit për radiodifuzion. Servisi publik radiodifuziv për momentin nuk e plotëson obligimin e tij ligjor.

Pronësia mbi mediumet mbetet e paqartë, e koncentruar lartë dhe me lidhje të fuqishme politike. Qeveria është një prej reklamuesit më të mëdhenj në vend dhe ekziston brengë se mjetet janë të dedikuara për kanalet televizive të cilat e përkrahin Qeverinë. Kanale të caktuara televizive janë donatorë kryesorë të partive politike. Hetimi, për akuza lidhur me shmangien tatimore, si dhe mbyllja e mëvonshme e kanalit televiziv A1 dhe gazetave që kishin qëndrime kritike ndaj politikave qeveritare solli brengosje për proporcionalitetin dhe selektivitetin e procedurës. Është zvogëluar shumëllojshmëria e ofertës mediatike. Botimi i gazetave *Vreme*, *Shpic* dhe *Koha e Re* u ndërpre në korrik.

Redaktorët dhe gazetarët ballafaqohen me presion joadekuat politik dhe frikësim.

Shpifja nuk është dekriminalizuar, ndërsa dënimet e parapara me ligj përfshijnë dënime të pakufizuara monetare ose burgim (edhe pse, në praktikë, deri më tani asnjë gazetar nuk është gjykuar me dënim me burg). Gazetarë të caktuar personalisht përgjigjen për njoftimet e dhëna dhe për këtë shkak u ekspozohen dënimeve të larta monetare. Në këtë kontekst, frikësimi i gazetarëve dhe autocenzura e zmadhuar mbeten si shkak për brengosje.

Me ndryshimet e Ligjit për Këshillin për radiodifuzion, u zmadhua numri i personave të emëruar nga trupat nën kontroll qeveritar. Ndryshimet janë miratuar pa konsultimin e Këshillit për radiodifuzion ose çfarë do lloj tjetër të debatit publik. Ndryshimet sjellin brengosje lidhur me zvogëlimin e pavarësisë së trupit dhe burokracinë e zmadhuar. Për momentin nuk ekziston Këshilli i gazetarëve për mediumet e shtypit.

Në shtator, Qeveria filloi me organizimin e tryezës së rumbullakët me përfaqësues nga gazetarët dhe mediumet me qëllim që të zhvillohet dialog për çështjet e ndërsjella brengosëse dhe të gjenden zgjidhje për to.

Lidhur me **lirinë e mbledhjes dhe shoqërimit**, situata e përgjithshme është e kënaqshme. Strategjia e Qeverisë dhe plani aksional për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë qytetare vazhdojnë të zbatohen. Kodeksi i praktikave të mira për pjesëmarrje në organizatat e shoqërisë qytetare në proceset e krijimit të politikave u miratua në korrik 2011. U arrit progres modest në përfshirjen e shoqërisë qytetare në procesin e krijimit të politikave dhe përpilimit të legjisllacionit. Nevojitet zhvillim i më tutjeshëm i qasjes konsekuente për inkurajimin e pjesëmarrjes së përgjithshme publike në miratimin e vendimeve, përfshirë edhe mekanizmat përkatëse institucionale.

Nevojitet përmirësim plotësues i sistemit për shpërndarjen e financave shtetërore organizatave të shoqërisë qytetare, veçanërisht lidhur me organizatat me interes publik. Organizatat e shoqërisë qytetare në masë të konsiderueshme mbeten të varura nga financimi i jashtëm dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare edhe më tutje është problem serioz.

Funksionarët e partive politikë dhe deputetët në Kuvend edhe medime të caktuara plasuan sulme publike mbi organizatat me qëndrime kritike të shoqërisë qytetare, me akuza për politizim të organizatave të shoqërisë qytetare dhe pastrim parash. Drejtori ekzekutiv i Institutit "Shoqëri e hapur" u shpall si fajtor nga ana e Komisionit për Lustrim për bashkëpunim me Shërbimin e Sigurimit të ish-Shtetit të Jugosllavisë. Dy anëtarë të Komisionit e bojkotuan punën e tij si protestë për këtë vendim.

Lidhur me **lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit**, 28 persona religjiozë juridikë u regjistruan në pajtim me Ligjin për status juridik të kishave, bashkësive religjioze dhe grupeve fetare, ndërsa 6 u refuzuan, përfshirë edhe kërkesën e Bashkësisë së Bektashinjve nga Tetova në bazë të shfrytëzimit të emrit të njëjtë si të Bashkësisë të Bektashinjve nga Kërçova tashmë të regjistruar.

Përgjithësisht, edhe pse të drejtat qytetare dhe politike respektohen, është arritur progres i mëtutjeshëm i kufizuar. Disa pjesë të burgjeve u rinovuan. Fillon t'i kushtohet vëmendje qëndrueshmërisë financiare të servisit publik radiodifuziv. Megjithatë, mbeten disa dobësi të caktuara lidhur me luftën kundër mosdënimit me organet për zbatimin e ligjit. Ende mbetet që vendi të përpilojë strategji efikase nacionale për sistemin e burgjeve. Redaktorët dhe gazetarët u ballafaquan me presion politik dhe frikësim të zmadhuar. Në këtë kontekst, mbi politikën e gazetarëve dhe redaktorëve lehtë ndikohet, që rezulton me autocenzurë me përhapje të gjerë.

Të drejtat ekonomike dhe sociale (shih Kapitulli 19-Politika sociale dhe punësimi)

Lidhur me **të drejtat e grave dhe barazisë gjinore**, vazhdon realizimi i strategjisë nacionale kundër dhunës në familje. U përmirësua vetëdija për dhunën familjare tek popullsia dhe u ndërmorën iniciativa që t'u përgjigjet më mirë nevojave të viktimave. U përforcua kapaciteti i trupit nacional koordinues për strategjinë nacionale për luftë kundër dhunës në familje. U bë progres i caktuar lidhur me shëndetin e grave. Çështja për mundësi të barabarta nuk është prioritet politik i Qeverisë. Zakonet diskriminuese, traditat dhe stereotipet janë të përhapura gjerësisht dhe ato i shpërfillin të drejtat themelore të grave. Pjesëmarrje e grave në jetën politike në nivel lokal mbetet e ulët. Gratë dhe vajzat romë ende vuajnë nga diskriminimi racor dhe gjinor. U realizuan aktivitete të kufizuara të dedikuara për romët dhe nevojitet qasje proaktive për realizimin e planeve aksionare nacionale ekzistuese.

U arrit progres i caktuar edhe në sferën e **të drejtave të fëmijëve**. Strategjia nacionale për parandalimin e delikuencës së të miturve u miratua nga Këshilli i Nacional për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Nevojiten resurse përkatëse financiare dhe administrative dhe bashkëpunim i afërt ndër-institucional për zbatimin e rregullt të Ligjit të ndryshuar për të drejtën e të miturve. Nuk ka kuadër të specializuar në mënyrë të mjaftueshme për ballafaqimin me viktimat të moshës së mitur në kundërshtim me ligjin dhe me të vërtetë nevojitet trajnim i mëtejshëm. Qelitë policore për paraburgim dhe qendrat edukuese-përmirësuese nuk i plotësojnë standardet për administrim të të drejtës së të miturve, veçanërisht lidhur me punësimin e psikologëve dhe punëtorëve socialë në gjykata. Avokati i Popullit paraqiti shkelje të të drejtave themelore të njeriut të të miturve në paraburgim, përfshirë mospasje të qasjes ose qasjes së kufizuar në shërbimet mjekësore, mungesë të qasjes në arsim dhe lënie në qeli në vetmi.

Përqindja e fëmijëve që jetojnë nën kufirin e varfërisë u rrit në afër 37%. Nuk është adekuate përkrahja institucionale për parandalimin e keqpërdorimit dhe për mbrojtjen e të drejtës së fëmijëve. Shërbimet për përkujdesje të viktimave janë shumë të kufizuara dhe ka mungesë të shkathtësive profesionale. Numri i rasteve të paraqitura të abuzimit seksual dhe pedofilisë mbeti përafërsisht i njëjtë, por konsiderohet se rastet e paraqitura janë vetëm pjesë e problemit të përgjithshëm. Për herë të parë Avokati i popullit e hulumtoi tregtinë me fëmijë brenda dhe jashtë shtetit. Fëmijët e lënë në rrugë, pjesa më e madhe romë, mbeten fenomen shpeshherë lidhur me lypjen.

Duhet të zhvillohen dhe zbatohen strategji për kyçjen e tyre të mëtutjeshme në sistemin arsimor. Ka nevojë të pa shmangshme që të punësohet kuadër i specializuar si psikologë dhe specialistë të arsimit për punë me fëmijë me nevoja të posaçme.

Lidhur me **personat e cenuar socialë dhe/ose personat me pengesa në zhvillim**, janë bërë përpjekje për deinstucionalizim, si përfshirja e shoqërisë qytetare në sigurimin e shërbimeve psikiatrike shëndetësore dhe hapja e seksioneve plotësuese të komunave për banim. Megjithatë, kushtet materiale dhe sjellja johumane dhe e degraduar në institucionet psikiatrike, veçanërisht në Demir Kapi, Demir Hisar dhe Negorci, dhe më tej na shqetësojnë. Nuk kishte përparim në zbatimin e Strategjisë nacionale për barazinë e drejtave të personave me pengesa në zhvillim 2010-2018. Në përgjithësi, integrimi shoqëror i personave me nevoja të posaçme ngelet i kufizuar.

Ekziston përparim i caktuar në sferën e politikës antidiskriminuese. Filloi të funksionojë Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe filloi të punojë në ankesat e parashtuara. Shumica e ankesave ishin në bazë etnike dhe politike. Megjithatë, e drejta në sferën e jodiskriminimit ngelet në tërësi të harmonizohet me asquis. Ende është lënë anash diskriminimi në bazë të përcaktimit seksual. Gjithashtu, duhet të forcohen kapacitetet e Komisionit. Bashkësia e lezbikeve, gejëve, biseksualëve dhe transeksualëve (LGBT) vazhdon të jetë objekt i diskriminimit dhe stigmatizimit. Librat universitarë dhe librat shkollorë për shkollat të mesme e trajtojnë homoseksualitetin si sëmundje. Ekziston nevojë e madhe që të rritet vetëdija jo vetëm lidhur me dispozitat e reja të përmbajtura në ligjin e miratuar, por edhe në raport me parimet e respektimit dhe tolerancës së dallimeve.

Në aspekt të **të drejtave të punës dhe të sindikatave**, ekzistojnë 39 sindikata të evidentuara në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe të 7 shoqatave të punëdhënësve. Janë zbatuar kriteret për pjesëmarrje reprezentative të partnerëve socialë në dialogun bipartiak dhe tripartiak socialë të paraparë me të drejtën e punës. U fillua me nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive në sektorin publik nga ana e sindikatave. Megjithatë, kapaciteti i partnerëve socialë nuk është përmirësuar, sindikatat ende nuk kanë mjete të qëndrueshme financiare dhe kapacitete për menaxhim.

Vazhdon të jetë pjesëmarrja e vogël e partnerëve socialë në procesin e zhvillimit të politikave. Nuk është përmirësuar dialogu social bipartiak dhe tripartiak.

Lidhur me **të drejtat e pronësisë**, procesi i kthimit të pronës së konfiskuar gjatë kohës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë vazhdon në masë të konsiderueshme t'i tejkalojë afatet ligjore të parashtuara. Gjykata kushtetuese e anuloi efektin retroaktiv të ndryshimeve të Ligjit për denacionalizim. Kthimi i pronës u zëvendësua me kompensim në obligacione. Gjykata Kushtetuese gjithashtu i anuloi dispozitat e Ligjit për denacionalizim që e përjashtonte zbatueshmërinë e tij të bashkësitë religjioze. Zbatimi i kërkesave për kthim për të cilat është miratuar vendim përfundimtar edhe më tej është e pakënaqshme. Procedurat e mbetura të kontesteve pronësore juridike vazhdojnë të prolongohen.

Përgjithësisht, të drejtat sociale dhe ekonomike janë të vendosura gjerësisht dhe është bërë përpaparim i caktuar i mëtutjeshëm. Është përmirësuar vetëdija për dhunën në familje të popullësisë. Janë zbatuar kriteret e reja për pjesëmarrje reprezentative të partnerëve socialë. Filluan të funksionojnë Këshilli Nacional për Parandalimin e Delikuentëve të Miturve dhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi. E drejta në sferën e antidiskriminimit ngelet në tërësi të harmonizohet me asquis, veçanërisht lidhur me diskriminimin në bazë të përcaktimit seksual. Duhet të forcohet kapaciteti i Komisionit kundër Diskriminimit.

Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtat kulturore

Lidhur me **pakicat**, dhjetëvjetori i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit siguroi mundësi të rëndësishme për forcimin e dialogut ndërmjet bashkësive në vend. Edhe Presidenti edhe Kryeministri morën pjesë në ngjarjet për shënimin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme. U zhvillua kornizë institucionale për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe për përkrahjen e dialogut ndëretnik.

Plani rrjedhës strategjik i Sekretariatit për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SZMKO) përfshin mirëkuptim gjithëpërfshirës të aspekteve të ndryshme politike që dalin nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, si arsimimi i integruar, përdorimi i gjuhëve,

decentralizimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë qytetare. Buxheti për vitin 2011 Sekretariatit për Zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit iu rrit në masë të konsiderueshme.

Megjithatë, Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ka hasur në probleme lidhur me punësimin e kuadrit të mjaftueshme të kualifikuar të lartë. Iu ndan mjete të kufizuara për rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të tyre. Kapacitetet për planifikim strategjik dhe standardet për kontroll të brendshëm ngelën të ulëta.

Progresi i caktuar u bë në zbatimin e ligjit për përdorim të gjuhëve që e flasin së paku 20 % të qytetarëve Në Kuvend, është avancuar zbatimi i Ligjit për gjuhët me punësimin e përkthyesve dhe interpretuesve më të shkathtë.

Megjithatë, deri më tani nuk është vendosur mekanizëm i qartë për ndjekje të përgjithshme dhe vlerësim të zbatimit të Ligjit për gjuhët. Disa institucione edhe më tutje përballen me mungesë të interpretuesve të kualifikuar dhe me përvojë. Mësimi zgjedhor i gjuhëve të bashkësive më të vogla nuk është i kapshëm në mënyrë të barabartë për arsye të disponueshmërisë së kufizuar të librave shkollorë dhe mungesës së mësimdhënësve të kualifikuar.

U bënë përpjekje për promovimin dhe zbatimin e Strategjisë për arsimim të integruar, në bashkëpunim të ngushtë me OSBE-në. U themelua grup pune koordinativ ndërresorialisht. Ka konsultime të afërta me bashkësinë ndërkombëtare të donatorëve për zbatimin e aktiviteteve konkrete të planifikuara të strategjisë që të garantohet efikasiteti dhe të shmanget dublimi. Megjithatë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i mungojnë kapacitete njerëzore dhe financiare që janë të domosdoshëm për realizimin e strategjisë. Edhe përkundër përpjekjeve të Qeverisë për promovimin e parimeve të arsimit të integruar, në disa shkolla u vazhdua praktika e ndarjes së nxënësve në linjë etnike ose turne gjuhësore. Edhe më tutje ka raste të dhunës ndëretnike në shkollat e mesme.

Marrëdhëniet ndëretnike u ngarkuan me incidente të caktuara. Projekti urban "Shkupi 2014" krijoi ndjeshmëri ndëretnike. Anëtarë të bashkësive joshumicë ankoheshin për lënien anash të përmendoreve të tyre historike dhe kulturore. Në shkurt, ndërtimi i muzeut-kishë në Kala të Shkupit solli në përleshje të dhunshme ndërmjet anëtarëve të dy bashkësive etnike kryesore. Përfshirja e drejtpërdrejtë në ngjarjet e politikanëve nga njëra nga partitë e koalicionit qeverisës shkaktoi shqetësim.

Komitete për marrëdhënie ndërmjet bashkësive u themeluan në 20 komuna ku kërkohet që të themelohen në pajtim me ligjin, si dhe në 14 komuna tjera në bazë vullnetare. Një numër i vogël i tyre e përmirësuan kapacitetin e tyre në bashkësinë e tyre. Megjithatë, numri më i madh i tyre vazhdon që të përballen me mungesë të mjeteve, kompetencave të paqarta dhe përfaqësim të pamjaftueshëm të bashkësive etnike që jetojnë në komunë.

Pak u përmirësua kapaciteti administrativ dhe prania e Agjencisë për Mbrojtjen e Drejtave të Pakicave të cilët janë më pak se 20% të popullatës. Megjithatë, si rezultat i mandatit të paqartë dhe zvogëlimit të konsiderueshëm të buxhetit në vitin 2011, Agjencia nuk është në gjendje t'i kryejë shumë detyra të definuara me ligj.

Numri i përgjithshëm i nëpunësve shtetërorë nga bashkësitë etnike joshumicë arriti 30% që është në pajtim me strukturën demografike. U bënë përpjekje që të rritet përfaqësimi i bashkësive më të vogla në shërbimin shtetëror, veçanërisht të bashkësive rome dhe turke. Në vitin 2010 kishte rritje prej 46% të bashkësia rome dhe rritje prej 12% të bashkësia turke. Megjithatë, janë të nevojshme përpjekje më të mëdha që të rritet kualiteti i procesit të punësimit. Një numër i madh i nëpunësve të rinj të punësuar shtetëror morën rroga, edhe pse nuk u ishin caktuar kurrfarë detyrash dhe përgjegjësisht. Përfaqësimi i bashkësive joshumicë në nivele udhëheqëse ngelet shumë i ulët.

Mund të vërehet përparim i vogël në sferën e inkluzionit të romëve. Në korrik, vendi e mori kryesimin njëvjetor me Dekadën për inkluzionin e romëve. Gjithashtu, u majtë seminar me Komisionin Evropian i cili solli rekomandime të reja për aksion dhe u pajtua që të takohen rregullisht që të ndiqet progresi. U bënë përpjekje për zbatimin e planit aksional për arsim me zbatimin projekteve në sferën e arsimit dhe në sferën sociale. Gradualisht u rrit numri i fëmijëve romë në shkollat e mesme dhe në universitete. U bënë ndryshime në Ligjin për mbrojtje sociale për shkak të stërpërfaqësimit të madh të fëmijëve romë në shkolla speciale për fëmijë me vështirësi në mësim. Programi mediator shëndetësorë romë filloi në 8 komuna.

Vazhduan që të zbatohen disa masa aktive në tregun e punës që kanë të bëjnë me Romët. Edhe krahas shkurtimeve buxhetore, përkrahja financiare për programet për romët u përkrah në nivelin nga vitet 2009 dhe 2010.

Megjithatë, nuk u ndërmorën masa që në mënyrë sistematike t'u përgjigjet lëshimit të dokumenteve personale, çka paraqet pengesë të madhe për qasje në shërbimet sociale, banim dhe shërbimet shëndetësore. Gjithashtu, fëmijët romë vazhdojnë të jenë të stërpërfaqësuar në seksionet për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Raporti i paradokohshëm konkludoi se rreth gjysma e fëmijëve janë romë, ndërsa ato janë vetëm 2,6% e popullatës. Kjo nuk është në pajtim me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të cilët e vërtetojnë të drejtën e fëmijëve romë për shkollimin jodiskriminues. Tempi i zbatimit të Strategjisë së romëve dhe planet aksionale në kuadër të Dekadës së romëve për inkluzionin e romëve 2005-2015, që e arriti pikën e saj të mesme, vazhdon të ngadalësohet. Nuk janë të vendosura mekanizma të qartë për vlerësim dhe kontroll. Mjetet shtetërore të shpërndara për zbatimin e planeve aksionale edhe më tutje janë të pamjaftueshme që t'u përgjigjen nevojave. Nuk kishte përmirësim në kapacitetet administrative në kabinetin e ministrit pa resor të bashkësisë romë dhe të seksioneve për zbatimin e Strategjisë së romëve. Nuk u ndërmorën hapa të konsiderueshëm që të sigurojnë të dhëna zyrtare për romët

Edhe më tutje ngelet shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht ndërmjet femrave romë dhe rinisë, dhe shpjen në kushte të pavoritshme banimi dhe jetese, shëndet të keq, si dhe ndjekje të ulët të shkollave, të ardhura të ulëta dhe shkallë e lartë e mortalitetit të romët.

Vazhduan kërcënimet për brutalitetin policor dhe përdorimit tejmase të forcës ndaj romëve. Shumë romë hezitojnë të parashtrajnë ankesa, veçanërisht kur bëhet fjalë për maltretim nga policia.

Në qershor 2011, kishte 1554 refugjatë dhe persona të brendshëm të zhvendosur (PBZH) në vend, shumica e të cilëve janë romë nga Kosova, nga të cilët vetëm 24 ishin pranuar si refugjatë dhe duhet të gjendet zgjidhje afatgjate për të tjerët. Qeveria siguron ndihmë të caktuar financiare për romët refugjatë nga Kosova. Vendimet pozitive ishin miratuar nga Gjykata Administrative në kontrolle gjyqësore dhe procedura ankimore. Këto vendime ishin kumtuar në bazë procedurale dhe jo në bazë qenësore. Megjithatë, mekanizmi për përcaktimin e statusit refugjatë ende përballet me mangësi. Refugjatët romë nga Kosova vazhdojnë të hasin në kushte veçanërisht të vështira.

Numri i personave të brendshëm të zhvendosur (PBZH) u zvogëlua prej 621 në 2009 deri në 611 në 2010. Numri më i madh i ankesave të parashtruara nga ana e PBZH kundër shtetit për dëme të shkaktuara nga konflikti 2011 janë ende në procedurë gjyqësore.

Përgjithësisht, u arrit progres i caktuar lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e pakicave dhe të drejtave kulturore. Marrëveshja kornizë e Ohrit vazhdon të jetë element qenësor për demokracinë dhe sundimin e së drejtës. Në Kuvend u përmirësua zbatimi i Ligjit për gjuhët. U rrit përfaqësimi i komunitetit romë dhe turk në shërbimin shtetëror. U përmirësua integrimi i romëve në sistemin arsimor, më përfshirje në rritje në arsimin e mesëm dhe atë universitar. Është i nevojshëm dialog i vazhdueshëm ndërmjet të gjitha bashkësive që të rritet besimi, veçanërisht në sferën e arsimit, kulturës dhe gjuhës. Romët vazhdojnë të përballen me kushte shumë të vështira për jetesë dhe diskriminimin dhe janë të nevojshme angazhime plotësuese.

2.3. Çështje rajonale dhe detyrime ndërkombëtare

Republika e Maqedonisë vazhdon në tërësi të bashkëpunojë me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë (GJNPJ). Nuk ka raste të mbetura ose ankesa në procedurë gjyqësore në Hagë. Katër lëndë të cilat GJNPJ i ktheu në kompetencë të autoriteteve vendore në 2008 janë lëndë e sistemit vendas gjyqësor. Në korrik Kuvendi miratoi Interpretim autentik të Ligjit për amnisti që përcaktoi se amnistia duhet t'i përfshijë të dyshuarit nga të gjitha rastet që nuk do të jenë të procedura para GJNPJ. Rrjedhimisht, në shtator, njëri nga rastet u ndërprere nga ana e Gjykatës Penale në Shkup me kërkesë të Prokurorit Publik. Gjithashtu në shqyrtim u konstatua se personat e lënduar në rast mund të kërkojnë dëmshpërblim përmes ankesës së veçantë. Statusi i rasteve të ngelura mbetet të përcaktohet. Partitë politike të shqiptarëve etnik pohojnë se të gjitha lëndët janë të përfshirë me Ligjin për amnisti prej vitit 2002.

Republika e Maqedonisë e pranoi Vendimin e Këshillit për avancimin e përkrahjes universale për gjykatën ndërkombëtare penale dhe për promovimin e pjesëmarrjes më të gjerë në të. Megjithatë, ai ende e mban marrëveshjen bilaterale për imunitet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga 2003, me të cilën lejohet përjashtimi nga kompetenca e Gjykatës ndërkombëtare penale. Kjo nuk është në pajtim me qëndrimet e

përbashkëta të BE-së për integritet të statusit të Romës ose parimet udhëheqëse të BE-së të lidhura me të për marrëveshjet bilaterale për imunitet. Vendi duhet të harmonizohet me qëndrimin e BE-së.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira miqësore paraqesin pjesë qenësore e procesit të afrimit të vendit drejt Bashkimit Evropian. Vendi vazhdoi plotësisht të marrë pjesë në iniciativat rajonale, duke përfshirë Procesin e Evropës Juglindore (SEECP), Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Marrëveshja qendrore evropiane për tregti të lirë (CEFTA), Marrëveshja për bashkësi energjetike dhe Marrëveshja për hapësirë ajrore evropiane të përbashkët (ECAA). Vendi nënshkroi protokoll plotësues për liberalizim të mëtejshëm të bujqësisë sipas Marrëveshjes CEFTA. Vendi vazhdoi të jep kontribut të tij në Misionin ALTEA të BE-së dhe Bosnjë dhe Hercegovinës. Në mars, në kuadër të SEECP, Republika e Maqedonisë e përkrahu Dokumentin rajonal strategjik dhe planin aksional për drejtësi dhe punë vendore 2011-2013. Vendi e përkrahu iniciativën e REKOM për pajtim.

Republika e Maqedonisë vazhdon të luajë rol konstruktiv lidhur me marrëdhëniet bilaterale me vendet fqinje-anëtare dhe vendet tjera të procesit të zgjerimit. Marrëdhëniet me Shqipërinë ngelen të mira dhe u nënshkrua marrëveshja për liberalizim të plotë të transportit bilateral dhe transitor ndërmjet dy vendeve. Marrëdhëniet me Bosnjë dhe Hercegovinën ngelen të mira dhe filluan bisedime për marrëveshje për bashkëpunim në sferën e shkencave shëndetësore dhe mjekësore, zbatim të përbashkët të vendimeve gjyqësore për çështje penale dhe për ndihmë juridike për çështje qytetare dhe penale. Marrëdhëniet me Kroacinë ngelen të mira. Lidhur me Malin e Zi u nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim ekonomik dhe social dhe për bashkëpunim në sferën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë dhe për ekstradimin e qytetarëve të përfshirë në kriminalitet të organizuar, korrupsion dhe larje parash. Përveç kësaj, u lidh marrëveshje bilaterale për mbrojtjen e investimeve dhe marrëveshjes për koordinim të sistemeve për mbrojtje sociale.

Marrëdhëniet me Serbinë ngelen të mira. U nënshkrua marrëveshje bilaterale për readmision. Përveç kësaj u nënshkrua protokoll për patrullime të përbashkëta kufitare dhe u themelua qendër e përbashkët kontaktuese për patrullat policore dhe kufitare. Vendi siguroi ndihmë humanitare për Serbinë pas tërmetit në Kralevë. Serbia vazhdoi ta mbajë politikën e saj për mosnjohjen e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë. Ngelin çështjet e pazgjidhura që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet kishave ortodokse.

1. Vendim 2011/168/ZNBP të Këshillit prej 29 mars 2011.

Marrëdhëniet me Kosovën u intensifikuan në mënyrë plotësuese. U nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim doganor që parasheh themelim të përbashkët kontrollues doganor në pajtim me standardet evropiane, marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe tre marrëveshje nga sfera e së drejtës penale. U vendosën patrulla të përbashkëta përgjatë kufirit.

U mbajt bashkëpunim i afërt politik dhe ekonomik me Turqinë.

Marrëdhëniet me Greqinë vazhduan të jenë të afërta, veçanërisht në sferën ekonomike, ndërsa vazhduan të jenë të cenuara negativisht me çështjen e pazgjidhur për emrin. Vendi ngelet i përfshirë në bisedime nën patronazhin e KB-së, si dhe përmes takimeve të drejtpërdrejta të kryeministrave, për zgjidhjen e kësaj çështje. Qeveria vendosi statua në qendrën e Shkupit, gjë që nga Greqia u pa si provokim për shkak të ngjashmërisë me atë të Aleksandrit të Madh. Duhet të shmangen aktivitetet dhe deklaratat të cilat do të mund të ndikojnë negativisht mbi marrëdhëniet e mira fqinjësore. Filluan bisedimet për procedurën juridike të iniciuar nga vendi kundër Greqisë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë lidhur me Marrëveshjen bilaterale të përkohshme të vitit 1995. Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, duke përfshirë edhe zgjidhje të pranueshme në bazë të bisedimeve për çështjen e emrit nën patronazh të KB-së, ngelet kryesore.

Marrëdhëniet me Bullgarinë ngelen të mira. U miratua Ligji për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet dy shteteve. U themelua qendër e përbashkët për bashkëpunim doganor dhe policor dhe u nënshkrua protokoll për kontrollime të përbashkëta kufitare. Në shtator vendet gjithashtu nënshkruan memorandum për bashkëpunim për integrimin evropian dhe euroatlantik. Çështjet etnike vazhdojnë të jenë sferë e brengosjes.

Përgjithësisht, Republika e Maqedonisë është partner konstruktiv në rajon. Marrëdhëniet bilaterale me vendet fqinje dhe vendet e përfshira në procesin e zgjerimit

vazhduan të përmirësohen. Çështja e emrit vazhdon të ndikojë mbi marrëdhëniet me Greqinë.

3. Kriteret ekonomike

Gjatë shqyrtimit të ngjarjeve në sferën e ekonomisë në Republikën Maqedonisë, Komisioni udhëhoq nga konkluzionet e Këshillit Evropian në Kopenhagë nga qershori 1993, ku përmendej se anëtarësimi në Union imponon ekzistim të ekonomisë funksionale të tregut dhe kapacitet për ballafaqimin me presionin konkurrues dhe forcave të tregut në Union.

3.1. Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut

Bazat e politikës ekonomike

Është mbajtur konsensus i gjerë për bazat e politikës së vendosur ekonomike në vend. Shumë programe e përshkruajnë kornizën afatmesme të politikave. Në janar 2011, autoritetet e dorëzuan programin e tyre të pestë paraaderuese ekonomike, i cili paraqitet kornizë fiskale, makroekonomike dhe fiskale të realizueshme, edhe pse ngandonjëherë optimiste dhe tregoi kapacitete të përmirësuara për përpilim. Autoritetet miratuan program për investime publike 2011-13, Strategji fiskale për 2011-13 dhe Strategji për borxhin publik 2011-13. Gjatë fundit të vitit 2010, Qeveria arriti marrëveshje me FMN-në për linjën kreditore për kujdesshmëri. Kjo kishte për qëllim përforsimin e besimit në tregjet ndërkombëtare. U përmirësua komunikimi me biznes-shoqërinë dhe u themeluan komitete të shumta ekonomike dhe financiare për përmirësimin e dialogut ekonomik. Vazhdoi bashkëpunimi me Bankën Botërore dhe institucione tjera financiare (INF). Reformat strukturore ende zbatoheshin në numër të madh të sferave. Përgjithësisht, është mbajtur koncensus i gjerë politik për bazat e politikës ekonomike.

Stabiliteti makroekonomik

BPV real u rrit për 1,8% në 2010, krahasuar me zvogëlimin prej 0,9% në vitin paraprak. Në 2011, prodhimtaria vazhdoi të rritet për 5,2% në gjysmën

e parë të vitit. Burimet kryesore për zhvillim u zhvendosen nga eksporti neto në gjysmën parë të 2010 dhe tremujorin e parë 2011. Në tremujorin e dytë të vitit 2011, konsumi privat ishte shtytës kryesor i zhvillimit, duke u rritur për 8,4%, ndërsa investimi në pajisje u zvogëluar për 7,5%. Si rezultat i zvogëlimit të investimeve, zhvillimi i importit u ngadalësua në tremujorin e dytë, prej 36,5% në tremujorin e parë në 4,5% në të dytin. Zhvillimi i eksportit gjithashtu u ngadalësua, prej 34,8% në tremujorin e parë në 8,9 në të dytin. Rritja e fortë në gjysmën e tremujorit nga viti 2011 është pasqyrë e bazës së dobët në vitin paraprak. Performansat e prodhimtarisë industriale dhe tregtisë me pakicë sugjerojnë në përshpejtimin e konsiderueshëm vjetor në vitin e parë të 2011. Prodhimi industrial u rinovua në shtatë muajt e parë të vitit 2011, duke u rritur për 8,6% në krahasim me periudhën e njëjtë në vitin paraprak. Megjithatë, niveli gjithëpërfshirës i prodhimtarisë industriale ende është më ulët se para krizës. BPV mesatar për kokë banori ngelet në masë të madhe e qëndrueshme në 2010, në 35% të BE -27. Përgjithësisht, aktiviteti ekonomik filloi të forcohet nga vjeshta e 2010. Megjithatë, shpenzimi i Qeverisë në pjesën e ndërtimtarisë luante rol të kënaqshëm në zhvillimin e shpejtë të bruto investimeve në kapitalin fiks.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse u rrit, duke pasqyruar aktivitetin e rritur ekonomik të vendit. Pas zvogëlimit prej -6,7% të BPV në 2009 në -2,8% në 2010, deficiti i llogarisë rrjedhëse në mesin e 2011 u rrit për afërsisht 3,5% të BPV për 2011. Importi i rritur ishte shkaku kryesor për rritjen e deficitit tregtar. Megjithatë, zhvillimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse ishte shoqëruar me rritje edhe më të madhe të të ardhurave të kapitalit, duke arritur shumën në qershor të 2011 rreth 4,5 % të BPV së vlerësuar vjetor. Dy burimet kryesore ishin të ardhurat e kapitalit lidhur me shfrytëzimin e pjesshëm të kredisë për kujdesshmëri të FMN-së, në shumë prej rreth 3% të BPV dhe të ardhurat në SDI, të cilat në tremujorin e parë 2011 ishin në masë të konsiderueshme më të larta në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë, në tremujorin e dytë, të ardhurat e SDI ishin më të vogla duke i sjellë të ardhurat e SDI gjatë gjysmës së parë të 2011 me 2% të BPM për vitin 2011.

Borxhi bruto i jashtëm ishte afër 60% të BPV në tremujorin e parë të 2011, krahasuar me 56% të BPV në vitin paraprak. Burimi kryesor për zhvillimin ishte borxhi publik, i cili kontribuoi 2,6% pikë përqindjeje të BPV në zhvillim Kreditimi i bankave private e ngritën borxhin e jashtëm për 1,4 % pikë përqindjeje. Rezervat devizore u rritën me 2,0 miliardë (29% të BPV) në gusht, duke pasqyruar zhvillimin e

konsiderueshëm të të ardhurave të SDI, por gjithashtu tërheqje të pjesshme të linjës kreditore për kujdesshmëri, që vendi e ka me FMN. Si rezultat i mbulimit të rezervave të importit potencial u rinovua afërsisht në tre muaj e gjysmë, edhe pse zhvillimi i fortë i importit e kufizoi përmirësimin. Përgjithësisht, bilanci i pagesave të jashtme regjistroi zhvillim të konsiderueshëm në deficitin e llogarisë rrjedhëse, edhe pse kjo ishte më tepër nga kompensimi i të ardhurave më të larta të kapitalit, veçanërisht SDI, ndërsa gjithashtu të kredisve të FMN-së dhe institucioneve tjera ndërkombëtare.

Papunësia ishte shumë e lartë gjatë vitit 2010, në 32% mesatarisht. Në vitin 2011, gjendja e tregut të punës nuk u përmirësua dukshëm, me zvogëlimin e papunësisë në 31,5% në muajin e tretë të 2011. Punësimi u ngrit për 5,5 në vit në tremujorin parë të 2011 (përkatësisht për 34,000 persona) duke krahasuar me zvogëlimin prej 0,4% në vitin paraprak. Sektorë kryesorë në të cilët kishte punësime ishte bujqësia, ndërsa gjithashtu edhe prodhimtaria. Megjithatë, punësimet e reja në bujqësi janë në masë të konsiderueshme rezultat i regjistrimit të bujqve të cilët ekzistojnë nga ajo. Numri i të papunësuarve u ul në 4,8% në tremujorin e parë prej 2011, përkatësisht zvogëlim prej 15,000 persona. Ekziston trend pozitiv të të punësuarit e rinj (grupi i moshës 15-24) me zvogëlimin prej 57,1% në tremujorin parë të 2010 në 52,5 në tremujorin e parë të 2011. Papunësia e të rinjve si pjesëmarrje në papunësinë e përgjithshme u zvogëlua prej 20,1% në 2010 në 17,7% në 2011. Faktor kryesor për këtë zvogëlim ishte zvogëlimi i madh i papunësisë të të rinjtë ndërmjet femrave. Më tutje, qasja më e lehtë në arsimin e lartëndihmoi në zvogëlimin e shkallës së papunësisë. Edhe pse ekzistimi i sektorit të rëndësishëm joformal çon drejt mundësisë për vlerësim të papunësisë faktike, papunësia e madhe ngelet çështje me rëndësi, veçanërisht ndërmjet të rinjve dhe më pak të arsimuarve Përgjithësisht, gjendja në tregun e punës në masë të madhe u përmirësua, por papunësia vazhdon të jetë shumë e madhe, veçanërisht ndërmjet të rinjve dhe më pak të arsimuarve.

Politika monetare me kujdes e përkrahu rimëkëmbjen e shkallshme, ndërsa politika e kursit devizor ngelet e orientuar drejt mbajtjes së stabilitetit të çmimit dhe de fakto lidhjen për euron. Banka Qendrore vazhdoi t'i zvogëlojë shkallët kamatore të politikave kyçe, siç është shkalla kamatore e 28 bonave të thesarit të Bankës Qendrore prej 4,5% në 4%. Përgjithësisht, politika e kursit politik dhe politikës monetare ngelen stabile.

Inflacioni u përshpejtua në tremujorin e tretë të vitit 2010, duke arritur 3,0% në fund të vitit, ndërsa përqindja vjetore në 2010 ishte 1,6% krahasuar me -0,8% në vitin 2009. Faktorët kryesorë të cilët sollën në zhvillimin e fortë kah fundi i vitit 2010 ishin çmimet më të larta për energji, metalet bazë dhe ushqimit. Gjatë tre muajve të parë të vitit 2011, inflacioni i çmimeve të konsumit vazhdoi të përshpejtohet, e udhëhequr nga çmimet e ushqimit dhe shërbimite transportuese. Megjithatë, që atëherë inflacioni filloi të ngadalësohet, duke u zvogëluar në 3,6% në gusht. Kjo solli në inflacionin mesatar prej 4,2% për tetë muajt e parë të vitit. Inflacioni bazë, i cili e përjashton ndikimin e çmimeve të energjisë dhe ushqimit në nivelin përgjithshëm të çmimeve, ishte përafërsisht zero në 2010, ndërsa u rrit afër 1,3% në pesë muajt e parë të vitit 2011.

Politika e përgjithshme fiskale është e orientuar kah arritja e qëllimeve të deficitit. Me qëllim të arritjes së qëllimit për 2,5% deficit për 2010, pushtetarët iu përgjigjën të ardhurave më të vogla nga ato që priteshin me zvogëlimin e shpenzimit të mallrave dhe shërbimeve dhe fuqimisht e kufizuan rritjen e planifikuar të shpenzimit kapital. Rrjedhimisht, qëllimi i deficitit prej 2,5% të BPV për 2010 ishte arritur, edhe pse të ardhurat ishin 7,8% më të ulëta se sa ato të planifikuara. Qëllimi për deficitin për 2011 është 2,5%. Në shtatë muajt e parë të 2011, të ardhurat si pjesëmarrje në BPV ishin në nivel të ngjashëm si viti paraprak, ndërsa shpenzimi ishte në masë të konsiderueshme më i lartë. Kjo solli deri në akumulimin e deficitit të pushtetit qendror në qershor rreth 2% nga BPV vjetore e vlerësuar, krahasuar me deficitin prej 1% të BPV të vitit paraprak. Megjithatë, një pjesë e kësaj rritjeje pasqyron shpenzime në fillim të periudhës, kryesisht në ndërtimtari, lidhur me zgjedhjet e parakohshme në qershor. Autoritetet kanë rezultate të qëndrueshme për arritjen e qëllimit prudent fiskal. Megjithatë, kualiteti i shpenzimit publik vuan nga kapaciteti ende i dobët për planifikim dhe vendime për shpenzime në afat të shkurtër, të cilët e prolongojnë akumulimin e investimit produktiv. Deficiti më i lartë, ndërsa gjithashtu shpenzimi i rritur publik i financuar me marrje të borxhit, kontribuoi për rritjen në raport me borxhin publik prej 31,9% në dhjetorë të vitit 2009 në 35,7% në dhjetor 2010.

Vazhdoi decentralizimi fiskal. Deri në mesin e vitit 2011, 79 nga 85 komuna u avancuan në fazën e dytë të decentralizimit. Më tutje, janë ndërmarrë masa plotësuese për përforcimin e qëndrueshmërisë fiskale të komunave të ngarkuara. Efikasiteti i

administratës publike ende është nën ndikimin negativ të ekipimit të pamjaftueshëm kadrovik, procedurave afatgjate, shkallës së lartë të përfshirjes së politikës që shpie në shkallë të lartë të rotacionit të kuadrit të kualifikuar. Përgjithësisht, politika u orientua kah arritja e qëllimit të tij fiskal, edhe përkundër të ardhurave më të ulëta në krahasim me ato të planifikuara. Profili i harxhimit e mbajti fokusin e tij të transfereve, edhe pse e zvogëloi harxhimin e tij të vazhdueshëm për mallra dhe transfere. Në masë të pakonsiderueshme u rrit shpenzimi kapital, megjithatë efekti i nxitjes së zhvillimit dhe punësimit nga ky investim u zvogëlua për arsye të elementit më të lartë të importuar të shpenzimit.

Si në të kaluarën, politika gjithëpërfshirëse makroekonomike ishte në masë të madhe e qëndrueshme, kushtet monetare ende ishin relative për zhvillim, me atë rast, duke pasur parasysh politikën e vendit për de fakto lidhje për euron. Shpenzimi publik në masë të madhe ishtenë pajtim me të ardhurat. Struktura e shpenzimit ishte gjerësisht e ruajtur, e fokusuar në transfere, me rritje të vogël të investimeve kapitale dhe zvogëlim të mëtejshëm në shpenzimin ekzistues për mallra dhe shërbime. Megjithatë, disa nga investimet kapitale mund të shpenzoheshin në mënyrë në masë të madhe e përkrah rritjen. Përgjithësisht, politika e përgjithshme vazhdoi të jetë e qëndrueshme, duke ngelur e orientuar kah stabiliteti, duke tentuar që ta përkrah rimëkëmbjen. Megjithatë, kualiteti i financave publike nuk janë më të mira në masë të konsiderueshme dhe çështja e papunësisë së madhe, veçanërisht ndërmjet të rinjve, paraqet sfidë kryesore.

Veprimi i ndërsjellë i forcave të tregut

Privatizimi në masë të madhe është kryer dhe ekonominë, kryesisht, e lëvizin forcat e tregut. Pjesëmarrja e aktiviteteve shtetërore ngel në masë të madhe e pandryshueshme, megjithatë si rezultat kryesor i zvogëlimit të aktiviteteve private, pjesëmarrja e sektorit privat u zvogëlua, prej 87% nga vlera e përgjithshme e shtuar në 2008 në 86% në 2009. Lidhur me punësimin, pjesëmarrja e punësimit në sektorin privat u zvogëlua prej 77,8% në 2009 në 77,2% në 2010. Pjesëmarrja e çmimeve të administruara dhe të rregulluara në shportën e IPC ishte zvogëluar prej 14,4% në 2009 në 13,1% në 2010, pjesërisht për arsye të ndryshimeve në shportën e IPC. Pjesa më e madhe e atyre çmimeve të administruara dhe të rregulluara janë mbulim të shpenzimeve. Vlera e aktivës së kompanive të cilat në tërësi ose pjesërisht të kontrolluara nga ana e shtetit ngelet rreth 13,5% të BPV. Pjesa më e madhe e këtij kapitali, përfaqësisht 80% është koncentruar në pesë kompani, kryesisht ndërmarrje publike, siç janë prodhimtaria dhe bartja e energjisë elektrike, ku shteti është pronar i shumicës dhe i telekomunikacionit, ku shteti është pronar i pakicës në kompani profitabile dominante për telekomunikacione. Përgjithësisht, si rezultat i krizës, u rrit roli i shtetit, ndërsa pronësia shtetërore ngelet e koncentruar kryesisht në shërbimet publike të telekomunikacionit dhe ato energjetike.

Hyrja dhe dalja në treg

Qeveria vazhdoi me ndërmarrjen e hapave për lehtësimin e hyrjes dhe daljes në treg. Ka përfunduar faza e dytë e sistemit njësportel, posaçërisht me përmirësimin e mundësive për regjistrim elektronik të hipotekave, procedurave të falimentimit, dërgimin e dokumentacionit etj. Në mënyrë plotësuese janë zvogëluar shpenzimet për regjistrim. Vazhdon zbatimi i fazës së tretë të ashtuquajturës "gjiljotina e biznesit" e cila ka për qëllim thjeshtësimin e rregullativës. Kontakti me bashkësinë e biznesit u përforcua. Vazhdoi procesi i mbylljes së kompanive të paqëndrueshme. Në gjysmën e dytë të vitit 2010, numri i procedura për falimentim ishte rreth një e katërta më i lartë në krahasim me vitin e kaluar. Mirëpo, gjatë vitit 2001 numri i procedurave të reja për falimentim përsëri u zvogëlua në nivelin para krizës. Si rezultat i rritjes së shpejtë të numrit të procedurave për falimentim, numri i procedura për falimentim të ngecura u zmadhua në gjysmën e dytë të vitit 2010, nga 338 lëndë në fund të vitit 2009 në 358 lëndë në fund të vitit 2010. Ende ekziston hapësirë për shkurtimin e mëtejshëm të procedurave për falimentim. Përgjithësisht, progres i caktuar i mëtejshëm është arritur në zvogëlimin e pengesave për hyrje dhe dalje në treg.

Sistemi juridik

Sistemi juridik për ekonomi funksionale të tregut në masë të madhe është vendosur. Janë marrë hapa për përmirësimin e efikasitetit të gjykatave, për rritjen e transparencës së vendimeve gjyqësore, për përshtetimin e procedurave juridike dhe për përmirësimin e zbatimit të marrëveshjeve, përmes bartjes së kompetencës për urdhër pagesën te noterët. Regjistrimi i të drejtave të pronësisë për patundshmëri praktikisht ka përfunduar. Numri i rasteve gjyqësore të pazgjithura është zvogëluar prej 6014 raste në fund të vitit 2009 në 5492 raste në fund të vitit 2010. Gjithashtu, është zvogëluar

kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, me përqindje të madhe të rasteve të zgjidhura në afat prej tre muajve nga 25% në vitin 2009, në 36% në vitin 2010, ndërsa përqindja e rasteve me kohëzgjatje më të madhe se një vit, prej 17% në vitin 2009 në 13% në vitin 2010. Zbatimi i marrëveshjeve ende shkon shumë vështirë, ndikim negativ mbi rrethin e biznesit veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vendosja e furnizimit elektrik e rriti transparencën e shpenzimeve publike. Megjithatë, edhe krahas pavarësisë së përforcuar juridike dhe financiare të trupave rregullator dhe mbikëqyrës, kapacitetet administrative dhe rezultatet nga realizimi i disa prej këtyre institucioneve, siç janë Agjencia për rregullimin e komunikacionit hekurudhor, trupat rregullator për energjetikë dhe telekomunikime, agjencitë për rregullimin dhe për mbikëqyrjen e sigurimit pensional me financim kapital dhe komisioni për letra me vlerë ende duhet të përforcohen. Përgjithësisht, funksionimi i sistemit juridik është përmirësuar, që do të duhet të ketë ndikim pozitiv në biznes klimën e investimeve. Megjithatë, dobësitë me sundimin e së drejtës, posaçërisht në gjyqësor, e cila karakterizohet me procedura të ngadalshme, mjete të pamjaftueshme dhe zbatim të pasigurt të marrëveshjeve, si dhe korrupsioni i shpërndarë vazhdojnë të kenë ndikim negativ mbi biznesin.

Zhvillimi i sektorit financiar

Rëndësia dhe funksioni ndërmjetësues i sektorit financiar janë rritur, duke pasqyruar kapital plotësues nga investitorët e huaj por edhe nga depozita i rritur i huamarrjes. Në sektorin bankar, aktiva e përgjithshme si pjesë e BPV u zmadhua prej 67% në mesin e vitit 2010 në 69% nga BPV i vlerësuar në mesin e vitit 2011. Kreditë si pjesëmarrje nga BPV u zmadhuan prej 43,5% në tetor 2010 në disa 45% nga BPV i vlerësuar në fund të gushtit 2011, derisa niveli i depozitave u rrit nga 48% në fund të tetorit 2010 në rreth 50% nga BPV i vlerësuar në gusht 2011. Depozitat vazhdojnë të jenë burimi i vetëm i likuiditetit në sektorin. Mbulimi i kredive me depozita është ende mbi 100%. Sektori në pjesën më të madhe vazhdon të jetë në procesi të kompanive të huaja, me 14 prej gjithsej 17 bankave në pronësi të huaj. Pjesëmarrja në pronësi të huaj është zmadhuar prej 68,6% në fund të vitit 2009 në 78% në mesin e vitit 2011. Pjesëmarrja pronësore e shtetit në sektor mbetet e vogël, me 7% nga aktiva e sektorit. Prona kryesore e shtetit përbëhet nga pjesëmarrja e shumtë në bankën e vetme për zhvillimin shtetit dhe nga numri i kufizuar i pak aksioneve të mbetura. Koncentrimi i tregut mbetet i lartë, por i njëjti është zvogëluar në vitin e fundit. Aktiva e pesë bankave e më të mëdha si pjesëmarrje nga aktiva e përgjithshme u zvogëluar vetëm në nivel marginal prej 77,4% në fund të vitit 2009 në 77,2% në fund të vitit 2010. Por, tre bankat më të mëdha humbën pjesë të tregut në llogari të bankave me madhësi të mesme. Efikasiteti i sektorit bankar në masë të madhe mbetet i pandryshueshëm. Profiti në sektorin në tërësi mbetet i ulët, me kontribut të vogël të mjeteve dhe kapitalit aksionar në tremujorin e parë, dhe profit të vogël në tremujorin e dytë (0,2% prirje të mjeteve, dhe 2,1% prurje të kapitalit aksionar). Por, bankat më të mëdha kanë pasur sukses më të madh se sa të voglat. Rritja kreditore u përshpejtua nga vjeshta e kaluar, duke arritur 8% në muajin gusht. Nivelet e rregulluara të kamatës nga sektori privat u zvogëluar pas nivelit të tyre më të lartë në tremujorin e fundit të vitit 2009. Shkallët për kreditë në denarë u zvogëluar prej 9,2% në shtator 2011, në 8,9% në korrik 2011, derisa nivelet e depozitave në denarë u zvogëluar prej 6,8% në 5,8%. Si rezultat i rënies së shpejtë të niveleve të kamatës së depozitave, shtrirja u rrit prej 2,4 pikë përqindje në shtator 2010 në 3,1 pikë përqindje në korrik 2011. Pjesëmarrja e moskryerjes së obligimeve kreditore të përsëri filloi që të zvogëlohet, nga më të lartat 10,6% në shtator 2010 në 9,3% në fund të vitit 2011.

Rregullimi i supervizionit në sektorin bankar në masë të madhe janë të ngjashme me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, funksionimi i drejtë i trupave rregullatorë dhe mbikëqyrës, siç janë Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital (MAPAA) dhe Kompania për letra me vlerë (KLV) ende pengohet për shkak të pavarësisë së pamjaftueshme financiare dhe/ose resurseve të pamjaftueshme njerëzore dhe informatike. Gjithashtu, në disa raste nuk janë mjaft të definuara edhe kompetencat institucionale të të njëjtave. Si rezultat i kësaj, ndikimi i këtyre institucioneve ende nuk paarritur nivel adekuat. Transparenca e tregut kreditor është përmirësuar përmes vendosjes së byrosë kreditore private, e cila përpilon raporte për historinë kreditore.

Relevanca e ndërmjetësuesve tjerë të tregjeve financiare është kufizuar, me mjete të cilat janë rreth 10% nga mjeti i përgjithshëm i sektorit financiar ose 8% të PBV. Kompanitë e sigurimit kanë rreth 4% të mjeteve të sektorit, ndërsa lizing kompanitë dhe fondet e pensioneve rreth 3% secila. Vlera e tregut të kapitalit është rreth 30% të BPV.

Përgjithësisht, sektori financiar vazhdoi procesin gradual të thellimit dhe përhapjes së tij. Megjithatë, niveli i negociatave financiare dhe konkurrencës së tregut ngeli në nivel të ulët, duke penguar rritjen më dinamike të sektorit privat, veçanërisht të NVM. Përveç kësaj, trupa të veçantë rregullator dhe mbikëqyrës ende nuk kanë arritur nivelin përkatës të pavarësisë, dispozicionin me mjete dhe ndikim.

3.2. Kapaciteti për menaxhim me presionin e konkurrencës dhe fuqitë e tregut në Union

Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut

Përgjithësisht, stabiliteti makroekonomik u mbajt edhe përpos turbulencave ekonomike globale të vazhdueshme. U avancuan procedurat për hyrje dhe dalje në treg dhe u përforcua sundimi i së drejtës. Megjithatë, struktura e jobaraspeshës së tregut të punës ende është shumë e theksuar dhe rrethina afariste ende pëson nga gjyqësori i ngadalshëm dhe numri i madh i institucioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse të dobëta dhe jomjaft të pavarura.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Niveli i dispozicionit të kapitalit njerëzor ende është i vogël. Organet vazhdojnë të përmirësojnë infrastrukturën fizike për arsimimin dhe kornizën rregullatore, me qëllim të avancohet suksesi i sistemit arsimor. Numri i arsimtarëve u rrit për 4,4% në vitin 2010, veçanërisht në shkollat fillore dhe të mesme. Shkalla e regjistrimit u përmirësua. Shpërndarja buxhetore për arsim shënoi rritje, prej 3,7% të BPV në Buxhetin për vitin 2010, deri në 3,8% në Buxhetin për vitin 2011. Si edhe paraprakisht, shpenzimi u fokusua në rinovimin dhe ndërtimin e objekteve shkollore dhe blerjen e pajisjes kompjuteristike. Përkundër këtyre përpjekjeve, niveli i përgjithshëm i arsimit dhe trajnimit të forcës punëtore ende është në nivel relativisht të ulët dhe jo kompatibil me aftësitë, ende është e konsiderueshme. Ngjel e konsiderueshme hapësira për përmirësim të efikasitetit të shpenzimeve publike për arsim dhe për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Përgjithësisht, masat për përmirësimin e nivelit të kualifikimit vazhdojnë. Megjithatë, për shkak të nivelit të ulët të arsimit, nevojiten përpjekje të qëndrueshme me qëllim përmirësimin e kapitalit njerëzor në shtet.

Dispozicioni i kapitalit në shtet vazhdon të jetë në nivel relativisht të ulët dhe cilësia e tij rekomandohet nga dekadat paraprake të investimit të zvogëluar. Niveli i ulët i arsimit dhe dispozicioni i vogël i kapitalit kontribuojnë për nivel përgjithësisht të ulët të produktivitetit. Progres i caktuar plotësues është arritur në përmirësimin e infrastrukturës transportuese. Bruto investimet në kapitalin fiskal treguan përshpejtim të dukshëm në gjysmën e dytë të vitit 2010 dhe veçanërisht në tremujorin e parë të vitit 2011. Megjithatë, niveli i përgjithshëm i investimeve në vitin 2010 dhe fillim të vitit 2011 ende janë më të vogla në raport me vitin e kaluar. Pjesëmarrja e investimeve të huaja ngjel në 51% të BPV. Të ardhurat nga investimet e huaja të drejtpërdrejta dukshëm u rritën në tremujorin e katërt të vitit 2010 dhe në tremujorin e parë të vitit 2011, por ishin më të vogla në tremujorin e dytë. Përgjithësisht, interesi i investuesve të huaj në shtet përmirësohet. Në disa raste, ekzistojnë procedura juridike kontestuese, si ato të cilat përfshijnë lejet për punë për punëtorë të huaj, ose ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal, vazhdon të jetë

pengesë për SDI. Shpenzimi për përforcimin e ekonomisë bazuar në njohuri ende ngel në nivel të ulët. Akumulimi i kapitalit themelor është penguar nga kapacitetet e dobëta për zbatim, por gjithashtu edhe nga përdorimi i mjeteve për dedikime më pak produktive, siç janë zbulimi i kryeqytetit. Përgjithësisht, kapitali themelor i shtetit vazhdon të jetë i ulët. Infrastruktura është përmirësuar, por edhe atje nevojiten korrigjime dhe modernizim.

Struktura e sektorëve dhe struktura e ndërmarrjeve

Nuk ka ndryshime më të mëdha në sferën e ristrukturimit të ndërmarrjeve. Industrinë e rrjeteve, si hekurudha, prodhimi dhe transportimi i energjisë ende, deri në shkallë të caktuar janë në pronësi shtetërore. Ndryshimet e para do kohëve të Ligjit për energjetikë të miratuar në pranverën e vitit 2011, do të duhet të rrisin konkurrencën dhe transparencën në sektorin e energjetikës. Në tregun e gazit dhe energjisë elektrike dominojnë numër shumë i vogël i furnizuesve, të cilët e minojnë konkurrencën e suksesshme. Në sektorin e telekomunikimeve, u rrit numri i ofruesve të shërbimeve, që rezultoi me pjesëmarrje më të vogël në treg të operatorit dominues për telefoni fikse dhe celulare. Nuk ka ndryshime të dukshme strukturore në sektorin e transportit.

Vëmendja e aktivitetit ekonomik vazhdon të largohet nga prodhimi kah shërbimet, veçanërisht në tregtinë me pakicë dhe gjithashtu edhe në ndërtimtari. Prodhimi e rriti pjesëmarrjen e vet nga 12,4% të BPV në tremujorin e dytë të vitit 2009, në 14,4% në tremujorin e katërt të vitit 2010, ndërsa ndërtimtaria u rrit prej 5,6% në 7,8% të BPV. Njëkohësisht, pjesëmarrja e vlerës së shtuar në bujqësi u zvogëlua prej 12,8% në 10,9% të BPV. Lidhur me punësimet, bujqësia shënon numër të zmadhuar të punësimeve në tremujorin e katërt, duke rritur pjesëmarrjen e vet prej 16,7% të të punësuarve në 19,2%, ndërsa pjesëmarrja e prodhimit në vlerën e përgjithshme u ul prej 23,9% në 22,5% gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009. Rritja e punësimeve në bujqësi dhe ulja njëkohësisht e produktivitetit në këtë sektor sugjeron në pjesëmarrje të rëndësishme të vendeve të punës "administrative", dhe jo të kapaciteteve të reja.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) deri më tani janë grupi më i rëndësishëm i kompanive, duke siguruar punësimin e rreth 82% të , të punësuarve në sektorin privat ose 56% të punësimin të përgjithshëm. Gjatë vitit 2010, në pajtim me uljen e përgjithshme të aktivitetit ekonomik, numri i NVM u ul në 8,3%. Kjo kryesisht reflekton rënien e ashpër të numrit të mikro - ndërmarrjeve, ndërsa rritet numri i NVM më të mëdha. Lidhur me punësimin, numri i të punësuarve u rrit për 1,5% gjatë vitit 2010, ndërsa, në mesin e kompanive më të mëdha, punësimi i zvogëlua në 14%. Dispozicioni i financimit të NVM nga ana e BEI me vlerë prej 100 milion euro përmirësuan qasjen deri te mjetet financiare. Përpos kësaj, Qeveria subvencionoi shpenzimet e normave të interesit për NVM të orientuara kah eksporti dhe rriti mjetet buxhetore për programet për mbështetjen e NVM.

Sektori jo formal mbështetet me dobësitë e politikës tatimore dhe politikës së konsumit publik, si dhe zbatimi i ligjeve, duke përfshirë edhe luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kjo ul bazën tatimore dhe suksesin e politikave ekonomike.

Përgjithësisht, ndryshimet strukturore drejt diversiteteve dhe aktiviteteve me vlerë të shtuar më të madhe ngelin të kufizuara. Konkurrenca në rrjetin industrial ngel e kufizuar me furnizues të përhershëm dominues. NVM përballen me vështirësi në qasjen deri te kapitali dhe tregu edhe përveç mbështetjes së zmadhuar. *Ndikimi i shtetit mbi konkurrencën*

Niveli i përgjithshëm i intervenimit sistematik shtetëror është i kufizuar. Të dhënat zyrtare sugjerojnë për nivei relativisht të ulët të ndihmës shtetërore, që është më pak se 1% e BPV. Megjithatë, kjo shifër nuk krahasohet me të dhënat për ndihmë shtetërore të grumbulluara në pajtim me standardet e BE-së. Është vendosur organizimi institucional për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe çështjeve të konkurrencës, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës.

Megjithatë, disponimi i vazhdueshëm i resurseve ende nuk mjafton të mbulojë tërë përfshirjen e përgjegjësive të agjencisë. Gjithsej, ndikimi i shtetit mbi konkurrencën ngel i kufizuar.

Integrimi ekonomik me BE-në

Shteti ka ekonomi të vogël, të hapur, me tregti të përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve të përmirësuar në nivel prej 114% të BPV gjatë vitit 2010, pas recesionit të vitit 2009. Integrimi tregtar me BE-në është përmirësuar, me rreth 63% të eksportit të përgjithshëm i cili për momentin shkon në BE dhe rreth 53% të importit që vjen nga BE. Rajoni i CEFTA-s është i dyti për nga rëndësia për shtetin, i cili përbën rreth 24% të eksportit dhe rreth 10% të importit. Struktura eksportuese ngel tepër e përqendruar në numër të caktuar të produkteve, në të cilat prodhimet e tekstilit dhe veshja marrin pjesë me rreth 17% nga eksporti i përgjithshëm, ndërsa produktet e përpunuara të hekurit me 26% gjatë vitit 2010, ndërsa prodhimet nga hekuri me rreth 26%. Pjesëmarrja e IHD-së u rrit në rreth 51% të BPV, me Holandën, Slloveninë dhe Austrinë si investues më të mëdhenj. Gjithsej, shtetet e BE-së përfshijnë rreth 60% të të ardhurave të përgjithshme të IHD-së. Zvicra, Turqia dhe Serbia janë investues të rëndësishëm të cilët nuk janë pjesë e BE-së. Kursi devizor në raport me euron qëndron stabil në kushte minimale. Konkurrenca e çmimeve ngel në masë të madhe e pandryshueshme. Gjithsej, integrimi tregtar me BE-në ka progres të mirë, por eksporti ngel i përqendruar në disa produkte me çmime të ndishme. Konkurrenca e çmimeve në suaza ndërkombëtare ngel në masë të madhe e pandryshueshme.

4. AFTËSIA QË TË NDËRMERREN OBLIGIME NGA ANËTARËSIA

Në këtë pjesë analizohet aftësia e Republikës së Maqedonisë për marrjen e obligimeve nga anëtarësia - respektivisht *acquis*, siç është shprehur përmes marrëveshjeve, legjislacionit sekondar dhe politikave të Unionit. Gjithashtu analizohet kapaciteti administrativ i Republikës së Maqedonisë që të zbatojë *acquis*. Analiza është strukturuar në pajtim me listën e 33 kapitujve të *acquis*. Në secilin sektor, vlerësimi i Komisionit e përfshin progresin e arritur gjatë periudhës për të cilën raportohet dhe përmbledhet niveli i gadishmërisë së shtetit.

4.1. KREU 1 Lëvizja e lirë e mallrave

Progres i caktuar mund të vërehet në lidhje me **parimet e përgjithshme**. Nga gjithsej 42 masa të theksuara në suazat e planit aksional për arritjen e harmonizimit me nenet 34 deri në 36 të TFEU, 14 masat të cilat kanë efekt të barabartë të kufizimeve kuantitative të importit dhe eksportit janë ndryshuar ose abroguar. Ekziston prolongim i qartë i zbatimit të planit aksional.

Ekziston progres në sferën e **masave horizontale**. Strategjia me indikatorët për zbatimin e *acquis* për institucionet përkatëse horizontale është përcjellë nga afër dhe zbatuar përmes planeve vjetore për punën e institucioneve infrastrukturore kualitative.

Në sferën e standardizimit, është arritur progres i mirë. U miratuan standardet Evropiane dhe ndërkombëtare në sferën e makinerisë, prodhimeve dhe proceseve ndërtimore, kimikaleve, ushqimit dhe aparateve elektroteknike. Standardet Evropiane (EC) 21,131 janë miratuar si standarde kombëtare, kryesisht me pranim. Gjithsej 2998 standarde kombëtare ofrojnë parakushte për harmonizim me direktivat për Qasje të re. Paraqitja e standardeve të BE-së dhe dokumenteve lidhur me standardizim të Komiteti Evropian për Standardizim (CEN) dhe Komiteti Evropian për Standardizim Alektroteknik (CENELEK) vazhdoi, si dhe heqja e standardeve konfliktuoze.

Numri i anëtarëve të kuvendit të Institutit për Standardizim (ISRM) u rrit në 90. Kapaciteti administrativ qëndron i pamjaftueshëm, veçanërisht në drejtim të obligimit ndaj ISRM si anëtare e plotfuqishme të CEN/CENELEK. ISRM nënshkroi marrëveshje për bashkëpunim me institucionet për standardizim të Francës, Azerbajxhanit dhe Ukrainës. Qeveria nuk alokon mjaft mjete për anëtarësim në Organizatat Evropiane për Standardizim, në kundërshtim me Ligjin për standardizim. Deficiti mbulohet me mjete modeste të ISRM.

Pas Ligjit të ri për akreditim dhe rekomandimeve të Bashkëpunimit evropian për akreditim (EA), Instituti për akreditim (IARM) i ndryshoi Kartën e vet dhe rregulloret e shumta dhe dokumentet për procedura. IARM momentalisht ka punësuar 16 punëtorë me orar të plotë të punës, 16 vlerësues udhëheqës, 64 vlerësues teknik dhe 44 ekspertë. Deri më 1 shtator të vitit 2011, IARM ka akredituar gjithsej 76 trupa për vlerësimin e harmonizimit dhe tërhoqi 11 akreditime. Shumica e akreditimeve të ndara në vitin 2010 kanë të bëjnë me laboratorë për hulumtim dhe kalibrim dhe trupa për inspektim. Buxheti operativ i IARM për vitin 2011 u rrit për 77% krahasuar me vitin 2010. Resurse të konsiderueshme janë shpërndarë për blerjen e pajisjes. Marrëveshje multilaterale për laboratorë për hulumtime, për kalibrim, trupa për inspektim dhe trupa për certifikim të prodhimeve me EA ende nuk janë nënshkruar.

Në drejtim të vlerësimit të harmonizimit, numri i trupave për vlerësimin e harmonizimit u rrit në gjithsej tetë. Ligji për siguri u revidua në vitin 2011, por ende nuk është harmonizuar me komizën horizontale të *acquis* të vitit 2008 (komiza e re ligjore).

Në sferën e *meteorologjisë*, Ministria e Ekonomisë përcaktoi tetëmbëdhjetë standarde të reja për instrumente për matje dhe miratoi dispozita për matësit e alkoolit dhe hidromatës alkooli, si dhe për kushtet elementare për shishet që përdoren si enë për matje, me qëllim që të transponohet legjislacioni përkatës i BE-së. Gjatë vitit 2010 numri i certifikatave për kalibrim të dhëna nga ana e Byrosë për meteorologji (BM) u rrit për 35% krahasuar me vitin 2009. Buxheti operativ i BM-së për vitin 2011 u rrit për afërsisht 59%, pothuajse 1,6 milionë euro. Pjesa më e madhe e buxhetit është shpërndarë për furnizim me pajisje për laboratorët e BM-së. Mirëpo, pajisja në laboratorë nuk kalibrohet rregullisht dhe asnjëra nuk është e akredituar. Rritja e planifikuar e personelit nuk ndodhi dhe kapaciteti administrativ ngeli i pamjaftueshëm.

Gjatë vitit 2010, Inspektorati Shtetëror i Tregut (ISHT) realizoi gjithsej 331 veprime inspektuese. Si rezultat i kësaj, imponoi gjithsej 75 masa korigjuese dhe ngriti 10 procedura për kundërvajtje. ISHT e rriti efikasitetin e veprimeve të saj inspektuese me ndryshimin e praktikave të brendshme operative. Pastaj, e përmirësoi transparencën e vet me vënien në përdorim të ueb faqes dhe mundësoi paraqitjen e ankesave në formë elektronike për qytetarët. Gjithashtu botoi broshura për konsumatorët dhe bizneset dhe "Doracak nëpër ISHT". Programi kombëtar për koordinimin dhe marrjen e masave efektive për hulumtim të tregut për periudhën 2011- 2012 u miratua në nëntor të vitit 2010, ndërsa Memorandumi për mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërmjet organeve doganore dhe organeve për hulumtim të tregut u nënshkrua në shkurt të vitit 2011. Anëtarët e trupit koordinues për hulumtim të tregut u emëruan, dhe në janar të vitit 2011, ndërmorën veprime të përbashkëta nga ana e organeve të hetimit të tregut për hulumtimin e prodhimeve të caktuara (p.sh. lojëra për fëmijë, preparate mjekësore dhe pajisje telekomunikuese). Mirëpo, organet e hulumtimit të tregut ende kanë resurse njerëzore dhe kapacitete financiare të kufizuara për realizimin e kontrollit të gjerë të prodhimeve për harmonizim teknik. Ekziston progres në sferën e masave horizontale.

Progres i dobët vërehet edhe në sferën e legjislacionit për prodhimet "Qasja e vjetër". U miratua Ligji i ri për kimikale, por transponomi i plotë i legjislacionit të BE-së në këtë sferë prej fillimi duhet të sigurohet përmes zbatimit të legjislacionit. Kanë progres përgatitjet në sferën e legjislacionit për prodhimet nga qasja e vjetër.

Është realizuar progres i caktuar në sferën e legjislacionit për prodhime në pajtim me "Qasjen e re dhe globale". Rregulloret për siguri të lojërave për fëmijë dhe zejtarisë rekreative, si dhe radio pajisjes dhe pajisjes terminale telekomunikuese dhe aktet nënligjore për pajisje mjekësore hynë në fuqi. Harmonizimi i tyre me *acquis* duhet të konfirmohet fillimisht. Në sferën e legjislacionit për Qasje të re dhe globale për prodhimet, vendi ka përparuar.

Progres mund të shënohet edhe në sferën e **masave procedurale**. Në këtë sferë vendi ka përparuar..

Konkluzion

Është realizuar progres i caktuar në sferën e lëvizjes së lirë të mallrave, veçanërisht në sferën e miratimit të EN standardeve dhe aktiviteteve operative të ISHT-së. Buxheti për zbatimin e strategjisë gjithëpërfshirëse për institucionet horizontale është zmadhuar. Mirëpo,

legjislacioni kornizë ende nuk është harmonizuar tërësisht me *acquis* në sferën e lëvizjes së lirë të mallrave. Institucionet e obliguara për infrastrukturë cilësore ende nuk kanë mjete financiare të mjaftueshme për zhvillim dhe financim të bashkëpunimit me partnerët e tyre relevantë të BE-së. Fillimisht duhet siguruar anëtarësim i plotë dhe shkëmbim efikas i të dhënave me trupat përkatës të BE-së. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e lirisë së lëvizjes së mallrave shënojnë progres relativ.

4.2. KREU 2 Lëvizja e lirë e punëtorëve

Nuk shënohet progres në sferën e **qasjes në tregun e punës**. Qeveria miratoi Vendim me të cilin rregullohet numri i lejeve për punë në 3000, të cilat duhet të lëshohen për të huaj gjatë vitit 2011 dhe u lëshuan 1146 leje pune për shtetas të huaj në gjysmën e parë të vitit. Ligji për nëpunës shtetërorë mbetet të ndryshohet, me qëllim që t'u mundësohet qytetarëve të BE-së qasje te vendet e punës në shërbimin publik. Fillojnë përgatitjet në këtë sferë.

Është bërë progres i caktuar në lidhje me përgatitjen për pjesëmarrje të shtetit në **EURES** (Shërbime Evropiane për Punësim) rrjetin. U implementua plani aksional që i thekson masat dhe aktivitetet për pjesëmarrje në EURES. Kapaciteti administrativ i Agjencisë për punësim u përforcua me punësim edhe të dy personave tjerë. Në vijim janë përgatitjet në këtë sferë.

Mund të vërehet edhe progres i vogël në sferën e **koordinimit të sistemeve për sigurim social**. U zbatua trajnim për t'u përforcuar kapaciteti i organeve publike. Hyri në fuqi marrëveshja me Malin e Zi për koordinimin e sistemeve për sigurim social. Përgatitjet në këtë sferë kanë progres mesatar.

Ekziston progres i vogël në sferën e **Kartelës evropiane për sigurim shëndetësor (KESSH)**. Marrëveshja me Belgjikën për përdorimin e KESSH hyri në fuqi në korrik të vitit 2011. Përgatitjet në këtë sferë janë në fazë të hershme.

Konkluzion

Ekziston progres i vogël në sferën e lirisë së lëvizjes së punëtorëve. Harmonizimi me *acquis* është në fazë të hershme.

4.3. KREU 3 E drejta për themelim dhe liri të ofrimit të shërbimeve

Mund të vërehet progres në sferën e **të drejtës për themelim**. Është miratuar legjislacioni për zbatim me qëllim të që thjeshtësohen procedurat për dhënie e lejeve. Janë bërë përpjekje për eliminimin e formaliteteve dhe barrierave të panevojshme administrative. Është mundësuar thjeshtësim elektronik i kërkesës për themelim. Regjimi i licencave në pajtim me ndryshimet e Ligjit për ndërtim ende nuk janë harmonizuar me *acquis*.

Në aspekt të direktivave për shërbim të cilat kanë ndikim në themelimin dhe shërbimet tejkufitare, Ligji për turizëm është ndryshuar për t'u mundësuar licencimi automatik, mirëpo, kushtet për licencim të ciceronëve turistikë ngelin të njëjta. Plani aksional për harmonizim me direktivat për shërbime është azhurnuar, ndërsa zbatimi është në vijim. Ligji horizontal për transponimin e direktivës për shërbime ende nuk është miratuar dhe nuk është miratuar ende "Sistemi njësportel". Koordinimi ndërmjet organeve kompetente nën udhëheqjen e Ministrisë së Ekonomisë është përmirësuar. Pushteti lokal dhe gjyqësor ende nuk janë pjesë e procesit të koordinimit që ka për qëllim t'i rrisë njohuritë nga praktika gjyqësore Evropiane për shërbimet relevante.

Është arritur progres në sferën e **lirisë për sigurimin e shërbimeve tejkufitare**. Ligji për tregti është ndryshuar për t'u harmonizuar me direktivat për shërbime. Ligji për kadastër të patundshmërive është ndryshuar, me mënjanimin e kushteve për reciprocitet dhe përkatësi nacionale, dhe me këtë rast janë siguruar shërbime tejkufitare. Operuesit e huaj duhet të sigurojnë degë ose filial me qëllim të sigurimit të shërbimeve në shtet, që nuk është në pajtim me *acquis*. Nuk ekziston dispozitë ligjore e përgjithshme në fuqi e cila mundëson sigurimin e shërbimeve tejkufitare. Edhe pse kushtet për reciprocitet për

persona juridikë të BE-së janë mënjeluar, kushti për përkatësi nacionale ende është i pranishëm në disa sektorë, përfshirë edhe veterinarinë, arsimin privat, turizmin dhe profesorët ordinarë. Ekziston vetëdije për obligimet të cilat dalin nga *acquis*. Mirëpo, kapaciteti administrativ i organeve të ndryshme kompetente ngel në nivel të pakënaqshëm. Në sferën e shërbimeve tejkufitare kanë filluar përgatitjet.

Mund të vërehet progres i konsiderueshëm në sferën e **shërbimeve postare**. Më 6 dhjetor të vitit 2010 u miratua Ligji i ri për shërbime postare, ndërsa shkalla e harmonizimit me *acquis* postare ka progres të konsiderueshëm. Nevojitet punë e mëtejme, veçanërisht për hapjen plotësuese të tregut, periudhës së emërimit, financimit dhe neto shpenzimeve të obligimit për shërbim të përgjithshëm. Përpos legjislacionit të miratuar primar, Agjencia për posta vazhdoi me miratimin e legjislacionit relevant i cili duhet të zbatohet. Tregu i postave shënon rritje, ndërsa paraqiten shumë operatorë që për momentin janë aktivë në treg. Megjithatë, gjithashtu, është me rëndësi të përforcohet inspektimi i tregut me qëllim që të ndalohet anashkalimi i kërkesave ligjore aktuale. Deri në vitin 2015 pritet liberalizimi i plotë i shërbimeve postare. Ofruesi i emëruar i shërbimeve të përgjithshme postare që e mban monopolin e shërbimeve nën 50g e përmirësoi punën, por është e nevojshme përmirësimi plotësues i shërbimeve. Kanë filluar përgatitje për privatizim të pjesës së ofruesit të emëruar të shërbimeve postare i cili për momentin është tërësisht në pronësi shtetërore. Agjencia e postave si trup rregullator nacional disponon me mjaft të punësuar dhe financohet vetë. Rregullatori i përmirëson kapacitetet e inspektimit të ofrimit të shërbimeve të përgjithshme postare dhe në këtë kontekst, gjithashtu, implikoi mjete juridike rregullatore. Ai përcakton procedura për zgjidhjen e kontesteve dhe i rrit kapacitetet e veta për t'i zbatuar vendimet. Bashkëpunimi me organet kompetente është në nivel të kënaqshëm. Kapaciteti për krijimin e politikave të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në sferën e shërbimeve postare ngel i dobët. Në sferën e shërbimeve postare shteti është në rrugë të mirë. Është vërejtur progres në sferën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**. Është miratuar Ligji për njohjen e kualifikimeve profesionale që i dallon kualifikimet profesionale dhe akademike. Megjithatë, nuk është tërësisht i harmonizuar me direktivën për njohjen e kualifikimeve profesionale, veçanërisht në lidhje me mobilitetin e përkohshëm. Përpos kësaj, kushtet në lidhje me gjuhën nacionale dhe reciprocitetin ngelin në legjislacion me të cilin rregullohen dallimet profesionale. Zbatohet Plani aksional për shpërblimin e sistemit për njohje të përbashkët. Akoma nuk është formuar grupi për koordinim ndërmjet organeve kompetente. Ende nuk është emëruar koordinuesi nacional i organeve kompetente dhe institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve profesionale siç kërkohet me direktivën për kualifikime profesionale. Ende duhet të arrihet harmonizimi me direktivat për avokaturë dhe të *acquis* për agjent tregtar dhe prodhime toksike.

Konkluzion

Në sferën e drejtësisë së themelimit dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve, shteti është në rrugë të mirë, veçanërisht në sferën e shërbimeve postare. Niveli i koordinimit ndërmjet organeve përgjegjëse të ndryshme për miratimin e shërbimeve tejkufitare shënon progres. Në sferën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, shteti është në fazë të hershme. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e të drejtës për themelimin dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve janë në fazë të hershme.

4.4. Kreu 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Vendi tanimë i ka plotësuar kërkesat nga faza e parë e Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim (MSA) më 2008 në sferën e **lëvizjes së kapitalit dhe pagesave**. Liberalizimi i mëtejshëm kushtëzohet nga kalimi në fazën e dytë të MSA-së në pritjen e vendimit nga Këshilli. Përparimi është i kufizuar në lëshimin e ndalimeve të caktuara për banorë të përhershëm në pikëpamje të investimeve të portofolit në tregje të huaja, megjithatë, të gjitha ndalimet mbeten. Ndalimet për shuma me para në dorë që mund të barten nëpërmjet pikave kufitare dhe shumat e transferteve që mund t'i bartin persona që nuk janë banorë të përhershëm nëpërmjet llogarive të tyre devizore lokale dhe të huaja nuk përputhen me *acquis*. Qytetarëve të UE-së nuk u lejohet të blejnë tokë bujqësore. Kjo paraqet pengesë efektive për lëvizjen e lirë të kapitalit. Investimet e huaja nuk janë në hap me

ekonomitë përkatëse. Doemos duhet të realizohet modernizimi i infrastrukturës. Dispozitat ligjore për pengimin e shtetasve vendas për të blerë letra të huaja me vlerë me hapjen e llogarive në baka të huaja ose blerje të pronës së patundshme jashtë vendit, mbeten në fuqi. Përgatitjet në sferën e lëvizjes së kapitalit dhe pagesave kanë përparuar mesatarisht.

Nuk ka përparim në sferën e sistemeve për pagesë. Kanë filluar përgatitjet për transponimin e direktivës për shërbime pagesore. Shumica e arkëtimit për transaksione jashtëkufitare me pagesë elektronike akoma janë joproporcionale me transaksionet vendore të arkëtimit elektronik. Në sferën e sistemeve pagesore, vendi pjesërisht i plotëson qëllimet e tij.

Mund të vërehet përparim i caktuar në **luftën kundër larjes së parave**. Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (DPLPFT) dhe Banka Qendrore paraqitën ligje plotësuese për zbatim në lidhje me parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Njoftimet për institucionet financiare për të gjitha transaksionet mbi 15 000 euro dhe nga Drejtoria Doganore për transfert mbi 10 000 euro tani kryhen në mënyrë automatike nëpërmjet kanalit të sigurtuar. DPLPFT filloi me kontrollime në institucionet për njoftim (mbi 54 persona juridikë në vitin 2010), kumtoi dënime financiare për kundërvajtje dhe zbatoi konfiskim të përkohshëm të pronës. Është përmirësuar bashkëpunimi me organet hetuese dhe gjyqësore dhe me njësitë e huaja për zbulim financiar, anëtare të grupacionit Egmont. (Megjithatë, në vitin 2010 numri i raporteve për transaksione të dyshimta u ul për 15% shtesë, gjysma e tyre u dërguan nga bankat. DPLPFT dërgoi 28 raporte dhe 140 njoftime te organet hetuese dhe gjyqësore. Është krijuar bazë statistikore e të dhënave për numrin e proceseve dhe aktgjykimeve gjyqësore për larjen e parave (*shiko kreu 24- drejtësia, liria dhe siguria*). Shikuar në përgjithësi, përgatitjet në sferën e luftës kundër larjes së parave kanë përparuar mesatarisht.

Konkluzion

Përparimi në sferën e lëvizjes së lirë të kapitalit ishte i pabarabartë dhe i fokusuar në zbatim në sferën e luftës kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Akoma ekzistojnë kufizime për investime afatshkurtra të portofolit dhe për transfert tejkufitar të arkëtimit. Ekzistojnë plane për liberalizim të mëtejshëm të lëvizjes së kapitalit dhe arkëtimit pas kalimit në fazën e dytë të MSA-së. Përgatitjet në sferën e lëvizjes së lirë të kapitalit janë në rrugë të mirë.

4.5. Kreu 5: Furnizime publike

Është arritur përparim në lidhje me parimet e përgjithshme. Seksioni përgjegjës për koncesione në Ministrinë e Ekonomisë e përmirësoi bashkëpunimin e tij me institucione tjera që janë përfshirë në sistemin për furnizime publike. Byroja për Furnizime Publike (BFP) themelon IT të veçantë dhe seksion për kontabilitet. BFP e koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e strategjisë për zhvillim të sistemit për furnizime publike për periudhën 2010-2012. Në viti 2010, 354 përfaqësues edhe nga organet e kontraktuara dhe operatorët ekonomikë u trajnuan në qendrën për trajnim të Byrosë për Furnizime Publike. Konflikti i interesave, etika dhe kundërkorrupsioni në furnizime publike u bënë modul i veçantë i trajnimit në programin vjetor për trajnim. Vazhdoi bashkëpunimi i BFP-së me Entin Shtetëror për Revizion (ESHR), Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (MKK). Megjithatë duhet të përforcohet statistika gjyqësore për furnizime publike lidhur me lëndët gjyqësore. Vazhdon trendi i shfuqizimeve dhe procedurave të pasuksesshme për tenderë. Kapaciteti i seksionit përgjegjës për koncesione në Ministrinë e Ekonomisë mbetet i pamjaftueshëm në përballje me projekte të mëdha. Duhet të përforcohet koordinimi me trupa tjerë shtetërorë në sferën e partneriteteve private publike. Në lidhje me parimet e përgjithshme, vendi përgjithësisht është në rrugë të mirë.

Është arritur përparim i caktuar në lidhje me transparencën në ndarjen e marrëveshjeve publike. Kufiri i epërm për e-furnizimet e detyrueshme u ngrit nga 30% të vlerës së

përgjithshme e përcaktuar e të gjitha marrëveshjeve publike deri në 70%. Në vitin 2010, 693 organe të kontraktuara dhe operatorë ekonomikë kryen trajnim të specializuar për shfrytëzimin e sistemit të integruar elektronik për furnizime publike. Rregullorja për shfrytëzimin e këtij sistemi u ndryshua për t'u definuar kriteri për ofertë ekonomike më të volitshme. Qendra për mbështetjen e shfrytëzuesve u bë operative. Zyra e prokurorit publik parashtroi kallëzime penale kundër kryetarëve të komunave dhe drejtorëve për institucionet shëndetësore për cenimin e Ligjit për furnizime publike. Megjithatë, disa marrëveshje për punë për projektin „Shkupi 2014“ u ndryshuan në raport me kriteret që zotëruan në periudhën e ndarjes së tyre me zmadhimin e shumave të kontraktuara dhe zmadhimin e vëllimit të punës. KSHPK vërtetoi se fondet shtetërore shpesh keqpërdoren për fushata publike dhe materiali i harxhuar është dërguar ndërsa tenderi adekuat ende ka qenë në vijim. Në lidhje me ndarjen e marrëveshjeve publike, vendi ka përparuar mesatarisht.

Mund të vërehet përparim në lidhje me sistemin për mjete juridike. Rreth 12% nga të gjithë tenderët që filluan më 2010 ishin lëndë e ankesave. Komisioni Shtetëror për Ankesa (KSHA) më 2010 e mbajti nivelin e rasteve të zgjidhura në rreth 95%. Ueb faqja e KSHA-së rregullisht azhurnohet edhe me rastet e fituara edhe me vendimet e marra përkatëse. Ligji për furnizime publike u ndryshua për të siguruar zbatim me kohë në rast ankese të vendimeve të KSHA-së. Numri i të punësuarve u rrit në 12, por KSHA-ja mbetet me buxhet dhe kuadër seriozisht të pamjaftueshëm. Harmonizimi i plotë me direktivën e ndryshuar të UE-së për mjete juridike akoma duhet të arrihet. Në lidhje me sistemin për mjete juridike, vendi ka përparuar mesatarisht.

Konkluzion

Është arritur përparim në sferën e furnizimeve publike. Legjislacioni për koncesione dhe partneritete tjera private publike fillimisht duhet të harmonizohet me *acquis*. Procedurat për furnizime publike janë bërë më shumë transparente dhe zbatimi është përforcuar, por kapaciteti administrativ i organeve të kontraktuara akoma është i dobët. Mjedisi juridik për zbatimin e mjeteve juridike është përmirësuar. Kapaciteti administrativ në sferën e mjeteve juridike dhe koncesioneve mbetet i dobët. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e furnizimeve publike kanë përparuar mirë.

4.6. Kreu: 6 E drejta e shoqërive tregtare

Mund të vërehet përparim i mirë në sferën e **të drejtës së shoqërive tregtare**. Ligji për shoqëri tregtare është ndryshuar me qëllim që të harmonizohet me direktivat ligjore në lidhje me kushtet për zbardhjen e llojeve të caktuara të shoqërive tregtare; në lidhje me realizimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve në shoqëri të kuotuar në lidhje me bashkimet jashtëkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe në lidhje me balancat e konsoliduara të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Ligji për sistem njësportel është ndryshuar me qëllim që të vendoset regjistrim elektronik i shoqërive; harmonizimi me *acquis* mbetet të vërtetohet. Harmonizimi me direktivën e dhjetë të Ligjit për shoqëri tregtare për bashkime jashtëkufitare është i rëndësishëm, por fillimisht duhet të arrihet transponomi i nenit 16 për pjesëmarrjen e të punësuarve. Në sferën e të drejtës së shoqërive tregtare, vendi është në rrugë të mirë.

Është arritur përparim i vogël në sferën e kontabilitetit korporativ. Është miratuar rregullore për formën dhe përmbajtjen e llogarive vjetore. Fillimisht duhet të arrihet harmonizim i plotë me direktivën e shtatë të Ligjit për shoqëri tregtare, duke i përfshirë edhe kushtet për përgatitjen e llogarive të konsoliduara. Akoma nuk është miratuar Ligji për mbikëqyrje publike në sferën e kontabilitetit.

Mund të vërehet përparim i mirë në lidhje me **revizionin**. Është miratuar Ligji për revizion me qëllim që harmonizimi të përshtet me direktivën për revizione ligjore të llogarive vjetore dhe të konsoliduara. Ligji mundëson themelimin të trupit për mbikëqyrje publike që duhet ta mbikëqyrë dhe promovojë revizionin. Këshilli për revizion dhe mbikëqyrje është në proces të themelimit si trup i pavarur rregullator. Instituti i revizorëve të autorizuar (IRA) kryen kontrole të kualitetit dhe u bë anëtar i bashkuar i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). IRA tani ka status të personit juridik; megjithatë, funksionon me

numër të pamjaftueshëm të të punësuarve. Kualifikimet e revizorëve të autorizuar të fituara jashtë vendit fillimisht duhet të pranohen. Marrë në përgjithësi, në sferën e kontabilitetit korporativ dhe revizionit vendi ka përparuar mesatarisht.

Konkluzion

Është arritur përparim i mirë në sferën e të drejtës së shoqërive tregtare. Ligji për shoqëri tregtare është ndryshuar dhe plotësuar për harmonizim të mëtejshëm me *acquis*. Janë themeluar sistemi për kontroll të kualitetit dhe trupi për mbikëqyrje publike; megjithatë korniza juridike në sferën e revizionit mbetet pjesërisht e harmonizuar me *acquis*. Instituti për revizorë të autorizuar tani është anëtar i bashkuar i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit, por kapaciteti administrativ mbetet i dobët. Kualifikimet e fituara jashtë vendit fillimisht duhet të pranohen. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e të drejtës së shoqërive tregtare pjesërisht i plotësojnë qëllimet.

4.7. Kreu 7: E drejta e pronësisë intelektuale

Vërehet përparim i caktuar në sferën e **të drejtave të autorit dhe të drejtave ngjashme**. Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, e përmirësoi kornizën për licencimin e shoqërive për menaxhim me të drejtat kolektive (SHMDK) dhe vendosi afat të fundit deri në shtator 2011 për përtëritjen e licencave të reja. Mbetet të vërtetohet harmonizimi i ligjit me *acquis* të UE-së. Megjithatë, SHMDK mbeten joaktive dhe/ose fillimisht duhet t'i fitojnë licencat në kuadër të Ligjit të ri për të drejta të autorit. Kapaciteti administrativ i seksionit që është përgjegjës për të drejtat e autorit në Ministrinë e Kulturës mbetet i dobët. Vendi ka përparuar mesatarisht në sferën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme.

Është vërejtur përparim i mirë në sferën e të drejtave të **pronësisë industriale**. Ligji për pronësi industriale u ndryshua për mbrojtje më të mirë të emrave gjeografikë të prodhimeve industriale dhe për zmadhimin kompetencave të Inspektoratit Shtetëror të Tregut (ISHT) gjatë konfiskimit të sendeve të falsifikuara. Mëtej, u miratua Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Lisbonës për Mbrojtjen e shenjave të prejardhjes dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar. Enti Shtetëror për Pronësi Industriale (ESHPI) nënshkroi plan aksional për periudhën 2010-2011 për bashkëpunim me Organizatën Evropiane të Patentave. Disa anëtarë të personelit për administrim të ESHPI-së dhanë dorëheqje; megjithatë numri i përgjithshëm prej 33 punëtorësh është i mjaftueshëm. Vazhdojnë aktivitetet për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI). Sipas programi TEMPUS, Qendra për Arsim për Pronësi Intelektuale i hapi studimet e para të specializuara pasuniversitare për pronësi intelektuale duke filluar nga viti akademik 2010-2011. Si pjesë e programit mësimor për trajnim të vazhdueshëm të Akademisë për Trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, më 2010, 405 anëtarë të gjyqësisë u trajnuan për të drejtat e pronësisë intelektuale. Vendi shënoi përparim të dukshëm në sferën e të drejtave të pronësisë industriale.

Është shënuar përparim i caktuar në pikëpamje të **zbatimit**. Trupi koordinues për pronësi intelektuale (TKPI) në vitin 2010 ndërmoi 23 aksione të koordinuara në tërë vendin për luftë kundër piraterisë dhe falsifikimit. TKPI propozoi të konfiskojë mall të falsifikuar, kryesisht audio/video CD-a, cigare dhe alkool por gjithashtu edhe lodra, softuer dhe pajisje për emetim. Bashkëpunimi me Agjencinë për menaxhim me pronë të konfiskuar vazhdon edhe rreth 180 000 mallra të cilat ishin lëndë e vendimit gjyqësor u asgjësuan publikisht në vitin 2010. Ndarja e kompetencave ndërmjet institucioneve për zbatimin e ligjit (DPI, Drejtoria doganore dhe Ministria e Punëve të Brendshme) mbetet e paqartë. Konfiskimi i prodhimeve të falsifikuara farmaceutike filloi në bashkëpunim me Byronë për barna, por vetëdija e konsumatorëve për rreziqet e tyre shëndetësore dhe kërcënimet për sigurinë e tyre mbetet e kufizuar. Numri i procedurave kundërvajtëse, civile dhe penale u zmadhua; në vitin 2010 u përfunduan vetëm 91 prej 152 rasteve me të cilat janë marrë seksionet e specializuara për PIS nga 13 gjykatat themelore, 34 dënime në para ndërmjet 200 dhe 1600 euro të shqiptuara personave juridikë, ndërsa 10 persona u dënuan në dënim me burg prej 6 muajsh. Kështu prodhimet e falsifikuara vazhduan të shiten në banoqe të përkohshme në rrugë, tregje dhe shitore. Tregtia me barna të falsifikuara dhe prodhime të rrejtshme nëpërmjet internetit nuk është lëndë e ndjekjes penale. Ende nuk ka evidencë autentike për

zbatim. Së pari duhet të zhvillohet metodologjia për grumbullimin e të dhënave statistikore. Së pari duhet të vendoset sistem për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve për zbatimin e ligjeve. Kanalet për falsifikim edhe mëtej janë të rënda për zbulim dhe pak punohet për zgjedhjen e problemit me "piramidën e falsifikimit". Nevojitet trup qendror me qëllim grumbullim të institucioneve dhe organeve të ndryshme që janë të përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të lidhura dhe plotësisht ta përcaktojë gjendjen momentale dhe të zhvillojë strategji nacionale dhe plan aksional.

Konkluzion

Është arritur përparim i caktuar në pikëpamje të kornizës ligjore për PIS. Korniza për licencimin e shoqatave për menaxhim me të drejta kolektive është e përmirësuar. Janë zmadhuar autorizimet e Inspektoratit shtetëror të tregut gjatë konfiskimit të sendeve të falsifikuara. Institucionet për zbatimin e ligjeve vazhdojnë të bashkëpunojnë, por përgjegjësia e tyre përkatëse në lidhje me zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale mbetet e paqartë. Edhe pse aktivitetet e (TKPI/Trupi koordinues për pronësi intelektuale) vazhdojnë në bazë të rregullt, falsifikimi dhe pirateria mbeten gjerësisht të shpërndara. Evidenca për përcjelljen e hetimeve, ndjekja penale dhe procedurat gjyqësore për piraterinë dhe falsifikimin nuk është e kënaqshme. Falsifikimi dhe pirateria nuk trajtohen si aspekt i krimit të organizuar. Niveli i vetëdijes te publiku për të drejtat e pronësisë intelektuale është ende i ulët. Marrë përgjithësisht, përgatitjet nga sfera e Ligjit për pronësi intelektuale përparojnë.

4.8. Kreu 8: Politika e konkurrencës

Është arritur përparim i mirë në **sferën e antitrusteve, duke i përfshirë edhe bashkimet**. Ligji i ri për mbrojtjen e konkurrencës hyri në fuqi në nëntor të vitit 2010. Ai i përforcon kompetencat për zbatim të cilat i posedon Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (KMK) në sferën e antitrusteve me futjen e masave të lëshimit, ndërsa e heq edhe klauzolën për suspendim të sanksioneve me vendime administrative. Kështu, në rast të procedurave të kundërvajtjes, klauzola për suspendim mund ta prolongojë zbatimin e vendimeve të KMK-së.

Numri i të punësuarve në KMK të cilët punojnë në sferën e antitrustit dhe bashkimit është i zmadhuar për një po ende është i pamjaftueshëm. Evidenca për zbatim mbetet në nivel të ulët në sferën e karteleve. Buxheti i përgjithshëm i KMK-së për vitin 2011 shënoi rënie të dobët në krahasim me vitin e kaluar dhe mbete joadekuat. Gjykatësit dhe Gjykata Administrative që punojnë në rastet me konkurrencë kaluan trajnime të caktuara për antitrust dhe bashkim. Marrë në tërësi, përgatitjet në sferën e antitrustit, duke përfshirë edhe bashkimet janë në fazën e avancuar.

Përqindja e vendimeve të KMK-së të pranuar nga Gjykata administrative është zmadhuar. Në krahasim me vitin 2010, evidenca për zbatim është zmadhuar në sferën e bashkimit, por mbetet në nivel të ulët në sferën e karteleve. Prej tetorit të vitit 2010, KMK-ja miratoi një vendim për marrëveshje të ndaluar, katër vendime në raste të keqpërdorimit të pozitës dominuese dhe katër vendime për bashkim.

Është vërejtur përparim i caktuar në sferën e ndihmës shtetërore. Është miratuar Ligji i ri për ndihmë shtetërore. Me këtë mundësohen procedura më të thjeshta administrative para KMK-së. Numri i të punësuarve që punojnë në sferën e ndihmës shtetërore është i mjaftueshëm. Numri i vendimeve të miratuara nga ana e KMK-së në sferën e ndihmës shtetërore është zmadhuar – prej tetorit 2010 ka miratuar gjashtë vendime. Kështu, kualiteti i vendimeve veçanërisht në lidhje me çështjen e klasifikimit të ndihmës duhet të përmirësohet. Dhënësit e ndihmës shtetërore organizuan aktivitete për ngritjen e vetëdijes, veçanërisht për dispozitat e ligjit të ri. Numri i institucioneve të cilat parashtrajnë raporte u zmadhua, veçanërisht ndërmjet dhënësit më të madh të ndihmës. Kështu, te institucione të caktuara ende ekziston hamendje për njoftim për ndihmë të KZK.

Është shënuar përparim i vogël në sferën e liberalizimit të tregut. Ndryshimet e fundit të Ligjit për energjetikë, të miratuara në pranverë të vitit 2011 sollën deri në zmadhimin e konkurrencës dhe transparencës në sektorin energjisë elektrike. Në sektorin energjetik, shumica e rezervave të qymyrgurit (lignitit) ende janë të menaxhuara nga ana e kompanisë për prodhimin e energjisë elektrike dhe ende nuk ekziston përkufizim i qartë juridik dhe financiar ndërmjet aktiviteteve për gërmimin e lignitit dhe punën e termocentraleve. Në tregjet e gazit dhe energjisë elektrike dominojnë furnizues të veçantë të cilit e minojnë konkurrencën efektive.

Konkluzion

Është vërejtur përparim i caktuar në sferën e konkurrencës. Në sferën e bashkimit dhe ndihmës shtetërore, evidenca për zbatim është përmirësuar në kualitet, por mbetet e ulët në sferën e karteleve. Kualiteti i vendimeve në sferën e ndihmës shtetërore duhet në mënyrë plotësuese të përmirësohet. KZK nuk disponon me mjete përkatëse buxhetore. Numri i të punësuarve është i mjaftueshëm që ta përfshijë materien e ndihmës shtetërore, por nuk është i mjaftueshëm në sferën e antitrustit dhe bashkimeve. Marrë përgjithësisht përgatitje në sferën e politikës së konkurrencës shënojnë përparim mesatar.

4.9. Kreu 9: Shërbime financiare

Është arritur përparim i mirë në sferën e **bankave dhe konglomerateve financiare**. U miratua Ligj për fond për sigurim dhe depozitave, duke e zmadhuar shumë e depozitave të siguruara. Plotësisht do të zbatohet deri në periudhën e aderimit. Ligji për shoqëritë financiare që i rregullon institucionet jobankare kreditore u miratua gjithashtu. Përgatitja e legjislacionit në sferën e bankave dhe konglomerateve financiare ka arritur përparim të mirë. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejme me qëllim që të përcillet zhvillimi i fundit rregullator në nivel ndërkombëtar. Mëtej, ndërmjetësimi financiar pengohet me konkurrencën e dobët në sektor dhe hedhjen e lartë të rrezikut në sektorin bankar.

U vendos legjislacion i ri që kërkon bankat dhe institucionet financiare t'u sigurojnë konsumatorëve informata të plota për prodhimet dhe shërbimet e tyre. Megjithatë, zbatimi i këtij legjislacioni mbetet sfidë dhe mbrojtja e konsumatorëve nuk është shqyrtuar në mënyrë adekuate.

Banka Qendrore, *Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë* (BPRM-së), ngriti disa pjesë për zbatimin e legjislacionit për menaxhim me rrezikun e kreditor dhe operativ dhe menaxhim të bankave në falimentim. Bashkëpunimi vazhdon me organet e mbikëqyrje së atyre vendeve bankat e të cilave i posedojnë disa nga bankat më të mëdha në vend. Kapaciteti i BPRM-së për zbatimin përkatës dhe vënien në fuqi të rregullave është i kënaqshëm. Korniza Bazel II për mbikëqyrje të rrezikuar zbatohet gradualisht: shtyllat 2 dhe 3 janë implementuar plotësisht. Megjithatë, shtylla 1 themelore për Bazel II, do të zbatohet nga janari i vitit 2012. Transponimi i Direktivës së kapitalit për fonde investuese dhe institucionet e kreditimit nuk ka përfunduar.

I mirë, por përparim jo i njëjtë mund të vërehet në sferën e **sigurimit dhe pensioneve profesionale**. Ligji për mbikëqyrje të sigurimit u ndryshua me qëllim të harmonizohet me Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe Ligjit penal. Një pjesë e *acquis* direktiva për solvencë I, duke e përfshirë edhe *acquis* për mbikëqyrje të rrezikut dhe kushtet për njoftim të jashtëm u transponuan; duhet të vërtetohet harmonizimi. Janë përmirësuar rezultatet nga zbatimi i Agjencisë për supervizion të sigurimit (ASS), ajo tash kryen edhe supervizion të jashtëm edhe supervizion të brendshëm. Kapaciteti o ASS dhe bashkëpunimi i saj me organet e supervizionit të kompanive të sigurimit që kanë filiale lokale është përkatës. Kompanitë e huaja të sigurimit e risigurojnë pjesën më të madhe të rrezikut të ndërmarrë nga ana e filialeve lokale, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me klientë më të mëdhenj. Fondi i garantuar për insolvencë të sigurveve tash është i mjaftueshëm; kapitali i nevojshëm dhe margjinat e solvencës janë mbi nivelet e mjaftueshme. Megjithatë, nuk ka rezultate për luftë kundër cenimeve të kryera nga ana e shoferëve të pasiguruar. Legjislacioni për zbatimin e Ligjit për automjete, me të cilin rregullohet regjistrimi dhe sigurimi, do të zbatohet nga 1 janari 2012. Dispozitat e Ligjit për sigurim të detyrueshëm në komunikacion, me të cilat autorizohet Ministria e Financave që t'i caktojë premittë plotësuese për sigurim të automjeteve, paraqesin barrierë efektive për konkurrencë ndërmjet kompanive të sigurimit, dhe të njëjtat ende nuk janë mënjanuar.

Ligji për sigurim pensional me financim kapital u ndryshuar me qëllim që të zvogëlohen sanksionet. Legjislacioni plotësuese për zbatimin e Ligjit për sigurim pensional me financim kapital u shpall nga Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital (MAPAS). MAPAS-i filloi përgatitjet për futjen e mbikëqyrjes së rrezikut. Rregullativat e reja do të modelohen sipas praktikës më të mirë të Organizatës ndërkombëtare të supervizionit pensional; megjithatë ato nuk janë të lidhura me Standardet e Bazelit. Skema pensionale e vendit, e cila bazohet në kontribute të definuara, dallohet nga modeli i cili zbatohet në më shumë vende të UE-së, sipas *acquis* përkatës i UE-së për supervizion të institucioneve për dispozitat për pension

profesional nuk mund të zbatohet. Fondet pensionale tash mund të investojnë një pjesë të vogël nga portofoli i tyre në kapital të aksioneve dhe obligacioneve lokale, me qëllim që të stimulohen MSS dhe zhvillimi lokal. Kufizimi i investimit në obligacione të huaja vazhdon, që është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të UE-së. Megjithatë kufiri u zvogëluar në 50% (30% në vitin 2010). Pavarësia financiare e MAPAS-it nuk është plotësisht e siguar edhe krahas ndarjes së buxhetit të MAPAS-it nga Ministria e Financave, e cila ende lëshon leje paraprake për menaxhim me mjetet e MAPAS-it. Nuk kërkohet përvojë paraprake lidhur me supervizionin financiar ose tregun e kapitalit për emërimin e udhëheqjes së MAPAS-it. Kapaciteti i përgjithshëm administrativ është i dobët dhe i ekspozuar në largimin e kuadrit me përvojë. MAPAS ka ndikim të kufizuar mbi institucionet në të cilat kryen supervizioni. Në sferën e sigurimit dhe të pensioneve profesionale, vendi pjesërisht i plotëson qëllimet e veta.

Është arritur përparim në sferën e **infrastrukturës financiare të tregut**. Komiteti për stabilitet financiar dhe Komiteti për supervizion të shërbimeve financiare takohen rregullisht. U miratua Ligj i ri për lizing, i cili fut standarde më të lehta për supervizion. Në sferën e infrastrukturës financiare të tregut, vendi ka arritur përparim mesatar.

U arrit përparim në sferën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimet investuese**. Shumica e direktivave të tashme për keqpërdorimin e tregut, tregjet e instrumenteve financiare, skemat e kompensimeve investuese, transparencë dhe prospekte, tashmë janë transponuara; barazimi duhet të vërtetohet. Duhet të ndërmerren hapa të mëtejme që të arrihet harmonizim me Direktivën nr. 2007/16 dhe zhvillimin tjetër të legjislacionit të UE-së në lidhje me ndërmarrjet për investime kolektive të letrave me vlerë për tregtim (paket 11CTIS IV). Më tej, dendësia me të cilën rregullat e supervizionit ndryshohen e rëndojnë zbatimin e ndërmarrjeve nga ana e tregut të kapitalit. Sipas zhvillimit administrativ, Kuvendi zgjodhi katër anëtar të rinj dhe e rizgjodhi kryetarin e rregullatorit, Komisionin për letra me vlerë (KLV); të gjithë ata do të jenë të punësuar me orar të plotë të punës në KLV. Më tej, janë ndërmarrë hapa për ndarjen e kompetencave të Bankës qendrore dhe KLV-së në sferën e licencimit dhe supervizionit të tregtimit të letrave me vlerë ndërsa bashkëpunimi i KLV-së me organet tjera të vendit u përforcua. Sistemi informatik i KLV-së u përsos dhe tani është adekuat. Megjithatë, numri i kuadrit në KLV ende nuk është i mjaftueshëm. Në nivel ndërkombëtar, KLV-ja nënshkroi Memorandum për mirëkuptim me Organizatën ndërkombëtare të komisioneve për letra me vlerë.

Konkluzion

Është arritur përparim përgjithësisht i mirë në sferën e veprimtarisë bankare, sigurimit dhe tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve investuese. Janë miratuar ligje për fondet e sigurimit të depozitave dhe shërbime financiare në largësi, gradualisht zbatohet marrëveshja Bazel II për mbikëqyrje të rrezikut dhe përmirësohen përgatitjet për legjislacionin tjetër në sferën e bankave dhe konglomerateve financiare. Agjencia për supervizion të sigurimit filloi me realizimin e supervizionit të brendshëm dhe të jashtëm. Është vendosur legjislacioni i ri me të cilin rregullohen shërbimet tjera financiare, siç janë marrë kompani financiare për lizing dhe jobankare dhe janë ndërmarrë hapa për ndarjen e kompetencave të Bankës Qendrore dhe KLV-së në sferën e licencimit dhe supervizionit të tregtimit të letrave me vlerë. Megjithatë, duhet të vërtetohet harmonizimi për një pjesë të legjislacionit të ri të transponuar. Pavarësia dhe kapaciteti për zbatimin e MAPAS-it duhet të shkarkohet. Zhvillimi i paradokohshëm në legjislacionin e UE-së duhet të merret parasysh. Marrë përgjithësisht, në sferën e shërbimeve financiare, harmonizimi me acquis është në rrugë të mirë.

4.10. Kapitulli 10: Shoqëria informatike dhe mediet

Është arritur përparim i mirë në sferën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive informatike**. Rregullatori mirati legjislacion për zbatim drejt përmirësimit të shërbimeve të kushteve të konkurrencës dhe e vendosi pjesën më të madhe të masave kryesore për mbrojtje të konkurrencës. Me zbatimin e detyrimeve në pikëpamje të kontabilitetit të shpenzimeve do të sigurohet se operatorët ndjekin kritere të rregullta, objektive dhe transparente gjatë ndarjes së shpenzimeve sipas shërbimeve. Rregullatori i obligon operatorët që të sigurojnë mbrojtje më të madhe të të drejtave të konsumatorëve nëpërmjet miratimit të rregullave për të drejtat e konsumatorëve me atë që obligohen siguresit e shërbimeve t'i shpallin të gjitha kushtet për qasje, vlerësim dhe tarifa. U vendosën rrjete të operatorëve virtualë mobilë dhe filluan procedura për rregullim të gjeneratës së ardhshme të rrjeteve për qasje. Rregullatori kreu analizë të të gjitha tregjeve relevante për komunikime elektronike dhe arriti përparim në futjen e mjeteve

rregulative. Tregjet relevante që janë mjaft konkurrense tashmë nuk i nënshtrohen rregullimit ex-ante. Taksat e larta që i paguan rregullatori i operatorit të cilët e kalojnë nivelin e domosdoshme për mbulimin e shpenzimeve administrative e vënë në pikëpyetje karakterin e papranuar të rregullatorit dhe mund të paraqesin barrierë për hyrje në treg, që është në kundërshtim me asquis-në. Rregullatori emëroi drejtor të ri; përsëri procesi i emërimit ngriti brenga për politizim të mundshëm. Niveli i bashkëpunimit me organin e konkurrencës u përmirësua sepse gjithçka filloi me koordinim me masat ex-ante të dedikuara nga rregullatori me ex-ante masat e organit për konkurrencë. U emërua sigures universal i shërbimeve. U arrit përparim në përgatitjet për futjen e numrit për raste urgjente 112. Kapaciteti administrativ në kornizat e ministrisë kompetente duhet të përforcohet. Është vërejtur përparim në sferën e komunikimeve elektronike dhe teknologjive informatike.

Është vërejtur përparim në sferën “**Shërbime të shoqërisë informatike**” në kompetencë të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, veçanërisht në sferën e shërbimeve publike të kapshme në internet. U miratuan ndryshime të Ligjit për tregti elektronike drejt përfundimit të harmonizimit në këtë sferë, veçanërisht nëpërmjet përcaktimit të pikës nacionale të kontaktit që duhet të fillojë me funksionim. U miratua strategji për përfshirje elektronike. Blerja nëpërmjet interneti mbetet në nivel të ulët. “Pragu” i ri për tregti nëpërmjet internetit me tarifë të lartë doganore nuk është në pajtim me strategjinë rrjedhëse për avancimin e ekonomisë digjitale. Mbetet të përcaktohet pika nacionale për shkëmbim të komunikacionit me internet. Është realizuar përparim i vendit në sferën “Shërbime të shoqërisë informatike”.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **politikës audiovizuale**. Me ndryshimet e Ligjit për veprimtari radiodifuzive, me të cilin Drejtorisë për të hyra publike iu dha obligimi i grumbullimit të taksës radiodifuzive në emër të servisit radiodifuzive publik. Numri i anëtarëve në Këshillin për radiodifuzion u zmadhua prej 9 në 15. U zmadhuan aktivitetet e Këshillit për radiodifuzion në pikëpamje të monitorimit të tregut, por edhe mëtej mbeten të pamjaftueshme. U intensifikua bashkëpunimi me organin për konkurrencë, megjithatë ligji për të drejtat e autorit dhe për pronësi të medieve si dhe për koncentrim të pronësisë së medieve ende nuk zbatohet në tërësi. Pirateria është e përhapur, veçanërisht në rrjetet TV kablovike. Duhet të sigurohet financim i qëndrueshëm i servisit publik radiodifuziv dhe Këshillit për radiodifuzion. Servisi radiodifuziv publik momentalisht nuk e plotëson rolin e tij ligjor të sigurimit të programeve informative, arsimore dhe argëtuese. U fillua procesi për miratimin e Ligjit të ri për media elektronike drejt harmonizimit me Direktivat për shërbime audiovizuale të medieve. Filluan përgatitjet për futjen e shërbimeve për televizion celular dhe gjenerata e dytë e televizionit digjital. Qeveria miratoi plan aksional për kalim në televizion digjital dhe për shfrytëzimin e dividendës digjitale; përsëri, kalimi u prolongua për vitin 2012, me çka u penguan investime në treg. Shfrytëzimi i tregut të operatorëve për të digjitalizim të servisit radiodifuziv publik nuk është në pajtim me praktikën më të mira evropiane. Imponimi në lirinë e medieve e prolonguan funksionimin e plotë të medieve pa përzjerje politike. Janë vendosur dënime të mëdha për shpifje të personave publikë, që është në kundërshtim me praktikën gjyqësore evropiane. Në sferën e politikës audiovizuale vendi doemos duhet t'i përforcojë përpjekjet e harmonizimit me asquis-në.

Konkluzion

Ekziston përparim në sferën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të shoqërisë informatike. Përparon harmonizimi me asquis-në e UE-së dhe u vendos pjesa më e madhe e masave kryesore konkurruese të mbrojtjes. Përparon afrimi i vendit në aktivitetet e parapara me Agjendën digjitale të Evropës. Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e politikës audiovizuale, duke e përfshirë planin aksional për kalim të plotë në emetim digjital dhe shfrytëzimin e dividendës digjitale. Përsëri në këtë sferë vendi vetëm pjesërisht i plotëson kërkesat e UE-së. Janë të nevojshme përpjekje të mëtejme në pikëpamje të kapacitetit të Këshillit për radiodifuzion aftësia e të cilit për përcjellje efektive të tregut edhe më tej mbetet joadekuate. Servisi radiodifuziv publik nuk arrin ta plotësojë rolin e tij ligjor.

4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Është arritur përparim **horizontal**. Është miratuar legjislacioni për zbatim në sferën e politikës për përkrahje të zhvillimit bujqësor dhe rural, që i përfshin pagesat e drejtpërdrejta dhe masat për përkrahje të tregut. Për vitin 2011 janë ndarë gjithsej 101

milione euro për skemat për përkrahje të drejtpërdrejtë; kjo i përfshin pagesa për sipërfaqe dhe numrin i krerëve, pagesat e premive për prodhime me rëndësi strategjike dhe pagesa jo në bazë të mallit. Kapaciteti institucional edhe mëtej mbetet problem, me kufizimin e ndarjes së buxhetit në vitin 2011 për rrogat e nëpunësve shtetërorë në sektorin, që është e komplikuar me përparimin e pabarabartë në plotësimin e vendeve të zbrazëta të punës.

Mund të vërehet përparim i mirë në vendosjen e sistemit të integruar administrativ dhe të kontrollit (SIAK). Sistemi për identifikimin e parcelave të tokës (SIPT) është në fazë të përparuar; regjistrimi i bujqve të bujqve është në vijim. Kadastra e patundshmërive për momentin e përfshin 99% të sipërfaqes të vendit. Regjistri i firmave, e cila si përkrahje ka edhe sistem të automatizuar për teknologji informatike, është plotësisht funksional dhe shfrytëzohet për mbikëqyrje të skemave nacionale për përkrahje në vitin 2011. Megjithatë, kapaciteti i internetit dhe serviseve është i kufizuar, veçanërisht në momente të mbingarkimit të madh. Kompatibiliteti i regjistrave të të dhënave shënon përparim, por ende nuk është plotësisht i arritur. Kapaciteti institucional për menaxhim dhe mirëmbajtje të IAKS është i pamjaftueshëm.

Është vërejtur përparim i caktuar në përmirësimin e kapacitetit të agjencisë për pagesa (Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural – APFBZHR). Përfshirja e përgjegjësive të punonjësve në APFBZHR është i vëllimshëm dhe i përfshin skemat nacionale për përkrahje, si dhe masat plotësuese ekzistuese dhe të planifikuara të Institutit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural (INPZHR) në korniza të komponentës V. Megjithatë, edhe krahas nivelit të motivimit dhe trajnimit, numri i tyre është i pamjaftueshëm. Përgatitjet për zbatimin e Fondit Garantues Evropian për Bujqësi (FGEB) (pagesa të drejtpërdrejta) kanë filluar me futjen e ligjeve përkatëse për zbatim. Është vërejtur përparim i kufizuar në zhvillimin e sistemit informatik të qëndrueshëm dhe efikas në bujqësi. Aktivitetet e rrjetit pilot për të dhëna kontabiliste të firmave (FADN) vazhdojnë. Është përforcuar dhënia e përkrahjes për bujqësinë. Përgatitje në sferën e çështjeve horizontale kanë përparuar mesatarisht.

Sa i përket **prodhimeve me prejardhje shtazore**, janë miratuar ligje për zbatim për shpezë, vezë dhe mjaltë. Vazhdon harmonizimi i legjislationit me *acquis* për kultura të specializuara, veçanërisht me miratimin e legjislationit për zbatim për verë. Është përforcuar kapaciteti institucional për zbatimin e legjislationit që është në fyqi. Është vendosur bazë ligjore për zbatimin e masave për përkrahje të tregut, si për shembull, intervenim për numër të kufizuar të mallrave, avancimi i konsumit dhe organizatave të prodhuesve. Harmonizimi me organizimin e përbashkët të tregut të UE-së është i kufizuar. Përgatitjet në këtë sferë kanë filluar.

Harmonizimi me *acquis* në sferën e kulturave të specializuara është në vijim, veçanërisht për verë. Është miratuar legjislationi për zbatim për verë, që veçanërisht ka të bëjë në regjistrimin e prodhuesve dhe kontrollin e kapaciteteve të prodhimit. Megjithatë, ligjit për zbatim që ka të bëjë me shenjat gjeografike së pari i duhet harmonizim me *acquis*. Janë miratuar rregulla për zbatim për pemë dhe perime dhe dispozita është kornizë ambicioze kohore për prodhime tjera.

Është shënuar zhvillim i mëtejshëm në sferën e zhvillimit rural. Zbatimi i IPARD programit në kornizat e komponentës V vazhdon për tri masa: “Investime në ekonomitë bujqësore”, “Përpunim dhe plasman” dhe “Diversifikim i ekonomisë rurale”. Deri tani janë përfunduar tre thirrje për parashtrimin e ofertave, ndërsa ka filluar e katërta. Detyrimi për katër propozime në kornizat e komponentës V të IPA-s është gjithsej €M 4.67. Megjithatë, absorpsioni i ndarjeve për vitin 2007 dhe 2008 në kornizat e komponentës V të IPA-së, që janë €8.8, edhe më tej është problem. Është përforcuar kapaciteti institucional i Organit drejtues të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU). Përgatitjet për akreditimin e masës për ndihmë teknike janë propozuar dhe përfundimi i tyre është paraparë deri në fund të vitit 2011.

Është vërejtur përparim i vazhdueshëm në sferën e **politikës së kualitetit**. Është vendosur legjislationi për zbatimin e kornizës juridike e cila ka të bëjë me standardet për plasman, kërkesa për prezantim dhe etiketim të shpenzuesve, si dhe vendosje e skemave për kualitet. Kjo u mbështet më përforcim dhe ristrukturim institucional.

Është shënuar përparim i mëtejshëm në **bujqësinë organike**. Është përforcuar ligji për prodhimtari organike, posaçërisht në sferën e regjistrimit të prodhuesve dhe kontrollit të prurjeve të lejuara dhe të palejuara. Duhet të konstatohet harmonizimi me *acquis*. Numri i prodhuesve organikë të regjistruar dhe numri i përgjithshëm i prodhimtarisë organike edhe më tutje rriten. Në vitin 2011 është ndarë buxhet prej 1.79 milionë eurosh për mbështetjen e prodhimtarisë organike. Kapaciteti administrativ është i pamjaftueshëm

për plotësimin e obligimeve që dalin nga *acquis*. Përgatitjet në këtë sferë përsëri janë në vijim.

Konkuzion

Është arritur përparim plotësues në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Politikat kyçe për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural gradualisht harmonizohen me kërkesat e BE-së. Për harmonizim me *acquis* janë të nevojshme angazhime të mëtejme të vazhdueshme. Kapaciteti administrativ në tërë sektorin edhe më tutje mbete problem. Marrë në përgjithësi, përgatitjet në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural shënojnë përparim mesatar.

4.12. Kapitulli 12: Siguria e ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare

Është arritur përparim i mirë në pikëpamje të **parimeve** të përgjithshme. Është miratuar ligj i ri për sigurinë e ushqimit. Ligji i përcakton parimet kryesore dhe kërkesat për sistem të integruar për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshët, kërkesat e përgjithshme dhe konkrete higjienike për sigurinë e ushqimit dhe organizimin e sistemit për sigurinë e ushqimit duke i përfshirë edhe kontrollet zyrtare. Duke filluar nga një janari 2011, është themeluar edhe Agjencia e pavarur për udhëqim dhe veterinar (AUV) me bashkimin e Drejtorisë për ushqim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë për veterinar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomi të Ujërave, me qëllim që të sigurohet qasje më konsekuente në sektor. Sigurimi i Agjencisë për ushqim dhe veterinar me personel duhet të përforcohet.

Është shënuar përparim në sferën e **politikës veterinare**. Janë miratuar ligje plotësuese për zbatimin e sistemeve për kontroll. Duhet të vendoset sistem për mbledhjen, përpunimin dhe mënjanimin e nusprodukteve me prejardhje shtazore. Kapaciteti i sistemeve për kontroll të importit është përmirësuar me hapjen e dy stacioneve kufitare për kontroll në vendkalimin kufitar Tabanovc dhe aeroportin në Shkup. Nga janari 2011, të gjitha formalitetet për import të kafshëve dhe nusprodukteve me prejardhje shtazore janë përgjegjësi e shërbimit veterinar kufitar për kontroll.

Pjesë e sistemit për identifikim dhe regjistrim të gjedheve, deleve dhe dhive që kanë të bëjnë me kontrollin e lëvizjes është përmirësuar, por nuk i përfshin të gjitha zhvillimet. Janë miratuar masa korrigjuese për mënjanimin e mangësive gjatë identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, por kapaciteti administrativ i Agjencisë për ushqim dhe veterinar edhe më tutje është i dobët. Është arritur përparim i dukshëm në sferën e masave kontrolluese për sëmundje të kafshët. Agjencia për ushqim dhe veterinar e zbaton programin për vaksinim oral të dhelprave, që është vendosur në planin aksional të përpunuar dhe ligje përkatëse për zbatim. Programet për mbikëqyrje të dukurisë së tërbimit dhe kolerës klasike të derrat janë në fazë fillestare të zbatimit. Është miratuar programi për kontroll dhe çrënjosje të encefalopative transmissive spongjiforme. Janë miratuar masa për kontroll dhe çrënjosje të sëmundjes Njukasëll dhe kolerës afrikane të kuajt, por harmonizimi fillimisht duhet të konfirmohet. Agjencia për ushqim dhe veterinar zbaton program për çrënjosjen e brucelozës. Edhe pse është arritur progres i dukshëm në vaksinimin masiv të përtpësve të vegjël kundër brucelozës në fusha të caktuara, përhapja e sëmundjes edhe mëtej mbetet ose zmadhohet në rajone tjera. Plani nacional për kontroll të salmonelës të pulat nuk është zbatuar për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme. Kapacitetet e Agjencisë për ushqim dhe veterinar, edhe pse janë përforcuar edhe mëtej janë të pamjaftueshme për kryerjen e kontrolleve sistematike të sëmundjeve ngjitëse të kafshët. Buxheti për vitin 211 për shpenzime veterinare për masat për shëndetin e kafshëve është reduktuar për 18% në krahasim me vitin 2010; nevojitet buxheti i përgjithshëm për pagesë të borxheve të mbetura nga viti 2010. Parashihet që shpenzimet për zbatimin e programit për vitin 2010 të paguhet nga buxheti nacional për vitin 2012.

Është arritur progres i caktuar në fushën e mirëqenies së kafshëve. Janë miratuar ligje për zbatim me të cilat transponohet *acquis*; harmonizimi fillimisht duhet të konfirmohet.

Fillimisht duhet të miratohen disa ligje për zbatim në sferën e tregtisë në kuadër të Bashkësisë me kafshë të gjalla, farë për fekundim, qeliza vezë dhe embrione. Qëllimi i legjislacionit ekzistues për qarkullim jo tregtues të kafshëve përkëdhelëse dhe kërkesa transporti për kafshë të gjalla dhe prodhime të kafshëve është transponomi; harmonizimi fillimisht duhet të vërtetohet. Gjatë periudhës që mbulohet me këtë raport nuk janë nënshkruar marrëveshje të reja ndërkombëtare veterinare. Është përforcuar

kapaciteti për transponim dhe zbatim të *acquis* që i përket çështjeve zooteknike. Është miratuar programi për ruajtjen e kafshëve.

Laboratorët e fakultetit për veterinarë u akredituan në mënyrë nacionale sipas ISO standardeve 17025 për 89 metoda plotësuese laboratorike. Është vendosur sistemi për mbikëqyrje të inspektorëve veterinarë dhe stacioneve veterinarë. Kapacitetet administrative të inspektimit veterinar edhe mëtej janë të pamjaftueshme edhe në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e sistemit kontrollues kompatibil me atë të BE-së. Në sferën e politikës veterinarë, vendi është arritur përparim.

U arrit progres i caktuar në aspekt të **plasimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë**.

Skemat për ndihmë për sistemin NASSR vazhduan deri në vitin 2011 dhe u realizuan trajnime për subjektet të përfshira në industrinë ushqimore. Subjektet e përfshira në industrinë ushqimore jo gjithmonë i zbatojnë procedurat e bazuara në sistemin NASSR, ndërsa kontrollet zyrtare nuk kryhen gjithmonë në pajtim me kërkesat ligjore. Ligji i ri për siguri të ushqimit siguron bazë juridike vëllimore për kategorizim dhe mbindërtim formal të subjekteve të përfshira në industrinë ushqimore. Vlerësimi i ndërmarrjes për përpunimin e ushqimit për përcaktimin e harmonizimit të tyre me standardet e BE-së jo gjithmonë kryhet saktësisht. Legjislacioni ekzistues i cili e transponon *acquis*-in i cili ka të bëjë me rregullat higjienike, rregullat e veçanta për prodhimet kafshore, rregullat e kontrollit dhe rregullat e veçanta të kontrollit për prodhime kafshore, fillimisht duhet të miratohet. Aktivitetet e planifikuara për përmirësimin e cilësisë së qumështit në pluhur nuk janë realizuar.

U miratuan rregullat për zbatim që kanë të bëjnë me kontrollin dhe menaxhimin me nusprodhime me origjinë kafshore. Ende nuk janë instaluar sistemit e nevojshme për mbledhje dhe për përpunim. Në rrjedhë është zhvillimi i strategjisë për menaxhim me nusprodhimet me origjinë kafshore. Filluan përgatitjet në këtë sferë.

U vërejt progres i caktuar në sferën e **rregullave për sigurinë e ushqimit**. U miratuan ligje për zbatim që kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit për përdorim të veçantë ushqimor dhe për aditivë ushqimorë. Qëllimi i ligjeve është transponimi i *acquis*-it për materiale të cilat vijnë në kontakt me ushqimin, etiketën, aditivin e ushqimit, aromat, ushqimin e ngrirë për kafshë, ndotës, prodhime të reja ushqimore, rrezatim të jonizuar dhe ujëra minerale. Fillimisht duhet të miratohet legjislacioni për zbatim që ka të bëjë me ushqim të klasifikuar dhe të pasuruar. Kapaciteti i laboratorisë në Institutin për mbrojtjen shëndetësore ende nuk është i mjaftueshëm, në aspekt të resurseve njerëzore dhe procedurave, që të mund të japë rezultate të vërteta. Është përforcuar kapaciteti i Inspektoratit për ushqim, por numri, trajnimi dhe profesionaliteti i të punësuarve edhe mëtej janë të pamjaftueshme. U miratua programi vjetor për përcjelljen e sigurisë së ushqimit dhe është në fazë të realizimit. Filluan përgatitje në këtë sferë.

U bë progres në lidhje me rregullat e veçanta **për ushqimin për kafshë**. U miratua ligji për ushqimin për kafshë. Legjislacioni për zbatim fillimisht duhet të miratohet.

U vërejt progres në sferën e **politikës fitosanitare**. U miratua legjislacioni për zbatim në të gjitha sferat, përfshirë shëndetin e bimëve, prodhimet për mbrojtjen e bimëve, cilësinë e farave dhe materialeve farore dhe të drejtave seleksionuese. U miratua listë e re e substancave të miratuara aktive të dedikuara për prodhime për mbrojtjen e bimëve. Nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për masat fitosanitare, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen, certifikatën e eksportit dhe përcaktimin e statusit të dëmtueseve në sferën e caktuar. Edhe krahas punësimeve të caktuara, kapacitetit administrativ të Drejtorisë Fitosanitare duhet ende të përforcohet.

Nuk është përmirësuar koordinimi ndërmjet organeve të ndryshme kompetente të politikës fitosanitare. Janë hapur dy stacione të reja kufitare fitosanitare për kontroll në pikën kufitare Tabanovce dhe në aeroportin e Shkupit. Përgatitjet për akreditim të Laboratorisë shtetërore fitosanitare janë në vijim. Kapaciteti i saj është përmirësuar, por edhe më tutje shfrytëzohet në mënyrë të pamjaftueshme, meqë roli i saj në sistemin nacional për përcjelljen e sigurisë së ushqimit nuk është definuar dhe nuk merren shembuj në bazë të rregullt. Filluan përgatitjet në këtë sferë. Nuk u vërejt kurrfarë progresi në harmonizimin e *acquis*-it në aspekt të lëshimit të organizmave të

modifikuara gjenetikë (OMGJ) dhe ushqimit të modifikuar gjenetik për njerëz dhe ushqimit për kafshë në rrethinë.

Konkluzion

U arrit progres i mirë në sferën e sigurisë së ushqimit, politikës veterinarë dhe fitosanitare, veçanërisht në aspekt të miratimit të ligjit të ri kornizë për sigurinë e ushqimit, themelimit të Agjencisë së re për ushqim dhe veterinarë dhe realizimin e programeve të ndryshme për shërimin e sëmundjeve të kafshët. Kapaciteti administrativ i Agjencisë për ushqim dhe veterinarë, në aspekt të numrit dhe profesionalitetit të të punësuarve të tyre, edhe më tutje është i pamjaftueshëm për t'u siguruar realizim përkatës. Përgatitjet në sferën e sigurisë së ushqimit, politikës veterinarë dhe fitosanitare janë në rrugë të mirë.

4.13. Kapitulli 13: Peshkataria

U arrit progres i kufizuar në sferën e **menaxhimit me resurset dhe flotën**. Filluan përgatitjet në këtë sferë. Nuk zbatohet kërkesa për regjistrim të flotës.

U arrit progres i kufizuar në sferën e **inspeksionit dhe kontrollit**. U miratua legjislacioni sekondar me të cilin përforcohet Ligji për peshkatari dhe akuakulturë. Megjithatë, kapacitetet administrative të Seksionit për peshkatari dhe akuakulturë në kuadër të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave (MBPE) dhe seksionit relevant në kuadër të Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë nuk janë të mjaftueshme. Filluan përgatitjet në këtë sferë.

U arrit progres i caktuar në sferën e **aktiviteteve strukturore**. U miratua legjislacioni sekondar që ka të bëjë me kontrollin dhe procedurat gjatë kontrollit të peshkimit rekreativ. Për vitin 2011 janë ndarë 1 000 000 (një milion) euro për skemat për përkrahjen e peshkatarisë.

Është arritur përparim në sferën e **politikës së tregut**. MBPEU-ja vendosi Regjistër të ndihmës së përgjithshme shtetërore të lejuar në sektorin për peshkatari. Skemat nacionale, tani duhet të harmonizohen me politikat strukturore dhe politikat për ndihmën shtetërore të BE-së, e kryesisht lidhur me mbështetjen për pllenimin me peshq të ujërave.

Nuk ka marrëveshje **formale ndërkombëtare**. Vazhdojnë procedurat joformale të punës për menaxhim me resurset e Liqenit të Ohrit, të Prespës dhe Dojranit me Shqipërinë dhe Greqinë, ujërat e të cilave janë të përbashkëta.

Konkluzion

Arrihet përparim i caktuar në sferën e peshkatarisë. Kapacitetet administrative ende janë të pamjaftueshme. Duke e pasur parasysh faktin që vendi është kontinental, një numër i madh i *acquis* që ka të bëjë me peshkatarinë nuk është relevant. Filluan përgatitjet për zbatim të politikave të përbashkëta për peshkatari. Përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim mesatar.

4.14. Kreu 14: Politika e transportit

Arrihet përparim i mirë në **komunikacionin rrugor**. Përmirësohet puna e Këshillit për sigurinë e rrugëve, u zbatuan fushata për siguri në pajtim me planin e tyre vjetor. Filloi zbatimi i legjislacionit për takografi digjitale dhe zbatohen të gjitha strukturat e nevojshme. Ndryshohet Ligji për komunikacionin rrugor me qëllim të harmonizimit me *acquis* lidhur me qasjen në treg. Është përforcuar kapaciteti i Inspektoratit Shtetëror për Transport dhe u siguruan pajisja e specializuar dhe trajnimi plotësues. Kështu, numri i inspeksioneve ende nuk është i mjaftueshëm. Kapaciteti administrativ për zbatim të politikave për siguri të rrugëve dhe *acquis* sociale duhet në mënyrë plotësuese të përmirësohen. Përgatitjet në sferën e komunikacionit rrugor përparojnë mirë.

Arrihet përparim i madh në **komunikacionin hekurudhor**. Në Kuvend është miratuar ligj i ri për interoperabilitet. Organi kompetent për siguri është themeluar si objekt në kornizat e Ministrisë së Transportit, por kapaciteti i tij administrativ duhet të përforcohet. Miratohet legjislacioni lidhur me lëshimin e lejeve të makinistëve që të transponohen rregullat e BE-së, por kjo do të zbatohet pas aderimit të vendit në BE. Organi

kompetent për siguri lëshoi seri të lejeve për mjete hekurudhore, disa prej tyre në pajtim me Specifikimet Teknike për Interoperabilitet të BE-së. Trupi për hulumtim të fatkeqësive, i themeluar në fillim të vitit 2010, nuk ishte efikas. Në vijim janë përgatitjet për trup të ri me orar të plotë pune në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë. Ende nevojiten përpjekje plotësuese për zbatim dhe vënie në fuqi të *acquis*. Lartësia e arkëtimit për qasje në hekurudhë ende negativisht ndikon mbi konkurrencën e komunikacionit hekurudhor në raport me komunikacionin rrugor. Agjencia rregullatore për komunikacionin hekurudhor është pjesëmarrëse e rregullt në grupin punues të rregullatorëve të komunikacionit hekurudhor të BE-së. Procedura të mundimshme, jotranspatente dhe të shtrenjta për lëshim të lejeve dhe certifikatave për siguri dhe sigurimin e procedurave gjyqësore kanë ndikim demoralizues mbi kompanitë që hyjnë në këtë treg monopolist. Si rezultat i kësaj, ende ekziston vetëm një operator. Nënshkruhet Marrëveshja e përbashkët për pikën kufitare me Kosovën.

Arrihet përparim i dobët në sferën e **komunikacionit të brendshëm ujqor**. Miratohet legjislacioni për zbatim të kushteve për anëtarët e ekuipazhit të anijes. Vendoset lëshimi i lejeve dhe inspektimit për siguri dhe këto janë në funksion. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar.

Nuk ka përparim në sferën e **komunikacionit të kombinuar**. Përgatitjet janë në vijim.

Mund të vërehet përparim i kufizuar në sferën e **komunikacionit ajror**. Agjencia për aviacionin civil, që është trup i pavarur rregullator, është funksionale. Kështu, resurset njerëzore ende nuk janë përforcuar. Zvogëlimi i resurseve financiare të organit kompetent për aviacionin civil në ndryshimin e Ligjit për aviacionin nuk është zgjidhur. Për disa nga kushtet në fazën e parë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët të Aviacionit Evropian, që ka të bëjë me menaxhimin, sigurinë e aviacionit dhe sigurinë, zbatohen masat nacionale për zbatim. Me rregull janë transponuar disa pjesë të rëndësishme të legjislacionit për Hapësirën e Përbashkët Evropiane, por nevojiten përpjekje të rëndësishme që të përfundohet harmonizimi rregullator. Me qëllim që të plotëshen obligimet nga periudha e parë kalimtare në pajtim me Protokollin V nga Aneksi V në Marrëveshjen për HPAE-në, transponimi i rregullit për interoperabilitet dhe hapësirë ajrore dhe përdorim fleksibil të rregullave për hapësirë ajrore duhet të përfundojnë dhe hapësira ajrore duhet të rikonfigurojë në bllok funksional ajror. Edhe pse është themeluar Organi Mbikëqyrës Nacional, duhet ende të bëhen përpjekje që të sigurohet funksionimi i tij i drejtë dhe struktura e qëndrueshme. Fillimisht duhet të themelohet Komisioni për hulumtim të fatkeqësive në komunikacionin ajror. Kuadri në kompani për shërbime të aviacionit ka mungesë të profesionalizmit përkatës. Është përforcuar kapaciteti administrativ i sektorit për komunikacionin ajror në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Marrë në përgjithësi, ende ka mungesë të kapacitetit administrativ përkatës në sektorin për komunikacionin ajror. Përgatitjet në sferën e komunikacionit ajror janë përmirësuar në mënyrë modeste.

Nuk vërehet progres në fushën e **navigacionit satelitor**. Janë filluar përgatitjet për instalimin e ndihmës teknike për zbatimin e programit për navigacion satelitor, menjëherë pasi të bëhet funksional.

Konkluzion

Shënohet progres në fushën e politikës së transportit, veçanërisht në fushën e komunikacionit rrugor dhe hekurudhor. Është filluar zbatimi i takografeve digjitale. Është miratuar ligj i ri për interoperabilitet në komunikacionin hekurudhor dhe është themeluar Organ kompetent për siguri. Organi kompetent për siguri duhet të inkorporojë procedura për lëshimin e certifikatave për siguri. Kapaciteti administrativ për çdo organ rregullator duhet në mënyrë plotësuese të përforcohet. Komisioni për hulumtim të fatkeqësive në komunikacionin hekurudhor dhe ajror duhet të përforcohet që të funksionojë si trup i pavarur për hulumtim të fatkeqësive dhe incidenteve të rënda. Përgjithësisht vlerësuar, përgatitjet në fushën e politikës së transportit kanë përparuar.

4.15. Kreu 15: Energjetika

Mund të vërehet progres në fushën e **sigurisë në furnizim**. Legjislacioni është harmonizuar me direktivat për siguri në furnizimin me energji elektrike dhe furnizim me gaz natyror. Drejtoria për rezerva të domosdoshme të naftës dhe derivateve të naftës vazhdoi me zbatimin e programit afatmesëm 2010-2015 për formimin e rezervave të domosdoshme. Në fillim të shtatorit 2011, rezervat e naftës ishin të barabarta për konsum mesatar vetëm 33-ditor. Fillimisht duhet të arrihet harmonizim me direktivat e reja për rezerva të naftës. Në fushën e sigurisë gjatë furnizimit, shteti pjesërisht i plotëson qëllimet e veta.

Është arritur progres i mirë në fushën e **tregut të brendshëm të energjisë**. Është miratuar Ligj për energjetikë, gjithpërfshirës, i harmonizuar me obligimet që rezultojnë nga Marrëveshja për Bashkësi Energjetike. Ligji i ri për energjetikë parasheh hapje të plotë të tregut të energjisë elektrike kundrejt gjithë konsumatorëve përveç amvisërive, deri në mesin e vitit 2012 dhe i përforcon kompetencat dhe pavarësinë e Komisionit Rregullator për Energjetikë (KRRE). KRRE ka miratuar rregullore për licenca dhe për ndarjen e kapaciteteve tejkufitare transmetuese. KRRE ka ndryshuar Rregulloren për mënyrën dhe kushtet për rregullim të çmimeve për energji elektrike dhe filloi përgatitje për sistem të ri tarifor për transmetim dhe distribuim të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 2012. Programi për subvencione për konsumatorë të cenueshëm është vazhduar edhe për vitin 2011. Është zgjidhur kontesti me operatorin e sistemit përçues, si investitor kryesor i BE-së. Është mbyllur procedura për zgjidhje të kontestit të nisur nga Sekretariati i Bashkësisë Energjetike për këtë rast. Çmimet për energji elektrike për amvisëritë, në vitin 2011 janë zmadhuar për më shumë se 5%, por prapë nuk i pasqyrojnë shpenzimet. Rregullat e tregut ende janë në përgatitje. Shkalla e arkëtimit të llogarive për energji elektrike mbetet e pamjaftueshme për të siguruar qëndrueshmëri të sistemit.

Ligji i ri për energjetikë përcakton ndarje të furnizimit me gaz natyror nga bartja e gazit natyror. Pronësia e sistemit për bartje të gazit mbetet e pazgjidhur ndërmjet Qeverisë dhe kompanisë për distribuim të gazit.

Kapacitetet administrative të KRRE janë të përforcuara në mënyrë plotësuese: janë punësuar dy anëtarë të rinj të personelit, ndërkaq KRRE ka vazhduar të ketë dobi nga aktivitetet e përgjithshme për trajnim nga dy IPA projekte për vitin 2007. Numri i personelit të Sektorit për energjetikë në Ministrinë e ekonomisë ka mbetur i pandryshuar në 14. Kapaciteti administrativ mbetet i pamjaftueshëm që të mund të përkushtojë vëmendje në të gjitha sfidat në politikën energjetike. Shteti ka përparuar mesatarisht në fushën e tregut të brendshëm të energjisë.

Është arritur progres në fushën e **efikasitetit energjetik**. Në prill është miratuar Plani aksional për efikasitet energjetik në pajtim me obligimet e Grupit punues për efikasitet energjetik pranë Unionit Energjetik. Është zbatuar fushatë për kursim të energjisë. Ministria e ekonomisë ka miratuar Rregullore për etiketim dhe rregullore për impiante të kombinuara me shkallë të lartë të efikasitetit dhe Urdhëresë për eko-dizajn. Agjencia për energjetikë ende ka mungesë të resurseve të domosdoshme dhe kapaciteteve administrative që të mund në mënyrë efektive t'i promovojë efikasitetin energjetik dhe burimet e rigjenerueshme të energjisë. Shteti ka filluar t'i realizojë qëllimet e veta në fushën e efikasitetit energjetik.

Në fushën e **burimeve të rigjenerueshme të energjisë**, është miratuar Rregullore e re për burime të rigjenerueshme të energjisë dhe Urdhëresë për tarifa të autorizuara. Qeveria ka miratuar vendim për konfirmimin e qëllimit të rolit të energjisë së rigjenerueshme prej 21% deri në vitin 2020, dhe ka dërguar plan aksional më të thjeshtë për burime të rigjenerueshme të energjisë për zbatim të Strategjisë për shfrytëzimin e burimeve të rigjenerueshme të energjisë në Sekretariatit e Unionit Energjetik. Shteti, për herë të parë është kualifikuar për pjesëmarrje në thirrjen për parashtrimin e propozimeve për Programin për energji inteligjente në vitin 2011. Përsëri, Memorandumi për pjesëmarrje në program ende nuk është nënshkruar. 8 hidrocentralet e vogla të para në këtë moment janë në fazë të ndërtimit. Qeveria lëshoi leje për ndërtim të pilot fermës për aerogjeneratorë - Bogdanci, me kapacitet të instaluar prej rreth 50mW. Përgatitjet në fushën e burimeve të rigjenerueshme të energjisë janë në rrjedhë, por shteti nuk e shfrytëzon plotësisht potencialin e burimeve të rigjenerueshme të energjisë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për përmirësimin e pjesëmarrjes së energjisë së rigjenerueshme në konsumin e fudit të energjisë.

Shteti nuk ka **energji nukleare**. Është miratuar studim për vlerësimin e mundësisë për ndërtim të centralit nuklear, si mundësi që të plotësohet kërkesa e energjisë nga viti 2020.

Është arritur progres i caktuar rregullator në lidhje me **sigurinë nukleare dhe mbrojtjen nga rrezatimi**. Plani nacional për gjendje të jashtëzakonshme është miratuar në qershor. Së pari duhet të konstatohet harmonizimi me *acquis* të rregullativave ekzistuese që janë në fuqi. Është nënshkruar Memorandum për mirëkuptim për bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë për siguri nga rrezatimi (DSRR) dhe palët e saj kontraktuese në Mal të Zi. Kapaciteti administrativ i DSRR-së mbetet i mjaftueshëm; megjithatë, zbatimi i ligjit nuk mund të përcillet në mënyrë efikase, për shkak se DSRR ka vetëm dy inspektorë. Buxheti për vitin 2011 për DSRR, në mënyrë të konsiderueshme u reduktua dhe DSRR ende në aspektin financiar nuk është e pavarur nga Ministria e shëndetësisë, edhe pse ende është e angazhuar për licencim të praktikave mjekësore. Objekti i paraparë për depozitim të hedhurinave radioaktive ende nuk është licencuar: dizajni i tanishëm nuk i përmbush standardet ndërkombëtare dhe nuk është kryer vlerësimi i duhur i ndikimit mbi mjedisin jetësor.

Konkluzion

Është arritur progres i mirë në sektorin e energjetikës, veçanërisht në miratimin e ligjit të ri gjithëpërfshirës për energjetikë dhe në zgjidhjen e kontestit afatgjatë me operatorin e sistemit distributiv. Prapë, duhet të vendoset funksionim efikas i tregut të energjisë elektrike dhe të sigurohen kushte për konkurrencë. Potenciali i efikasitetit energjetik në shtet dhe burimet e rigjenerueshme të energjisë ende nuk janë shfrytëzuar në mënyrë adekuate dhe ende nuk është siguruar pavarësi financiare e rregullatorit për mbrojtje nga radiacioni. Përgatitjet në fushën e energjetikës shënojnë progres mesatar.

4.16. Kreu 16: Tatimimi

Është shënuar progres i kufizuar në harmonizim me legjislacionin në fushën e tatimit të tërthortë. Shkalla e *tatimit mbi vlerën e shtuar* (TVSH) për pajisje mjekësore dhe pajisje tjera për përdorim personal me qëllim të lehtësimit ose terapisë së invaliditetit është zvogëluar prej 18% në 5%, çka është në pajtim me *acquis* Pragu i regjistrimit të TVSH-së është zmadhuar prej vitit 2011 për afërsisht 32 000 €, që kryesisht është në pajtim me pragjet që aplikohen në disa shtete anëtare të BE-së. U ndryshua Ligji për akciza me qëllim të dekurajimit të abuzimit të vajrave minerale të shënuara si karburantë për automjete dhe jo për ngrohje dhe për rritjen e dënimeve për lloje të caktuara të kundërvajtjeve. Ligji për TVSH dhe për akciza janë vetëm pjesërisht në pajtim me *acquires*, disa procedura për akciza edhe mëtej mbeten më të ulëta nga ajo që është e domosdoshme në shkallë minimale. Përgatitjet në këtë fushë janë në vijim.

Në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë nuk është arritur progres. Është ndryshuar Ligji për tatimin mbi fitim, prapë duhet të zgjidhen disa çështje si për shembull diskriminimi potencial i personave jorezidentë në aspekt të pagesës së tatimit të dividendës dhe aplikimit të ardhshëm të Direktivës për ndërmarrje amë dhe shoqëri të varura. Lirimi nga tatimi mbi të ardhurat personale për të punësuarit në zonat zhvillimore teknologjike industriale është zmadhuar prej 5 deri në 10 vite. Vendosja e tatimit të kamatave të depozitave u anulua për vitin 2013. Progresi në përgatitjet nga kjo fushë relativisht përparon.

Është shënuar progres i kufizuar në fushën e **bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë**. Është nënshkruar marrëveshje për shmangie të tatimit të dyfishtë me Belgjikën. Numri i marrëveshjeve të lidhura me shtete anëtare të BE-së edhe mëtej është 23. Janë lidhur marrëveshje për shmangie të tatimit të dyfishtë me Kosovën dhe Norvegjinë. Prapë marrëveshjet nuk përfshijnë kthim të borxhit dhe shkëmbim të informatave.

Është arritur progres në fushën e **kapacitetit operativ dhe kompjuterizimit**. Me Ligjin e ndryshuar për regjistrim të pagesave të gatshme është përforcuar politika ndëshkimore. Me ligjin e ndryshuar dy herë për procedurën tatimore janë instaluar politika me të cilat u jepet mundësi obliguesve tatimorë t'i korrigjojnë parregullsitë, është qartësua politika ndëshkimore dhe u përmirësua procedura për ankesë me përfshirjen e Inspektoratit Administrativ Shtetëror për ankesa të cilat nuk zgjidhen në afatet juridike. Ndryshimi i Ligjit për Drejtorinë e të hyrave publike (DHP) kontribuoi për krijimin e kompetencave të reja të së njëjtës, duke

përfshirë arkëtim të kompensimeve dhe dënimeve nga procedura administrative dhe kundërvajtëse si dhe kompensime për leje për shërbime televizive dhe të radios. DHP e ka plotësuar planin e vet strategjik për vitin 2010-2013 dhe përpiloi plane aksionale për vitin 2011. Shërbimet e tatimpaguesve janë decentralizuar në mënyrë plotësuese dhe janë hapur sportele të reja tatimore për ofertë të shërbimeve ndaj tatimpaguesve. Drejtoria e të hyrave publike që është kompetente për obligues të mëdhenj tatimorë e zmadhoi numrin e shoqërive që i përfshin prej 235 deri 255. Aktivitete të përforcuara të revizionit u kombinuan me mjete të reja për vlerësim të rrezikut, u zmadhua arkëtimi i obligimeve të mbetura, u zgjerua parashtrimi elektronik i paraqitjes tatimore dhe deri në masë të caktuar është përforcuar kapaciteti i revizionit të brendshëm. U vendosën marrëveshje për monitorim horizontal me obligues tatimorë që të përmirësohet harmonizimi me inspektimin e kufizuar dhe u fillua me revizion të evidencës e cila nuk zbatohet në vendngjarje. Strategjitë intensive komunikative përmes mjeteve të arritshme të internetit, veglave për telekomunikim dhe publikime të reja sollën në rritjen e harmonizimit vullnetar. U mbajt trajnim për standarde profesionale dhe menaxhim dhe u zbatua sistemi i notimit të të punësuarve. Në kudër të DHP-së u themelua Qendra për pagesën e borxheve, Qendra për konfiskimin e mallrave, Akademia e tatimit për trajnim dhe njësi e posaçme për revizion për mbledhjen e informatave për rreziqe të larta të mashtimit dhe evitimit të tatimit. Filloi të vlejë Rregullorja e re për zbatimin e Ligjit për akciza dhe u miratuan udhëzime për procedura për kontroll të akcizave për gaz të lëngshëm të naftës. Përsëri edhe mëtej ka mungesë të personelit posaçërisht në fushën e revizionit. Kapaciteti TI i administratës së tatimit mbetet i dobët. Është e domosdoshme në mënyrë plotësuese përmirësimi i revizionit të brendshëm, pagesa e detyrueshme, hulumtimi i tatimit, revizioni i tatimit si dhe përpjekjet për zvogëlimin e ekonomisë joformale. DHP ka mungesë të kapacitetit për hulumtim të tatimit dhe kapacitet zbulues, ndërsa koordinimi me policinë financiare mbetet të përforcohet në mënyrë të rëndësishme. Kodeksi i sjelljes për tatimim të subjekteve afariste ende nuk është vendosur. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar.

Konkluzion

Mund të vërehet përparim i kufizuar në fushën e harmonizimit të legjislacionit së tatimit. Kapaciteti operativ për administrim të tatimeve vazhdoi të përmirësohet, përsëri duhet të kihet parasysh pagesa e detyrueshme, hulumtimi, revizioni, kapacitetet TI dhe kapacitetet e të punësuarve. Në rend të parë duhet të vendosen mjetet efektive për luftën kundër mashtimit tatimor dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale. Përgatitjet në fushën e tatimit janë në rrugë të mirë.

4.17. Kreu 17: Politika ekonomike dhe monetare

Në sferën e politikës monetare mund të vërehet përparim i rëndësishëm. Është miratuar ligj i ri për bankën qendrore, me të cilin paraqiten organizimi dhe aktivitetet e Bankës qendrore, statusi i saj juridik, pavarësia dhe marrëdhëniet e saja me parlamentin dhe qeverinë, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e saja pas aderimit në BE dhe eurozonë. Ligji i përket ndalimit për financim monetar të sektorit publik dhe ndalimit për qasje të privilegjuar për sektorin publik për tregjet financiare. Banka qendrore është përgjegjëse për aktivitetet monetare dhe të tjera, si kreditor i instancës së fundit dhe instrumenteve tjera të politikës monetare; shkalla e kursit devizor dhe mbajtjen e politikës për valutë të huaj; emetimi i bankënotave dhe monedhave; organizimin e sistemit të pagesës; mbikëqyrjen e institucioneve financiare; stabilitetin financiar, analiza statistikore dhe udhëheqjen e regjistrimit kreditor. Kapaciteti institucional dhe administrativ i Bankës qendrore është adekuat. Është përmirësuar kualiteti i statistikës monetare dhe harmonizimi i saj me standardet ndërkombëtare. Në sferën e politikës monetare, vendi është në pajtim me kërkesat.

Është arritur avancim i caktuar në sferën e **politikës ekonomike**. Programi i pestë paraaderues ekonomik (PPE), i cili përfshin e periudhën 2011-2013, është paraqitur me kohë. Prezantimi i informatave në PPE është përmirësuar, posaçërisht korniza fiskale dhe makroekonomike. Ende ekziston hapësirë për përmirësimin e llogaritjes së rezultateve dhe kualitetit të të dhënave për kapitalin themelor dhe për tregun e punës. Në pjesën strukturore i mungon përshkrimi gjithëpërfshirës për reforma. PPE ende nuk shfrytëzohet si dokument themelor për krijimin e politikës ekonomike. Kapaciteti administrativ i disa institucioneve qendrore shtetërore për formulimin dhe zbatimin e politikës ekonomike është rritur. Përsëri,

kapacitetet administrative të disa komunave, posaçërisht atyre më të vogla, mbeti i dobët. Përgatitjet në sferën e politikës ekonomike janë relativisht të avancuara.

Konkluzion

Është arritur përparim i rëndësishëm në sferën e politikës monetare dhe ekonomike. Është miratuar ligj i ri që i definon aktivitetet, organizimin dhe pavarësinë e Bankës qendrore. Është përmirësuar kualiteti i programit paraaderues ekonomik. Kapaciteti administrativ për zbatimin e politikës në mënyrë të rëndësishme ndryshon ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. Marrë përgjithësisht, përgatitjet në sferën e politikës monetare dhe ekonomike janë të avancuara.

4.18. Kreu 18: Statistika

Është arritur përparim në sferën e infrastrukturës statistikore. Është miratuar Ligji i ndryshuar për statistikë shtetërore nga Kuvendi dhe i njëjti e përforcoi rolin e Entit shtetëror për statistikë (ESHS) si koordinator i sistemit nacional statistikor dhe e avancoi vendosjen e parimit të Kodit Evropian statistikor në praktikë. Është miratuar strategjia e re për diseminim e të dhënave për vitin 2010-2012 dhe plani aksional për zbatimin e saj. Janë punësuar rreth 40 punëtor të rinj nga bashkësitë që nuk janë shumicë, me çka u përmirësua përfaqësimi i drejtë dhe gjendja e të punësuarve. Situata me resurset në ESHS duhet në mënyrë plotësuese të përmirësohen, por përgatitjet e përgjithshme në këtë sferë janë avancuar.

Është arritur përparim i caktuar në fushën e **klasifikimeve dhe regjistrave**. Është përgatitur klasifikimi nacional i profesioneve në pajtim me kualifikimin Standard ndërkombëtar të profesioneve ISCO-08. Është kryer baza e të dhënave për regjistër statistikor të fermave dhe janë përmirësuar procedurat për azhurnimin e saj. Përgatitjet në këtë sferë janë relativisht të përparuara.

Është arritur përmirësim i mirë në sferën e **statistikave të sektorëve**. Pas përgatitjeve intensive për regjistrimin e popullatës dhe ekonomive familjare, së pari i caktuar në prill të vitit 2011, regjistrimi u prolongua për në tetor të vitit 2011. Përsëri, Komisioni shtetëror për regjistrim arriti marrëveshje për përbërjen e ekipeve për regjistrim në mesin e shtatorit, që solli prolongimin e angazhimit dhe trajnimit të regjistruesve.

Ka përmirësime në statistikën bujqësore dhe rezultatet e anketës së parë të fermerëve u shpallën në vitin 2011. Marrë përgjithësisht, është arritur përparim në llogaritë nacionale, duke i përfshirë përmirësimet metodologjike në tabelat për furnizime dhe përdorim të llogarive tremujore; dhe në zhvillimin plotësues të llogarive të sektorëve. Është përforcuar bashkëpunimi ndërmjet ESHS dhe Ministrisë së Financave. Nuk është vendosur cili institucion duhet të jetë përgjegjës për statistikën e llogarive financiare. Është arritur përparim në statistikën afariste. Zhvillimi i statistikës strukturore afariste vazhdoi dhe të dhënat e para janë paraqitur nga EUROSTATI. ESHS vendosi përmirësime metodologjike në sferën e statistikës afatshkurte dhe i shpalli rezultatet e para sipas kualifikimi të ri të aktiviteteve ekonomike, NACEP. 2. U rrit numri i të dhënave që janë bartur te Komisioni Evropian dhe ESHS dhe prodhuesit tjerë të të dhënave statistikore inkurajohen ta vazhdojnë këtë trend. Përsëri, do të jenë të nevojshme përpjekja e rëndësishme dhe resurset financiare me qëllim të arritjes së harmonizimit të plotë me ESA 95, duke e përfshirë shfrytëzimin më të mirë të të dhënave. Janë përparuese përgatitjet në sferën e statistikave të sektorëve.

Konkluzion

Është arritur përparim në disa sfera, por së pari duhet të arrihet harmonizim i plotë në sferën e statistikës. Duhet të bëhen përpjekje të rëndësishme që të përmirësohen statistikën e sektorëve, posaçërisht për statistikën ekonomike. U rrit mesatarja e bartjes së të dhënave, por duhet të përforcohen përpjekjet. Janë përparuese përgatitjet në sferën e statistikës.

4.19. Kreu 19: Politika sociale dhe punësimet

Ekziston përparim i vogël në sferën e të **drejtës së punës**. U bënë disa ndryshime në Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për agjencitë për punësim të përkohshëm. Është i ngadalshëm implementimi i ligjeve të zbatueshme. Nuk janë të përforcuara në mënyrë plotësuese kapacitetet administrative të institucioneve përgjegjëse për implementimin dhe zbatimin e të drejtës së punës. Nuk është përmirësuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve relevante. Përgatitjet në këtë sferë janë ngadalësuar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e **sigurisë dhe shëndetit në punë**. Funkcionin këshilli nacional për siguri dhe shëndet gjatë punës. Numri i inspektorëve urrit në mënyrë të pakonsiderueshme dhe u sigurua trajnimi. Përsëri, kapaciteti inspektues mbetet i pamjaftueshëm. Vazhdon të jetë i lartë numri i inspeksionit të vendeve të punës në Inspektoratin shtetëror të punës. Në sferën e legjislacionit, u miratua Rregullore për rreze lidhur me ekspozimin e agjentëve biologjikë në punë. U përgatitën ndryshime të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës, që të harmonizohet në mënyrë plotësuese me Direktivën komizë 89/391/EEC. Mungesa e koordinimit ndërmjet organeve relevante ende e pengon finalizimin e strategjisë për zhvillim të mëtejshëm të sigurisë dhe shëndetit në punë. Ende nuk ka evidencë të konsoliduar të të dhënave për fatkeqësi në punë. Në përgjithësi, kapaciteti administrativ duhet të përforcohet, që të garantojë implementim të drejtë dhe zbatim të dispozitave ligjore,

Ekziston përparim i caktuar në sferën e **dialog social**. Këshilli ekonomik social takohet rregullisht. Tri sindikatat më të mëdha nënshkruan memorandum për bashkëpunim, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e tyre koordinuese në dialogun social. Dialogu i dyanshëm dhe i trianshëm social duhet në mënyrë plotësuese të përmirësohet dhe pjesëmarrja e partnerëve socialë në procesin e zhvillimit të politikave duhet në mënyrë plotësuese të zhvillohet. Përgatitjet në këtë sferë vazhdojnë të shënojnë përparim të ngadalshëm.

U arrit përparim i kufizuar në sferën e **politikës për punësim**. Nuk është zvogëluar punësimi në ekonominë informale. Inspektorati shtetëror i punës vazhdoi të zbatojë disa iniciativa në nivel qendror, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për nevojën e luftës kundër punës së paparaqitur. Përsëri, ndikimi është mjaft i kufizuar. Mungon bashkëpunim efikas dhe koordinim ndërmjet trupave për zbatim. Shkalla e papunësisë mbetet e lartë dhe pjesëmarrja e tregut të punës është ende shumë e ulët. Buxheti i dedikuar për programin aktiv të tregut të punës u zvogëlua për vitin e dytë dhe ende nuk është adekuat. Agjencia për punësim kryen analië të masave ekzistuese aktive të tregut të punës, por ende është pa qasje detajore ndaj monitorimit dhe evuluit. Përgatitjet në këtë sferë nuk janë shumë të përparura.

Shënohet progres i caktuar në përgatitjen për pjesëmarrje në **Fondin Evropian Social**. Fillori furnizimi i projekteve, të kofinancuara sipas Programit operativ "Zhvillim i resurseve njerëzore" (IV IPA komponenti), por ballafaqohet me prolongime të konsiderueshme, të cilat vënë në rrezik, pjesë të mjeteve. Ende nuk është i mjaftueshëm kapaciteti në suazat e ministrive kompetente, të përfshira në implementimin e këtij komponenti, në lidhje me numrin e personelit dhe ekspertizës. Përgatitjet në këtë fushë përparojnë.

Është arritur progres i caktuar për **inkluzion social**. Është miratuar strategjia nacionale për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social dhe janë përgatitur planet aksionale identike. Nuk është garantuar buxheti adekuat për implementimin e programeve operative. Ka filluar implementimi i programit nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale 2010-2012 me analizë të shërbimeve të decentralizuara për inkluzion social. Janë përgatitur plane aksionale lokale për inkluzion social në tetë komuna. Vazhdon kalimi nga kujdesi institucional në shoqëror, veçanërisht për njerëz me sëmundje mentale. Vazhdon të jetë i kufizuar progresi në fushën e decentralizimit administrativ dhe fiskal i shërbimeve sociale. Mbetet të vlerësohet ndikimi i plotë i gjendjes ekonomike mbi varfërinë; shkalla e varfërisë është ende e lartë. Shkallë e lartë e braktisjes së shkollës në vitet e hershme të arsimit është përmirësuar në mënyrë të pakonsiderueshme, por prapë mbetet i rëndësishëm, veçanërisht te fëmijët romë. Nuk përparon zbatimi i strategjisë nacionale për barazi të të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018. Gjithsej, duhet të mirëmbahet potenciali i politikave sociale. Progresi i implementimit të masave, të caktuara me planet e miratuara strategjike në lidhje me reduktimin e varfërisë, Romët, njerëzit me invaliditet dhe njerëzit tjerë të përjashtuar,

nuk kanë resurse njerëzore dhe financiare adekuate. Përgatitjet në këtë fushë janë në fazë të hershme.

Mund të shënohet progres i vogël në fushën e **mbrojtjes sociale**. Është ndryshuar Ligji për mbrojtje sociale dhe janë inkorporuar dispozita të reja për persona me shikim krejtësisht të dëmtuar dhe për persona me invaliditet fizik. Ngadalë vazhdon të zhvillohet zbatimi i Ligjit për mbrojtje sociale. Kapaciteti administrativ është ende i pamjaftueshëm, që të zhvillohet sistem i qëndrueshëm dhe i drejtë për mbrojtje sociale. Përgatitjet në këtë fushë janë avancuar relativisht.

Mund të shënohet progres i caktuar në fushën e **antidiskriminimi**. Filloi të implementohet ligji kornizë për antidiskriminim. Përsëri, ai nuk është tërësisht në pajtim me *acquis*, veçanërisht për shkak se në mënyrë eksplicite nuk e ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual gjatë punësimit ose profesionit. Në ligj janë paraqitur afati restriktiv prej tre muajve për ankesa dhe vëllimi i gjerë i përjashtimeve. Është formuar dhe ka filluar me punë Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, por ekziston brengosje në lidhje me funksionimin dhe pavarësinë e atij trupi. Ende duhet të përforcohet kapaciteti financiar dhe administrativ dhe ekspertiza e Komisionit dhe duhet të konstatohet e theksuar udhëheqja e evidencës. Veçanërisht kritik është kapaciteti administrativ i Sekretariatit të Komisionit. Sekretariati nuk ka resurse të mjaftueshme dhe pajisje që ta mbështetë punën e Komisionit. Organizatat e shoqërisë civile e përcjellin implementimin e të drejtës dhe aktiviteteve të Komisionit. Pjesa më e madhe e ankesave të parashtuara janë mbështetur në bazë etnike. Romët janë bashkësi e cila më së shumti pëson nga diskriminimi. Ende është shumë i kufizuar grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave. Përgatitjet në këtë fushë janë avancuar relativisht.

Mund të shënohet progres i vogël të **mundësitë e barabarta**. Janë vendosur mekanizma që t'i mundësojnë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale të ballafaqohet me ankesat për trajtim të pabarabartë. Përsëri, Sektori për mundësi të barabarta në suaza të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale akoma nuk ka resurse përkatëse njerëzore dhe financiare. Gjithashtu, mbesin jopërkatëse kapacitetet e komisioneve për mundësi të barabartat në nivel lokal. Mbetet e kufizuar mbështetja për aktivitetet dhe iniciativat e orientuara drejt luftës kundër zakoneve, traditave dhe stereotipeve diskriminuese. Zmadhohet shkalla e punësimit të gratë në 36%, por mbetet shumë e vogël në krahasim me mesataren e BE-së. Është bërë pak që të përmirësohen të drejtat e grave në sferat rurale.

Konkluzion

Është bërë progres i vogël në harmonizim me *acquis* në sferën e politikës sociale dhe punësimit. Shkallët e papunësisë dhe varfërisë mbesin të larta. Duhet në mënyrë plotësuese të zbatohen politikat për punësim efikas dhe inkluzion social. Është e ngadalshme përfshirja e romëve, personave me invaliditet dhe personave tjerë të përjashtuar socialë. Filloi të zbatohet ligji kornizë për antidiskriminim; përsëri, sa më shpejtë duhet të arrihet harmonizimi i tij i plotë me *acquis*. Në mënyrë plotësuese duhet të përforcohet dialogu social tripartit dhe dypartit. Kapaciteti i përgjithshëm administrativ është akoma i pamjaftueshëm. Përgatitjet në sferën e politikës sociale dhe punësimit nuk kanë përparim të lartë.

4.20. Kreu 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale

Është shënuar progres në fushën e **parimeve të ndërmarrjeve dhe politikës industriale**. Vazhdoi reforma rregullatore e punës afariste. Deri tani janë zbatuar 48 masa në pajtim me projektin "Gjotina rregullatore", si dhe 19 masa në pajtim me pakon e katërt antikrizë të karakterit të reformave. Këto masa kanë për qëllim reduktimin e dënimeve për kundërvajtje të vogla, aukcion publik të truallit ndërtimor në pronësi shtetërore të bizneseve me kushte të volitshme, thjeshtëzim dhe reduktim i shpenzimeve për leje ndërtimore, krijim i kushteve juridike për rregullim të objekteve afariste të cilat punojnë në zonën gri dhe pezullimin e tatimit mbi fitim për riinvestim në vend. Është përmirësuar sistemi njësportel për regjistrim të subjekteve afariste. Në mënyrë plotësuese është zgjeruar Regjistri Qendror me shtimin e regjistrimit për procedurë falimentimi dhe regjistër të personave të diskualifikuar të punojnë si menaxherë të firmave. Përsëri, futja e të dhënave, funksionaliteti dhe interoperabiliteti i regjistrave të ri duhet të sigurohet. Është zbatuar testim i 150 kompanive me qëllim të caktimit të pengesave me të cilat ballafaqohen subjektet afariste. Qeveria e ka vazhduar dialogun e rregullt me përfaqësues të biznes komunitetit dhe kompanive si dhe konsultimet në

aspekt të akteve juridike të lidhura me tregtinë dhe në aspekt të qëllimeve strategjike. Organet kanë marrë parasysh parimin “së pari mendo në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, megjithatë nevojitet punë shtesë dhe e domosdoshme në këtë fushë. Baza qendrore e të dhënave për të gjitha aktet juridike nuk azhurnohet rregullisht dhe ende nuk funksionon plotësisht. Është miratuar strategji për zhvillim të zejtarisë, megjithatë nuk janë ndarë mjete buxhetore për zbatimin e saj. Resurset njerëzore të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe Agjencisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme edhe më tej mbeten të pamjaftueshme. Në fushën e parimeve të ndërmarrjeve dhe politikës industriale, shteti relativisht ka përparuar; përsëri komuniteti i biznesit mbetet i dobët, me shkallë të ulëta të investimeve.

Është arritur përparim në fushën e **instrumenteve të ndërmarrjeve dhe politikës industriale**. Vendi edhe më tutje merr pjesë në programin e BE-së për sipërmarrësi dhe inovacion. U përpilua raport për përparimin inovativ dhe për herë të parë, vendi u përfshi në indeksin e BE-së për përparim inovativ për vitin 2010. Agjencisë për investime të drejtpërdrejta të huaja iu nda shuma prej 4.9 milionë eurosh dhe u krijua seksioni për çështje juridike dhe ndihmë zhvillimore për mbajtjen e investimeve. Buxheti i vitit 2011 për programet vjetore për ndihmën e konkurrencës, siparmarrësisë dhe punës së klasterëve është më i madh në mënyrë të konsiderueshme nga viti 2010. Ministria e Ekonomisë ndau rreth €173,000 për Programin për zbatimin e politikës industriale në vitin 2011. Krahas masave të reja që u ndërmorën për përfortimin e biznes bashkësisë, shërbimet që u siguruan nga disa organe qendrore dhe lokale akoma e pengojnë punën e pandërprerë të bashkësisë afariste. Tërheqja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) dhe zmadhimi i eksportit edhe më tutje mbetet fokusi kryesor i politikës ekonomike, por përsëri, instrumentet sa më shpejtë duhet t'i dorëzojnë rezultatet e dëshiruara. Është arritur progres mesatar në përgatitjet në fushën e instrumenteve të politikës, por të njëjtat mbesin joefektive.

Është arritur përparim i caktuar në fushën e **politikave të sektorëve**. U miratuan ndryshime të Ligjit për veprimtari turistike dhe akteve në lidhje me zbatimin, me qëllim që thjeshtëzimi i zbatimit të ligjit dhe skema për subvencione të bëhet më tërheqëse për të huajt. Programi për vitin 2011 për zhvillimin e turizmit u përcaktua në €932,000, që paraqet zmadhim prej 72% gjatë vitit 2010.

Konkluzion

Në fushën e ndërmarrjeve dhe politikës dhe parimeve industriale përparimi është i mirë por i pabarabartë, por dha dobi të vogël praktike në aspekt të ngritjes së ekonomisë. U thjeshtëzua legjislacioni dhe procedurat administrative për punën e subjekteve afariste u racionalizuan. Përsëri, masat për mbështetjen e ndërmarrjeve edhe më tutje mbesin të ndara nëpër disa programe të udhëhequra nga organe të ndryshme me financim të pamjaftueshëm.

4.21. Kreu 21: Rrjetet transevropjane

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **rrjeteve transportuese**. Vendi mban bashkëpunim aktiv sipas Memorandumit për mirëkuptim në lidhje me zhvillimin e rrjetit më të rëndësishëm rajonal transportues dhe vazhdoi me zbatimin e planit shumëvjeçar për periudhën 2011 – 2015 për Observatorin transportues të Evropës Juglindore. Është përfunduar aksi i autostradës së korridorit X, në afërsi të kufirit me Serbinë (Tabanovce - Kumanovë). Procesi i furnizimeve të aksit të autostradës Demir Kapi - Smokvicë, e kofinancuar nga IPA fondet, akoma nuk është përfunduar. Akoma mbetet të zbatohet përfortimi i kapaciteteve administrative me profesionalizëm teknik përkatës. Përgatitjet në sferën e rrjeteve transportuese shënojnë përparim mesatar.

Është arritur përparim në sferën e **rrjeteve energjetike**. Operatori i sistemit për transport e nënshkroi deklaratën për vendosjen e Zyrës së koordinuar për ankand në Evropën juglindore. Përgatitet për ndërtimin e largçuesit prej 400 kV me Serbinë kanë përparim plotësues. Është nënshkruar Memorandum për mirëkuptim ndërmjet dy operatorëve të sistemit për transport për ndërtimin e largçuesit të ri prej 400 kV me Shqipërinë (Manastir - Elbasan). Në sferën e rrjeteve energjetike, vendi shënon përparim mesatar.

Është arritur përparim në sferën e rrjeteve telekomunikative. Vendi ndërmori hapa që t'i shfrytëzojë fitimet nga Programi për mbështetjen e politikës për teknologji dhe komunikime informatike nga Programi kornizë për konkurrencë dhe inovacione.

Konkluzion

Është arritur përparim plotësues në sferën e rrjeteve transportuese. Marrë në përgjithësi, vendi vazhdon t'i zhvillojë rrjetet e veta transportuese dhe energjetike dhe të ketë pjesëmarrje aktive në Observatorin transportues të Evropës juglindore dhe në Bashkësinë energjetike. Akoma është prolonguar zbatimi i korridorit X, pasi që nevojitej periudhë plotësuese që të vendoset komizë financiare. Përgatitjet në sferën e rrjeteve transportuese shënojnë përparim mesatar.

4.22. Kreu 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Nuk është arritur përparim në **kornizën ligjvënëse** në këtë sferë. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme me qëllim që të sigurohet zbatimi i politikës të kohezionit në pajtim me rregullat dhe politikat e BE-së, veçanërisht në sektorin e mjedisit jetësor. Programimi dhe fleksibiliteti shumëvjeçar i buxhetit mbeten të pamjaftueshme. Përgatitjet janë me përparim mesatar në këtë sferë.

Përparim i kufizuar është vërejtur në aspekt të **kornizës institucionale**. Në pajtim me rekomandimet e revizorit, u bënë disa ndryshime në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit në suaza të Strukturave operative për IPA komponentët III dhe IV, duke përfshirë vlerësimin e pavarur dhe menaxhimin me kriza, si dhe procedurat për paraqitjen e parregullsive. Projekti për vendosjen e sistemit të decentralizuar për zbatimin pa 'ex-ante' kontrolle u përpilua dhe parashtrua në Komision. Nevojiten përmirësime të mëtutjeshme dhe të konsiderueshme me qëllim që të zmadhohet efikasiteti i strukturave operative të zhvillimit rajonal të IPA-s dhe programeve për zhvillimin e resurseve njerëzore. Kjo e përfshin tejkalimin e mungesës së koordinimit të ministrave në suaza të këtyre programeve. Përgatitjet kanë përparim mesatar në këtë sferë.

Përparim i caktuar dhe i kufizuar u arrit në sferën e **kapacitetit administrativ**. Analiza e peshës së punës dhe planeve për rekrutim për vitin 2011 u përpilua nga ana e institucioneve relevante të IPA-s, siç janë Fondi nacional, CFCD-ja dhe të gjitha ministrive horizontale/institucioneve të interesuara që janë pjesë e strukturave operative. Trajnimi u krye në bazë të Planit për trajnim për vitin 2010 – 2011. Arritja e kufizuar e ekspertëve përkatës e pengon procedurën për furnizime për disa programe; ministrinë përkatëse akoma duhet të tregojnë se kanë përgjegjësi të plotë gjatë zbatimit të programeve. Përforcimi i mëtutjeshëm esencial i kapacitetit administrativ është i nevojshëm në të gjitha institucionet me nxjerrjen e dobisë së tërësishme nga trajnimet dhe mësimin nga përvoja e fituar në pajtim me komponentët përkatës të IPA-s. Kapaciteti administrativ i vendit në këtë sferë mbetet i pamjaftueshëm.

Përparim i kufizuar është arritur në aspekt të **programimit**. Ndryshimet e pjesshme të bëra në programet operative dhe përgatitjet për operacionet identifikuese dhe projektet e mëdha vazhdojnë në mënyrë të pjesshme me ndihmën e IPA-s. Përsëri, zhvillimi i linjës projektuese mbetet çështje e rëndësishme, veçanërisht në sektorët e arsimit dhe mjedisit jetësor. Duhet të përforcohet kapaciteti administrativ në sferën e programimit dhe përpilimit të projekteve. Përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim.

Është arritur përparim në sferën e **monitorimit dhe vlerësimit**. U themeluan sistemi informatik për menaxhim (SIM) dhe komiteti për menaxhim me vlerësim në pajtim me IPA komponentën IV. Vlerësimi i përkohshëm i IPA komponentës III akoma nuk zbatohet. Vlerësimi i përkohshëm i IPA komponentës IV ka përfunduar. Përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim.

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **menaxhimit dhe kontrollit financiar**. Nëpunësi nacional për autorizim i parashtroi kërkesat e para të përkohshme për pagesën për Komponentën III dhe Komponentën IV, si dhe pagesën e parë me para në dorë për Komponentë I. Organi i revizionit u themelua në qershor të vitit 2011, por, me prolongim të konsiderueshëm të hyrjes në fuqi të Ligjit nacional për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese. Nominimi i kryetarit të organit të revizorit e ngriti çështjen për kriteret e

zgjedhjes. Kapaciteti administrativ sipas Sistemit të decentralizuar për zbatim (SDZ) është përmirësuar në aspekt të kuadrit dhe trajnimit të domosdoshëm, por mbetet i pamjaftueshëm. Përgatitjet në këtë sferë shënojnë përparim.

Konkluzion

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e zhvillimit rajonal dhe koordinimit të fondeve strukturore. Zbatimi i programeve operative të IPA-s për zhvillim rajonal dhe zhvillim të resurseve njerëzore shënon përparim, por është me dinamikë më të dobët se sa ajo e domosdoshmja, me qëllim që të ketë dobi të plotë nga resurset në dispozicion dhe të shmangët derdhja e mjeteve. Mungesa e ekspertizës përkatëse dhe koordinimit të mjaftueshëm institucional e pengoi përgatitjen e operacioneve/projekteve dhe procedurën për furnizime. Ministrinë relevante akoma duhet të tregojnë kontroll të tërësishëm mbi zbatimin e programit. Marrë në përgjithësi, mund të shënohet përparim mesatar në sferën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore.

4.23. Kreu 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore (shih edhe Kriteret politike)

Është arritur përparim i caktuar në sferën e **gjyqësorit**. U miratuan ndryshime të shumta të legjislacionit që përfshijnë spektër të gjerë të çështjeve; përsëri, problemet thelbësore në lidhje me pavarësinë, kompetencën dhe efikasitetin duhet të zgjidhen sa më shpejt në praktikë.

Sa i përket pavarësisë së gjyqësorit, anëtarësimi me detyrë zyrtare të ministrit të Drejtësisë në Këshillin gjyqësor u ndryshua. Ministri i Drejtësisë tani merr pjesë në punën e Këshillit gjyqësor pa të drejtë vote, në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Venedikut. Anëtarësimi i ministrit me detyrë zyrtare në Këshillin e prokurorëve publikë u mënjanua.

U ngritën procedura për shkarkim kundër 13 gjyqtarëve në vitin 2010, që rezultoi në 7 vendime për shkarkim (në krahasim me 10 në vitin 2009). 5 gjyqtarë dhanë dorëheqje, duke përfshirë edhe atë gjatë procedurës për shkarkim. Nuk u ngrit procedurë disiplinore kundër asnjë gjyqtari (në krahasim me 2 në vitin 2009). Nevojiten përpjekje plotësuese për t'u mbrojtur siguria e mandatit të gjyqtarëve, duke e përfshirë edhe nevojën për përkufizim të qartë dhe legjislacion të parashikuar duke ekspozuar baza me vëllim më të vogël dhe më të sakta për shkarkim dhe baraspeshë më të mirë ndërmjet procedurave disiplinore dhe procedurave për shkarkim. Ndryshimet e fundit të Ligjit për gjykata nuk arritën t'i përfshijnë mangësitë, por shtoi shkaqe plotësuese për shkarkim që mund ta cenojnë marrjen e pavarur të vendimeve.

Sa i përket paanshmërisë së gjyqësorit, ndarja e rastësishme e rasteve është funksionale në të gjitha gjykatat nga viti 2010, si pjesë e Sistemit për menaxhim automatik me lëndët gjyqësore (SMALGJ). Asnjë gjyqtar nuk iu nënshtrua procedurës së shkarkimit në bazë të paanshmërisë ose mospjesëmarrjes që në mënyrë të barabartë të trajtohen partitë gjatë vitit 2010 (në krahasim me 3 në vitin 2009). Gjithsej 11 trajnime me temë në lidhje me etikën gjyqësore, korrupsionin dhe konfliktin e interesave u realizuan gjatë periudhës së njoftimit.

Sa i përket profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqësorit, Ligji për gjykata u ndryshua që në hollësi të përcaktohen kushtet e arsimit për gjyqtarë, duke përfshirë njohjen e detyrueshme të gjuhës angleze, si dhe vendosjen e testit psikologjik dhe etik. U vendosën kushte të reja minimale për stazhin gjyqësor permanent prej 4 dhe 6 vjet për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme, në mënyrë përkatëse. Përsëri, hyrja në fuqi e këtyre dispozitave është e prolonguar deri në mesin e vitit 2013 me çka në mënyrë të konsiderueshme prolongohet ndikimi pozitiv mbi profesionin.

Gjenerata e tretë e kandidatëve të Akademisë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë (ATGJPP) që përbëhet prej 10 gjyqtarëve dhe 7 prokurorëve, me sukses e përfundoi trajnimin fillestar në fund të vitit 2010. ATGJPP, gjithashtu vazhdoi të sigurojë trajnim vijues për gjyqtarët e punësuar, prokurorët dhe target grupet tjera në sferën e drejtësisë me gjithsej 240 seminare, konferenca dhe punëtori të realizuara në periudhën e njoftimit, në dobi të gjithsej 7156 pjesëmarrësve. Në përgatitje është trajnimi i trajnuesve për zbatimin e Ligjit të ri për procedurë penale që hyri në fuqi në nëntor të vitit 2012. Prej 71 studentëve të diplomuar të ATGJPP prej nga tre vitet e fundit, deri më tani vetëm 49 janë punësuar si gjyqtarë dhe prokurorë. Në kundërshtim me këtë, punësimet në gjykata jashtë ATGJPP-së vazhduan edhe këtë vit, sipas dispozitave kalimtare që janë prolonguar deri në vitin 2013. Në periudhën e njoftimit, nga gjithsej 26 vende të arritshme për gjyqtarë nga instanca e parë, vetëm 6 u plotësuan

me studentë të diplomuar nga ATGJPP-ja edhe krahas shkallës solide të aplikimeve nga ana e kandidatëve. Teprica e gjyqtarëve (më shumë se 50% të përcaktuar në dispozitat kalimtare) janë emëruar nga ana e Këshillit gjyqësor nga radhët e profesioneve tjera juridike.

U vendosën dispozita të reja për kontrollin dhe vlerësimin e punës së gjykatësve me ndryshimet e Ligjit për këshillin gjyqësor. Ata duan të përmirësojnë funksionimin e sistemit gjyqësor me vendosjen e procedurës disiplinore në nivel të gjykatësve individualë, megjithatë, ato nuk kanë të bëjnë me cilësinë e aktgjykimeve dhe nuk janë të lidhura me nevojat për trajnim. Përkundrazi, theksimi i qëllimeve dhe afateve, si dhe lidhshmëria e procedurës për shkarkim mund të kenë efekt negativ mbi pavarësinë. Këshilli gjyqësor përfundoi vlerësimin e punës një vjeçare të 605 gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave për vitin 2010. Vetëm një gjykatës u vlerësua me "nuk kënaq".

Sa i përket efikasitetit të gjyqësorit, Këshilli gjyqësor mori vendim për numrin e rasteve të cilat duhet të përpunohen në nivel mujor nga ana e gjykatësve në instanca të ndryshme gjyqësore, si dhe për metodologjinë e gradimit të kompleksitetit të rasteve në bazë të lëndës. Meqë qëllimi kryesor i këtyre masave është të përmirësohet efikasiteti, duhet pasur kujdes të mënjanohet zbatimi formal tej mase i qëllimeve në llogari të cilësisë së mirë, me marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur.

Kohëzgjatja e përgjithshme e proceseve gjyqësore ende paraqet sfidë dhe me këtë është penguar aftësia e shtetit të përballet me të dhëna jo përkatëse statistikore. Në korrik të vitit 2011, u miratua metodologjia për grumbullimin, analizimin dhe përpunimin e të dhënave gjyqësore në bazë të udhëzimeve të Komisionit Evropian për efikasitet të drejtësisë (KEED). Megjithatë, kjo do të zbatohet vetëm nëpërmjet SAUSP deri në fund të viti 2012, pas zhvillimit dhe testimit të softuerit të nevojshëm. Duhet marrë informata të plota dhe të zbatueshme për kohëzgjatjen mesatare të llojeve të ndryshme të procedurave, duke marrë parasysh të gjitha instancat dhe zbatimin. Është me rëndësi të identifikohen dhe sugjerohen procedura të gjata dhe rastet e ngelura gjyqësore të cilat kanë ndikim negativ mbi të drejtat themelore të qytetarëve për qasje te drejtësia, si dhe atraktiviteti i shtetit për investime të huaja të drejtpërdrejta. Gjatë vitit 2010, Gjykata Supreme pranoi 398 ankesa në lidhje me procedurat tepër të gjata. Gjatë periudhës së njëjtë ajo vërtetoi 137 ankesa dhe lejoi kompensimin në 124 raste. Shuma e përgjithshme e parave është rreth 160 000 euro.

Në bazë të ndryshimeve ligjore në vitin 2010 rreth 400 000 lëndë të përfunduara do të barten nga sistemi gjyqësor te përmbaruesit profesionistë gjyqësor ose të mbyllur në gjysmën e dytë të vitit 2011, ndërsa rreth 37 000 fletëpagesa do tu barten noterëve. Rreth 90 000 dënime penale dhe kundërvajtëse tani më janë transferuar në Drejtorinë e të Hyrave Publike për zbatim dhe 43 000 duhet të transferohen. Ende nuk mjafton numri i përmbaruesve (90 nga 132 të planifikuar) veçanërisht për pjesën veriperëndimore të shtetit. Për momentin ka mbi 111 000 lëndë aktive përmbaruese me të cilat veprojnë përmbaruesit gjyqësorë. Kompetenca për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës supreme është transferuar nga Gjykata supreme te Gjykata Supreme Administrative e posafomuar e cila filloi të funksionojë në korrik të vitit 2011. Kjo do të ulë vëllimin e punës së ardhshme të gjykatës paraprake. Mbetet të shihet si do të jetë ndikimi i këtyre ndryshimeve mbi gjatësinë mesatare të proceduarës në të gjitha nivelet. Riorganizimi i kompetencave nuk mundet vetë të sigurojë efikasitet dhe cilësi të drejtësisë, përveç nëse shoqërohet me resurse përkatëse, trajnim dhe rregulla procedurale të përmirësuara për mbështetje të funksionimit të pandërprerë të sistemit gjyqësor.

Sa i përket zgjidhjeve alternative të kontesteve, disa ligje u ndryshuan për tu avancuar mediacioni në rastet e mbrojtjes qytetare, penale, kundërvajtëse, e të miturve dhe mbrojtja e konsumatorëve dhe u përpilua doracak për trajnim të mediatorëve. Numri i mediatorëve të certifikuar për momentin është 177. Ndërmjet prillit dhe qershorit të vitit 2011 u dha iniciativa për mediacion të lirë në kontestet komerciale në Gjykatat Themelore Shkup 2 dhe 22 raste ishin drejtuar kaht meditacioni i lirë. Megjithatë, në tërësi, niveli i marrje së mediacionit ende është i vogël.

Me ndryshimet më të reja të Ligjit për buxhetin gjyqësor u përfshi rritja e mjeteve nga buxheti i shtetit prej 0,4% deri në 0,8% të BPV që do të arrihet gradualisht deri në vitin 2015. Në praktikë, progresi i më tejme pengohet nga financimi jo adekuat. Objektet e reja të Gjykatës themelore Shkupi 1 dhe i Zyrës së Prokurorisë publike (ZPP) janë në ndërtim, por strategjia për përmirësimin e kushteve të punës dhe infrastrukturës TI të ZPP nuk janë zbatuar për shkak të kufizimeve buxhetore, ndërsa AOSJO ka mungesë të kuadrit dhe të lokaleve përkatëse, duke pasur parasysh numrin e madh të stërvitjeve që i organizojnë.

Sa i përket qasjes së drejtësi, ka pasur 174 aplikime për ndihmë juridike nga të cilat 141 janë shqyrtuar nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa 58 janë miratuar. Ekzistojnë 211 avokatë dhe 2 shoqata të

qytetarëve të regjistruara si ofrues të ndihmës juridike. Buxheti vjetor për ndihmën juridike për momentin është 100 000 euro. Sistemi i ndihmës juridike ende është në fazën e hershme të zhvillimit.

Sa i përket transparencës dhe marrëdhënieve me publikun, Këshilli Gjyqësor ka shqyrtuar 1581 ankesa të qytetarëve lidhur me punën e gjyqtarëve dhe gjykatave në vitin 2010 dhe 808 në gjysmën e parë të vitit 2011. Ato kryesisht kishin të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurës, dështimin e caktimit të gjykimit ose datës për dëgjim, moszbatimin e aktgjykimeve dhe dështimin për harmonizim me afatet procedurale. Janë bërë ndryshime në Ligjin për këshillin gjyqësor, që nënkupton detyrim për të mbajtur mbledhje publike të paktën një herë në muaj për të diskutuar për ankesa të tilla. Me ndryshimet e Ligjit për gjykata vendosen zyra për marrëdhënie me publikun në të gjitha gjykatat dhe gjykatat janë të detyruara të publikojnë aktgjykimet e tyre në faqet etyre të internetit brenda dy ditëve nga dita e miratimit, në mënyrë që të rritet transparenca e punës së tyre. Deri tani janë shpallur rreth 72 000 aktgjykime.

U arrit përparim i caktuar në sferën e politikës antikorruptive. Kodi penal u ndryshua që të përmirësohet vëllimi inkriminimit për mito dhe tregtisë nën ndikim dhe të vendoset përgjegjësi penale për mosukses të paraqiten tatimet dhe mjete tjera të cilat përdoren për financim në fushatat zgjedhore.

Me ndryshimin e Kodit Zgjedhor është vendosur kusht të dorëzohen raportet financiare në të gjitha fushatat zgjedhore në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, Entin Shtetëror për Revizion dhe Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (ESHPK) brenda 15 ditëve nga përfundimi i fushatës, të publikohen menjëherë në faqet përkatëse të internetit të këtyre trupave.

Ndryshimet u miratuan me qëllim që të zbatohet raundi i tretë i rekomandimeve të GREKO-s për inkriminim dhe transparencë për financim të partive. Kodi i ri i procedurës për kundërvajtje, i cili u miratua në nëntor të vitit 2010 dhe hyri në fuqi në nëntor të vitit 2012, ka për qëllim ta forcojë rolin e prokurorit publik në procedurën parahetimore dhe të vendosë numër të madh të masave të posaçme hetimore. Duhet të miratohet Programi Shtetëror 2011-2015 për preventivë dhe mënjanim të korrupsionit dhe programit shtetëror për zvogëlimin e konflikteve të interesit, si dhe planet e tyre përkatëse aksionale. Për të marrë parasysh rekomandimet e GREKO-s, duhet të ndryshohet Ligji për financimin të partive politike. Konventa e OECD-së për parandalim korruptimit të nëpunësve të huaj publikë në transaksionet afariste ndërkombëtare së pari duhet të ratifikohet.

Ekzistojnë disa trupa që kanë për detyrë të luftojnë kundër korrupsionit . KSHPK, Njësia e anti-korrupsionit në kuadër të Departamentit të kimit të organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Avokatia themelore publike për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë mungesë të personelit dhe financave. Formimi i qendrave për hetim në bazë të Ligjit të ri për procedurë për kundërvajtje do të kërkojë rritje prej 30% të numrit të prokurorëve dhe kuadrit për ndihmë. Edhe më tej mbetet i pamjaftueshëm specializimi i përmbaruesve gjyqësorë dhe i gjyqësorit në nivel lokal, sidomos në korrupsione të vogla. Edhe pse Ligj për parandalim të korrupsionit u ndryshua që të përsoset KSHPK, besimi i publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij mbetet i brishtë. Qasja e tij është ende reaktive, jo proaktive, ndërsa ndikimi i tij mbi përparimin e politikave të antikorruptonit është i dobët. Në vitin 2010, KSHPK mori 457 ankesa të reja ose raporte për korrupsion dhe paraqiti 14 kërkesa për Avokatinë e popullit (AP) për të filluar ndjekje penale.

Pjesa më e madhe e rasteve të korrupsionit të hetuara dhe të dhëna para gjyqit edhe më tej janë për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe për mashtrim. Kishte 83 aktgjykime për vepra penale të lidhura me korrupsion në vitin 2010 dhe deri tani 58 aktgjykime në vitin 2011. Kapaciteti i gjykatave të merret me raste të ndjeshme të nivelit të lartë të korrupsionit mbetet i dobët. Gjykatat edhe më tej zbatojnë dënime të buta. Numri i rasteve në të cilat ishte urdhëruar sekuestrimi ose konfiskimi i pronës, mbetet i vogël. Vendimet nga prokurorët publikë për të mos u parashtruar akuzë ende nuk janë të shqyrtuar nga gjykatat. Mungesa e statistikës së konsoliduar që në mënyrë të qartë e përcjell hetimin, ndjekjen, aktgjykimin dhe shqiptimin e dënimeve lidhur me rastet e korrupsionit është dobësi të cilës duhet t'i kushtohet vëmendje në mënyrë që të lehtësohet përgatitja e strategjive për luftë kundër këtij fenomeni dhe që të informojnë publikun më mirë për përparimin në luftimin e tij.

Në vitin 2010, Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme paraqiti padi penale kundër 29 nëpunësve të policisë, duke përfshirë 16 raste të keqpërdorimit të dyshuar të pozitës zyrtare. Pesë nëpunës policorë nga një kalim kufitar janë akuzuar si pjesë e operacioneve të mëdha policore. Drejtoria doganore duhet t'i japë prioritet rrezikut të lartë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të ardhshme për anti-korrupsion.

Gjatë periudhës raportuese, 496 lista anketuese janë dorëzuar nga nëpunësit publikë me zgjedhje, emërim ose skadim të mandatit. KSHPK vendos për herë të parë, procedurë për kontroll sistematik të listave anketuese, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencinë për Kadastër, Regjistrin Qendror, Depozitarin Qendror për Letra me Vlerë dhe DHP-në. Ndërmjet prillit dhe qershorit të vitit 2011 janë konfirmuar 9 prej 122 listave anketuese të dorëzuara nga personat zyrtarë nga pushteti ligjvënës, 28 prej 124 listave anketuese nga pushteti ekzekutiv dhe 89 prej 913 listave anketuese nga pushteti gjyqësor. KSHPK dërgoi 30 raste në të cilat ekziston mospërputhja e DHP-së për procedurë të mëtejshme.

KSHPK pranoi 620 deklarata për konflikt të interesave dhe dorëzoi 202 kërkesa për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për mospërputhjen që të dorëzohet deklaratë e tillë, duke përfshirë edhe kundër një deputeti, 4 kryetarëve të komunave dhe 8 gjyqtarëve. Gjithashtu, pranoi 95 kundërshtime me të cilat kërkohet të caktimi i konfliktit të interesit. Ndryshimet e Ligjit për konflikt të interesave dhe aktet nënligjore për përcaktimin e procedurës për kontrollim të përmbajtjes së deklaratave të tilla së pari duhet të miratohen.

Sa i përket Ligjit për financimin e partive politike, 16 parti politike dorëzuan llogari vjetore për punën financiare të Entit Shtetëror për Revizion (ESHR), 8 parti dorëzuan raportet vjetore financiare, 6 parti dorëzuan raporte tremujore të donacioneve për gjysmën e dytë të vitit 2010 dhe 7 parti dorëzuan raporte tre mujore për tatim për gjysmën e parë të këtij viti. Të gjitha partitë politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare në qershor të vitit 2011 paraqitën raporte financiare për fushatën zgjedhore, duke përfshirë edhe donacione, në lidhje me Kodin Zgjedhor. ESHR filloi me revizion të këtyre raporteve në shtator.

Numri i ankesave të paraqitura në Komisionin Nacional për mbrojtjen e të drejtave për informata me interes publik u rrit nga 340 në vitin 2009 në 540 në vitin 2010. Numri më i madh i tyre ishin të parashtruara nga organizatat qytetare, arsyeja më e zakonshme ishte mosveprimi i poseduesit të informatave. Informatat e lidhura me shpenzimet publike dhe më tej janë përjashtime të shumta të përcaktuara në ligj.

Akademia për stërvitje të gjykatësve dhe prokurorëve publikë (ASGJPP) zbatoi 13 trajnime për 373 pjesëmarrës për dispozitat e reja të Kodit Penal në lidhje me konfiskimet e zgjeruara dhe pasurimet të paligjshëm dhe 6 trajnime kanë marrë pjesë 162 pjesëmarrës rryshfeti i gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve ligjorë.

U arrit përparim i kufizuar në sferën e të drejtave themelore.

Zyra e avokatit të popullit pranoi 4043 ankesa në vitin 2010 (ritje prej 11% prej vitit 2009) Janë konstatuar kundërvajtje në 20% të rasteve në të cilat është punuar (987 prej 4828) dhe rekomandimet e Avokatit të popullit ishin të pranuar në 791 raste që paraqet ritje prej 71 % prej vitit 2009. Numri më i madh për kundërvajtje janë konstatuar në sferën e të drejtave të pronësisë (19%), të drejtave të konsumatorëve (12,4%) dhe të gjyqësisë (10%). Komisionet e Qeverisë të instancës së dytë dhe më pak i përgjigjen udhëzimeve të Avokatit të Popullit, sipas njësive të vetadministrimit lokal. U punësuan tre persona për secilin nga të tre seksionet e reja të Zyrës së Avokatit të Popullit që kanë të bëjnë me antidiskriminimin, luftën kundër torturës dhe veprimin çnjerëzor ose poshtëruës dhe me të drejtat e fëmijëve, në mënyrë përkatëse.

Kishte përparim të kufizuar në lidhje me ndalimin për torturë dhe veprim çnjerëzor ose poshtëruës. Seksioni i specializuar i Avokatit të popullit për luftë kundër veprimin çnjerëzor ose poshtëruës, që është i përcaktuar si mekanizëm parandalues nacional për zbatimin e Protokollit fakultativ të Konventës kundër torturës, filloi punën në prill. Gjithashtu, për plotësimin efektive të misionit të tij, mungojnë pushteti dhe resurset. Seksioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale e intensifikoi përcjelljen e punës së policisë. Ai e rriti bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe avokatinë Publike në kryerjen e mbikëqyrjes në sjelljen e policisë. Megjithatë, së pari duhet të transformohet në organ që është plotësisht i pavarur nga policia me aftësi për zbatimin e hetimeve efikase . Numri i rasteve të veprimin çnjerëzor apo veprimin poshtëruës të shprehur para gjykatës ishte për 27 vepra penale kundër 29 nëpunësve të policisë në vitin 2010, krahasuar me 36 vepra penale kundër 50 nëpunësve të policisë në vitin 2009. Nuk ishin paraqitur rastet të burgimit të paligjshëm.

U arrit përparim i kufizuar në lidhje me sistemin e burgut. U miratua në doracak për mbikëqyrje në institucionet ndëshkuese përmirësuese. Në dhjetor të vitit 2010, u miratua programi për stërvitje të detyrueshme të personelit të burgut, si dhe për standardet ndërkombëtare dhe për të drejtat e njeriut, ndërsa u zbatun disa stërvitje. Vazhdon ndërtimi dhe rekonstruimi i paraburgimeve dhe burgjeve.

Krahu gjysmë i hapur i burgut të Idrizovës është renovuar; megjithatë, pjesë nga burgu dhe më tej janë nën standarde të nevojshme. Vendi ende duhet të zhvillojë plane strategjike gjithëpërfshirëse për zgjidhje të sfidës të menaxhimit të sistemit të burgjeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Duhet të forcohet kapaciteti i Drejtorisë për Kryerjen e Sanksioneve për përcjelljen e reformave në burg.

Në lidhje me lirinë e të shprehurit të medieve në përgjithësi përdoret kornizë ligjore, por duhet të kushtohet vëmendje që të garantohet se zbatimi i tij është i qëndrueshëm dhe transparent dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Trajnime të caktuara që kanë të bëjnë me gazetarë dhe gjykata nuk u realizuar, por në këtë sferë, është i domosdoshëm trajnim më sistematik dhe ngritje e vetëdijes. Në vitin 2011, Shoqata e Gazetarëve ka mbajtur një sërë konsultimesh për zhvillimin e vetërregullimit për mediet e shtypit dhe ato elektronike. Në vitin 2010, është themeluar sindikata e parë e pavarur e gazetarëve dhe të punësuarve në media.

Megjithatë, shpifja nuk është dekriminalizuar. Në vitin 2010, ka pasur 587 raste për shpifje të parashtruara në gjykatë, nga të cilat 139 ishin kundër gazetarëve. Niveli i gjobave të vendosura është shpesh i madh në krahasim me rrogën mesatare mujore, ndërsa kjo mund të çojë në vetcensurë. Mediumet edhe më tej mbeten subjekte në ndikim të interesave politike dhe ekonomike. Frikësimi i gazetarëve dhe zbatimit selektiv të ligjeve kundër kompanive të medieve janë në rritje arsye për shqetësim. Zbatimi i evidencës së të dhënave kundër koncentrimit të medieve është i ulët, i penguar pjesërisht nga mungesa e transparencës së pronësisë.

Nuk ka përparim në lirinë e tubimit dhe shoqërimit. Ende nuk është formuar Komisioni i Qeverisë me status të interesit publik. Legjislacioni për tatime nuk është harmonizuar me Ligjin për shoqata dhe fondacione, me çka pengohet qasja në përfitimet tatimore dhe realizimin e aktiviteteve të caktuara ekonomike.

Është siguruar në përgjithësi liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit.

U arrit përparim i vogël për të drejtat e grave dhe barazisë gjinore. Politikës së Sektorit për të drejtat e barabarta në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale i mungojnë profesionalizëm përkatës dhe resurset njerëzore. Kapacitetet financiare të sektorit janë shpërfillëse. Edhe krahas përpjekjeve për përfundim të kapaciteteve të komisioneve lokale për mundësi të barabarta, ata ende përballen me mungesë të ekspertizës dhe vullnetit politik. U zbatuan vetëm aksione shumë të kufizuara të dedikuara për gratë Rome. Pjesëmarrja e grave në jetën politike në nivel lokal mbetet e dobët .. Puna në këtë sferë është ende në fazën e hershme.

U arrit përparim i caktuar në lidhje me të drejtat e fëmijëve. U miratua strategji nacionale për parandalimin e delikuencës së të miturve dhe u ndryshua Ligji për të drejtën e të miturve, duke sjellë përmirësime në lidhje me ndihmën juridike falas, ndërmjetësimin dhe të drejtat procedurale të të miturve. Zbatimi i drejtë i Ligjit dhe Planit Akcional 2010-2012 kërkon resurse shtesë financiare dhe administrative, koordinim më të ngushtë ndërmjet institucioneve përkatëse, miratim të standardeve dhe protokolleve për zbatimin dhe zhvillimin e sistemit gjithëpërfshirës për monitorim. Gjithashtu, të nevojshme janë përpjekjet e mëtejshme për forcimin e kapaciteteve të personelit të specializuar për t'u marrë me të miturit, për të përmirësuar kushtet e paraburgimit dhe për të siguruar arsim dhe shërbime shëndetësore për të miturit në paraburgim. Fëmijët me nevoja të veçanta psikologjike dhe intelektuale edhe më tej janë grup i cenueshëm, ndërsa nuk ka institucione të specializuara mjekësore që u janë përkushtuar atyre. Kritike është mungesa e resurseve dhe kapaciteteve nga qendra për punë sociale. Përgatitjet në këtë sferë janë në fazë të hershme.

Mund të vërehet një përparim i kufizuar në veprimin me personat e cenueshëm dhe / ose personat me nevoja të veçanta. Për tu vendosur dispozita të reja për personat me nevoja të veçanta u ndryshua Ligji për Mbrojtje Sociale. U hapën njësi të vogla banesore shtesë në shoqata lokale për personat me nevoja të veçanta, si pjesë e shërbimeve të mbrojtjes sociale, me çka numri i përgjithshëm arriti në 14 ..

Megjithatë, kapaciteti administrativ i komunave mbetet i pamjaftueshëm për të marrë përgjegjësitë e nevojshme të politikës sociale. Integrimi social i personave me nevoja të veçanta mbetet i kufizuar. Konventa e KB për të drejtat e personave me nevoja të veçanta ende nuk është ratifikuar.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e politikës për antidiskriminim. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi u bë operativ dhe filloi të veprojë me ankesat e dorëzuara. Pjesa më e madhe nga ankesat ishin të bëra në bazë politike dhe etnike. Megjithatë, Ligji për antidiskriminim ende nuk është në tërësi i harmonizuar me *acquis-it*. Është lëshuar diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Gjithashtu, duhet të përforcohet kapaciteti financiar, administrativ dhe kapaciteti teknik i Komisionit.

Në lidhje me të drejtat e pronësisë, regjistri i tokës mbulon 99,5% e nga territori i vendit, duke lënë të papërfshira zona të vogla në Shkup, Gostivar dhe Kriva Pallankë. Zyra e Regjistrimit të tokës organizon disa fushata për të forcuar vetëdijen publike dhe vazhdoi me organizimin e rregullt të ditëve të hapura për publikun. E-kadastrit për herë të parë u provua në Shkup, Negotinë dhe Kavadarë. Vendi u bashkangjit në Sistemin Evropian për përcaktimin e pozicionit (EUPOC) Megjithatë, procesi i kthimit të pronës së konfiskuar gjatë periudhës së Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë vazhdon të zgjerohet ndjeshëm përtej kufijve ligjorë. Cenimi i të drejtave të pronësisë të lidhura vetëm me procesin e denacionalizimit arrijnë 32% të peticioneve të parashtruara te Avokati i Popullit.

Zbatimi i kërkesave për zhdëmtim për të cilat është miratuar vendim përfundimtar mbetet i pakënaqshëm. Procedurat për kontestet e mbetura juridike edhe më tej krijojnë prolongim. Përsëri nuk është arritur përparim për kthimin e pronave të bashkësive fetare.

U arrit përparim i vogël në lidhje me respektimin e bashkësive pakicë dhe të drejtat kulturore. Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) është ende e domosdoshme për të siguruar vazhdimin e dialogut ndër-etnik dhe bashkëpunimin . Janë ndërmarrë hapa për të përmirësuar integrimin ndër-etnik në arsim. Është përmirësuar struktura për zbatim të Dekadës të Romëve. U arrit përparim që të sigurohet përfaqësimi i drejtë, veçanërisht në lidhje me bashkësitë e romëve dhe turqve. Megjithatë, administrata publike duhet të punësojë nëpunës shtetërorë më të kualifikuar dhe më me përvojë nga bashkësitë joshumicë në të gjithë sektorët dhe pozitat. Zbatimi i Strategjisë për Romët dhe planet e saj aksionale duhen të përforcohen dhe të financohen në mënyrë përkatëse

U arrit përparim në mbrojtjen e të dhënave. U miratuan ndryshime të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që të forcohet pozita e Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DBDHP) dhe për të përmirësuar zbatimin . Suksesi i (DBDHP) vazhdon të jetë i kënaqshëm dhe kapaciteti i saj është përforcuar me rritje të vogla të personelit. Dhe më tej sigurohen trajnime të shpeshta ndërsa ndërveprimin me institucionet tjera është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, ligji nuk ka referencë për çdo formë e ndërhyrjes gjyqësore. Këshilli ende nuk e ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave. Ndarja buxhetore e (DBDHP) është zvogëluar.

Nuk u arrit zhvillim i posaçëm në lidhje me të drejtat e qytetarëve të UE-së.

Konkluzion

Përparimi i caktuar dhe i kufizuar mund të vërehet në pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit, veçanërisht në ndryshimin e rolit të Ministrit të Drejtësisë, Këshillit gjyqësor dhe formimin e Gjykatës lartë administrative. Qëndroi i dobët në vlerësim dhe sigurinë e mandatit të gjyqtarëve. Përpjekje më të mëdha janë të nevojshme për të siguruar kompetencën brenda profesionit, veçanërisht nëpërmjet punës së AOSJO-së dhe zbatimin e kërkesave minimale më të rrepta për punësim. Pabarazia e të dhënave statistikore dhe analiza mbi gjykatat duhet të trajtohen si prioritet. U arrit përparim i caktuar në politikën e antikorrupsionit. Vazhdon harmonizimi i legjisllacionit dhe fillon rishikimi sistematik i listave anketuese nga KSHPK.

Megjithatë, zbatimi i kornizës ligjore të ndryshuar kohët e fundit nuk është plotësisht e angazhuar, mungon përmbledhja e konsoliduar dhe analizë statistikore, ende nuk është formuar evidenti i të dhënave mbi rastet e korrupsionit në nivele të larta, mbetet për të vendosur sistemin për kontrollin e deklaratave të konfliktit të interesave. SHPK duhet të jetë më proaktiv në referimin dhe ndjekjen e përparimit të rasteve të korrupsionit. Vendi shënoi përparim mesatar në sferën e të drejtave themelore. Duhet të bëhet shumë në përparimin e mëtejshëm dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Në sferën e shprehjes së lirë, frikësimi i gazetarëve, vetcenzura dhe frekuentimi i aktiviteteve të shpifjes dhe më tej janë lëndë brengosëse. U arrit përparim i caktuar në lidhje me të drejtat kulturore dhe bashkësive etnike. Marrëveshja Kornizë e Ohrit mbetet elementi i rëndësishëm për demokraci dhe qeverisjen e të drejtës në vend.

4.24. Kapitull 24: E Drejta, liria dhe siguria

U arrit përparim i caktuar në sferën e migrimit. Zbatimi i planit aksional 2009-2014 për politikë migruese vazhdon edhe përkrah disa prolongimeve të rëndësishme. Ligji për të huaj është ndryshuar për tu siguruar korniza juridike për vendosjen e bazës nacionale të të dhënave për të huaj, duke përfshirë të dhënat për azil, migrim dhe viza. Baza e të dhënave është funksionale dhe e lidhur me të gjithë institucionet të prekuara dhe trajnimi për shfrytëzuesit dhe administrator për bazat e të dhënave është përfunduar; megjithatë aktet nënligjore të nevojshme për përdorim dhe mirëmbajtje fillimisht duhen të

miratohen. Këmbimi i informatave dhe kordinimi i migrimit ilegal me vendet nga rajoni është forcuar. Në vitin 2010 u zbuluan mbi 1100 emigrantë ilegalë. Marrëveshja për readmision me vendet të UE vazhdon suksesshëm të zbatohet. Gjithashtu është nënshkruar marrëveshja për readmision me Srbinë.

Në vitin 2010, sipas marrëveshjes për readmision të UE-së dhe marrëveshjeve biraterale janë pranuar 839 persona. Buxheti dhe resurset njerëzore të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale janë ritur në mënyrë të parëndësishme. U miratua profili nacional për migrim për vitin 2010. Në këtë sferë vendi po përparon mirë.

U arrit përparim i kufizuar në sferën e azilit. U miratuan rregulla për përcaktimin e rolit të çdo institucioni në procesin e integritit të emigrantëve dhe të huajve, dhe me të cilët sigurohet emërimi i kujdestarëve ligjorë për persona të mitur pa shoqërues dhe persona të hendikepuar mental. Qendra për integrim, e cila i përgatit planet për integrim në familje të emigrantëve të njohur dhe persona nën mbrojtje supsiadiare, mbeti pjesërisht i financuar nga Qeveria nga fillimi i vitit 2011. Qeveria miratoi program për integrimin e personave me azil të ndarë duke përfshirë ndihmën për banim. Megjithatë, numri i familjeve të prekura në praktikë, mbeti pa përkrahje për banim disa muaj, që i detyrohet vonesës në zbatim. Në gjysmën e parë të vitit 2011 janë regjistruar 349 kërkesa për azil (në krahasim me 147 gjatë tërë vitit 2010). Në periudhën e njëjtë 418 parashtues të azilit janë vendosur në Qendrën e pranuar për azilkërkues në Vizbeg. Kërkuesit e azilit ende ballafaqohen me probleme gjatë qasjes te informatat për procedurat dhe të drejtat sociale. Nuk pa përparim në shpejtimin e procesit të sigurimit të dokumenteve personale për azilkërkuesit. Kërkuesit të azilit ende nuk kanë qasje për ndihmë juridike falas nga shteti. Mungon korniza juridike për sigurimin e qasjes te sigurimi shëndetësor publik i personave me azil të ndarë. Edhe pse kapaciteti administrativ i Seksionit për azil në Ministrinë e Punëve të Brendshme shënoi rritje të vogël, efikasiteti i saj në miratimin e vendimeve të shkallës së parë për azil nuk mund të konsiderohet i kënaqshëm dhe duhet të përmirësohet. Duhet të bëhen përpjekje të shqyrtohet si të parandalohet keqpërdorimi potencial i sistemit për azil. Edhe më tej ekzistojnë probleme gjatë sigurimit të interpretimit. Vendimet për ankesa nga Gjykata administrative vazhdojnë të miratohen në masë të madhe sipas procedurës së sa në baza thelbësore. Me formimin e Gjykatës së lartë administrative u vendos edhe një shkallë e zbutjes. Korniza institucioneve dhe juridike në masë të madhe funksionojnë, por zbatimi i legjislacionit dhe strategjive mbetet i pamjaftueshëm dhe janë të nevojshme përpjekje plotësuese. Në këtë sferë vendi është në fazë përparimtare.

U arrit përparim i caktuar në sferën e politikës së vizave. Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore në vend janë të lidhura me sistemin nacional të vizave N-VIS (N-VIS). Sistemi është i lidhur me bazën nacionale të të dhënave për të huaj. Qeveria miratoi vendim duke u lejuar vendeve të treta me Vizë të vlefshme të Shengenit të tipit (C), hyrje në vend pa viza. Harmonizimi me listat pozitive dhe negative të UE-së ende nuk është mbaruar në tërësi. Në këtë sferë vendi përparon mirë.

Liberalizimi i vizave për qytetarët të cilët udhëtojnë në zonën e Shengenit është ndarë me vlefshmëri prej 19 dhjetorit të vitit 2009. Rregullat për regjim pa viza respektohen nga shumica e udhëtarëve. Megjithatë, edhe krahas regjimit pa viza, ka rritje të numrit të kërkesave të pabaza për azil në disa vende-anëtare të UE-së. Pushtetet nacionale vendosën grup të masave që të veprojnë kundër kësaj dukurie duke përfshirë kampanjat publike informative me fokus të posaçëm në grupet e cenuara, të cilat në të vërtetë janë përfshirë, si dhe masa preventive si kontrolli i përforcuar i kufijve dhe profilimi. Janë në rrjedhë përpjekje për zgjidhjen e kësaj çështje. Me qëllim të sigurimit të zbatimit të përhershëm të obligimeve të ndërmarra, është vendosur mekanizëm për ndjekjen e liberalizimit të post- vizave. Komisioni e paraqiti raportin e vet të parë për ndjekje Parlamentit evropian dhe Këshillit në qershor të vitit 2011.

U arrit përparim i mirë në sferën e kufijve të jashtëm dhe Zonës së Shengenit. U miratua Ligj i ri për kontroll kufitar me qëllim të harmonizimit me të BE-së, posaçërisht Kodit për kufij të shengenit. Është hapur kontakt i përbashkët për bashkëpunim policor dhe doganor me Bullgarinë dhe janë nënshkruar protokolle për patrulla të përbashkëta kufitare me Bullgarinë, Serbinë dhe Kosovën. Bashkëpunimi i mirë me Fronteks vazhdon. U miratua Rregullore për zhvillim të analizave të rrezikut në sferën e kriminalitetit të organizuar tej kufitar dhe migracionit ilegal dhe janë zbatuar disa trajnime në sferën e analizës së rrezikut. Janë formuar dy njësi mobile në nivel qendror që të rritet efikasiteti në luftën kundër migracionit ilegal dhe kriminalitetit tej kufitar dhe përdorimit operativ të analizës së rrezikut. Është zhvilluar në mënyrë të rëndësishme trajnimi i policëve në teren, ndërsa U miratua programi për trajnim specifik të policëve në nivel të lartë dhe të mesëm që fillon të zbatohet. Është vendosur bazë

qendrore e të dhënave për dokumente të falsifikuara dhe origjinale dhe formularë për dokumente të udhëtimit e cila rregullisht azhurnohet. Në rrjedha është faza e dytë e zbatimit të sistemit radio-komunikues TETRA, i cili mbulon 40% të territorit të vendit. Policia kufitare ende nuk ka pajisje adekuate teknike dhe resurse buxhetore. Stacionet policore përgjegjëse për mbikëqyrjen e kufijve ende nuk kanë qasje në bazën qendrore të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në tërësi, kanë përparuar përgatitjet në sferën e kufijve të jashtëm dhe zonës Shengen.

Mund të vërehet përparim i mirë në sferën e bashkëpunimit gjyqësor në materien civile dhe penale. Marrëveshja për bashkëpunim gjyqësor me Euro drejtësinë (Eurojust) hyri në fuqi. Janë nënshkruar tri marrëveshje bilaterale me Kosovën për ndihmë të ndërsjellë juridike për çështje penale, ekstradimin dhe transferimin e personave të gjykuar. U miratua Ligji i ri për bashkëpunim ndërkombëtar në materie penale duke siguruar kornizë të gjerë juridike, por zbatimi i tij do të fillojë me zbatimin e Ligjit të ri për procedurë penale në nëntor të vitit 2012. Është zbatuar trajnimi për 54 gjykatës dhe 14 prokurorë për zbatimin e ligjit të ri. Kushtetuta është ndryshuar me qëllim që të mundësohet lidhjen e marrëveshjeve për ekstradim në harmonizim të mëtejme me marrëveshjet ndërkombëtare. Ministria e drejtësisë përpunoi 752 kërkesa në materien penale dhe 2316 kërkesa në materien civile. Bashkëpunimi me Euro drejtësinë është i mirë. Dërgimi i nëpunësit për kontakt në Euro drejtësi në mënyrë plotësuese do ta rrisë bashkëpunimin. Në këtë sferë vendi është në fazë relativisht avancuese.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar. Është formuar seksion ndërkombëtar për koordinim të zbatimit të ligjeve përgjegjës për shkëmbimin e informatave policore dhe zbuluese (IS) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Janë dhënë 103 fletarreste në vend në vitin 2010. Ka bashkëpunim aktiv rajonal dhe ndërkombëtar për zbatimin e ligjeve ekskluzivisht edhe nëpërmjet kanalit të Interpolit. Gjithashtu, bashkëpunimi nëpërmjet personave për kontakt me Europolin është i mirë. Konkluzioni nga marrëveshja operative me Europolin në mënyrë të rëndësishme do ta lehtësojë shkëmbimin e të dhënave analitike me qëllim të përmirësimit të luftës kundër kriminalitetit të organizuar dhe terrorizmit.

Akti për sistematizim të Byrosë për siguri publike vendosi përshkrim të vendeve të punës dhe strukturë të re organizative. Niveli i ri i formuar i Byrosë për siguri publike ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe të sigurojë qasje integruese për operacionet policore. Ministria e punëve të brendshme zbatoi proces për evaluimin e procesit të punës në nivel vjetor për herë të parë, si hap i parë në zbatimin e sistemit të shërbimeve dhe karrierë. Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale i Ministrisë për Punë të Brendshme kreu 33 kontrolle sipas dispozitave ligjore për kufizimin e aktiviteteve policore të nëpunësve në Ministri. Është formuar grup i punës me qëllim të zhvillimit të strategjisë për trajnim; por kjo ende nuk është bërë. Qendra për trajnim të policëve zbatoi trajnim avancues, në vazhdimësi dhe specifik.

Zbatimi i plotë i shemave të reja organizative në Sektorët rajonalë për punë të brendshme (SPB) është i penguar për shkak të mungesës së personelit. Ekzistojnë gjithashtu interesa për politizim të policëve dhe punëve të tyre duke përfshirë zbatimin e hetimeve. Janë paraqitur rreth 160 raste të punësimeve jo transparente në vende të nëpunësve në kundërshtim të Sektorëve për punë të brendshme, pa shpallje paraprake të vendeve të lira të punës. Ndryshimi i Ligjit për punë të brendshme krijoi mundësi për zvogëlimin e rrogave me ç'rast të punësuarit në Ministri janë sistemuar në vende më të ulëta të punës si rezultat i ndryshimeve në organizim që mund ta dobësojnë stabilitetin e punësimit në kuadër të organizimit të policisë. Fakti se Qendra për trajnim nuk ka buxhet të posaçëm në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme e kufizon kapacitetin për planifikim në terren dhe strategjik të trajnimit.

Akti i sistematizimit, gjithashtu, solli ndryshime në Seksionin për kriminalitet të organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmirësimin e funksionalitetit të vet dhe integritet në sistemin e zbulimit nacional dhe ndërkombëtar për hetime penale. Të gjitha shërbimet të cilët merren me kriminalitetin e organizuar tani bien në kuadër të Qendrës për eliminimin e kriminalitetit të organizuar dhe serioz, i cili i përfshin bazën nacionale për të dhëna të zbulimit dhe qendra nacionale për koordinim përgjegjës për planifikim strategjik dhe grumbullimin e informatave zbuluese. Megjithatë, U arrit përparim i kufizuar në lidhje me personelin në Qendrën për eliminim të kriminalitetit të organizuar dhe serioz, ndërsa vetëm rreth 64% nga numri i përgjithshëm i vendeve të punës në shëmën e organizuar janë të plotësuara, me çka pengohet efikasiteti i tyre. Baza nacionale për të dhëna zbuluese nuk do të jetë funksionale para fundit të vitit 2012 dhe për momentin është në fazën e tenderit. Qendra ndërkombëtare për koordinim, e cila mund ta përmirësojë shkëmbimin e informatave ndërmjet zbatimit të ligjeve, ende nuk është vendosur. Qeveria miratoi Strategji dhe Plan Aksional shoqëruar për krijimin e saj, megjithatë mungojnë shpërndarjet relevante buxhetore për shoqërim të këtyre instrumenteve.

U miratua Kodi i ri për procedurë penale që do të hyjë në fuqi në nëntor të vitit 2012. Qëllimi i tij është të përmirësohet efikasiteti i procedurave penale me përfundimin e rolit të prokurorit publik, me themelimin e policisë gjyqësore dhe përmirësimin e procedurave hetimore për krimin e organizuar të ndërlidhur dhe raste të korrupsionit.

Përfshirja e drejtpërdrejtë e Ministrisë për punë të brendshme gjatë lejimit të ndjekjes mbetet në fuqi dhe Ligji për ndjekjen e komunikacioneve fillimisht duhet të ndryshohet. Përveç kësaj, mbikëqyrja ekzistuese parlamentare mbi shfrytëzimin e urdhrave për ndjekje duhet të përfundohet. Zbatimi tejet restriktiv dhe i centralizuar i ndjekjes në mënyrë joadekuate i përket rritjes së kërcënimit nga krimi i organizuar. Drejtoria e Doganave dhe Policia Financiare nuk kanë kapacitet teknik për zbatimin e masave specifike hulumtuese. Numri i ndjekjeve në raste të kriminalitetit të organizuar është relativisht i ulët. Përgjithësisht, përdorimi i teknikave specifike të hulumtimit është ende i pamjaftueshëm dhe duhet të rritet, si dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare.

Në vitin 2010 shtatë herë është aktivizuar programi për mbrojtjen e dëshmitarëve. Seksioni për mbrojtjen e dëshmitarëve ende nuk ka pajisje adekuate. Nuk janë të mjaftueshme masat të cilët janë ndërmarrë për sigurimin e kompensimit viktimave të kimit të organizuar.

Probleme strukturore janë ende të dukshme në zbatimin e ligjeve në luftën kundër kimit të organizuar. Resurset njerëzore nuk janë të balancuara në mënyrë efektive në zbatimet e ndryshme të ligjeve. Ekziston tepriçë e nëpunësve policorë dhe doganorë të përqindje të caktuar e popullatës, derisa numri i gjykatësve hetues dhe gjykatësve nuk është i mjaftueshëm.

Kapacitetet analitike dhe administrative të Drejtorisë për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (DPLPFT) u rritën në raport me hetimin e kriminalitetit financiar. Pjesa më e madhe e rasteve të analizuara në periudhën e njoftimit ishin në lidhje me fshehjen e tatimit. Në periudhën e njoftimit, DPLPFT parashtrori 23 raporte për transaksione të dyshimta të lidhura me larjen e parave te organet hetuese dhe prokuroria dhe 95 raporte të lidhur me lloje tjera të kriminalitetit ekonomik dhe financiar. Bashkëpunimi ndërkombëtar me FIU në vende tjera vazhdon, me atë që DPLPFT pranoi 33 kërkesa dhe dorëzoi 79 kërkesa në vitin 2010. Deri tani 95 persona janë akuzuar për larjen e parave në vitin 2011 në krahasim me 10 persona në vitin 2010. Kualiteti i hetimeve për larjen e parave dhe kriminalitetit financiar ende duhet të përmirësohet.

U arrit përparim i caktuar në luftën kundër parandalimit të tregtisë ilegale me njerëz. Është hapur vendstrehim nacional i viktimave të tregtisë ilegale me kapacitet deri në 12 persona. Numri i viktimave të identifikuara të tregtisë ilegale me njerëz është 12 në vitin 2010, që paraqet rritje prej 8 persona nga viti paraprak. Në vitin 2010, 25 persona janë burgosur nën dyshimin për tregti ilegale me njerëz, në krahasim me 17 në vitin 2009, ndërsa 11 persona janë dënuar, rritje prej në zero në vitin 2009. Aktgjykimet lëvizin nga katër deri 8.5 vjet burg. Në mënyrë plotësuare duhet të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse, multidisiplinore dhe e centruar ndaj viktimave të tregtisë ilegale me njerëz. Përveç kësaj, duhet të përmirësohet identifikimi proaktiv i viktimave të tregtisë ilegale me njerëz prej vendeve tjera dhe në kuadër të vendit.

Vendi ka përparuar në sferën e bashkëpunimit policor dhe luftës kundër kimit të organizuar. Megjithatë, përpjekjet e trupave relevantë për zbatimin e ligjit (Ministria e Punëve të Brendshme, Avokati i Popullit, Drejtoria Doganore dhe Policia Financiare) për luftën kundër kimit të organizuar duhet të përfundohet. Në të njëjtën kohë, janë të nevojshme përpjekje të rëndësishme që të sigurohet zbatim i plotë i reformave të praktikës policore, si dhe të sigurohet vendosja e bazës nacionale për të dhëna zbuluese. Mbetet brengosje në lidhje me politizimin e policisë.

Mundet të shënohet përparim i caktuar në sferën e luftës kundër terrorizimit. Policia miraton qasje adekuate ndaj çështjeve për luftën kundër terrorizimit. Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral vazhdon. Bashkëpunimi me organet hetuese dhe prokurorinë dhe njësitë e huaja zbuluese është përmirësuar. Strategjia për luftën kundër terrorizmit (2012-21014) në lidhje me Strategjinë për luftën kundër terrorizmit të BE-së dhe Konventës Evropiane për parandalimin e terrorizmit të Këshillit së bashku me Planin Aksional adekuat, duhet fillimisht të miratohen. Në periudhën e njoftimit janë paraqitur pesë transaksione të dyshimta në lidhje me financimin e terrorizmit nga ana e Drejtorisë për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimin e Terrorizimit. Në tërësi, përgatitjet në këtë sferë janë përparuese.

Mund të vërehet përparim i vogël në raport me bashkëpunimin në sferën e drogës. Zbatimi i planit të ri aksionar të strategjisë nacionale për drogë i cili përfshin periudhën e vitit 2009-2012 është në rrjedhë, në pajtim me strategjinë për drogë të BE-së (2005-2012). Në vitin 2010, vlera e drogës së konfiskuar mbeti relativisht e ulët duke marrë parasysh lokacionin e vendit të marshutave kryesore të Ballkanit për tregti me drogë. Drejtoria Doganore nuk shënoi sukses të posaçëm në zbulimin e konfiskimit të narkotikëve në kufij. Kapaciteti i resurseve njerëzore të Seksionit për tregti të palejuar me drogë në Ministrinë e Punëve të Brendshme mbetet i pamjaftueshëm. Vendi në pjesën më të madhe i përmbush kërkesat.

Mund të vërehet përparim i mirë në sferën e bashkëpunimit doganor, Drejtoria Doganore merr pjesë në numër të madh të operacioneve ndërkombëtare për zbulimin e tregtisë ilegale. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave zbuluese me Drejtorinë Doganore të vendeve anëtare dhe më gjerë në rajon është ipërshpejtuar me qëllim të parandalimit dhe zbulimin e tregtisë ilegale dhe luftën kundër kriminalitetit tejkuftar. Informatat zbuluese rregullisht shkëmben me Shërbimin për iniciativë kooperative të Evropës Juglindore dhe Shërbimit për lidhje rajonale zbuluese. U nënshkrua marrëveshje për bashkëpunim doganor me Kosovën, memorandum për bashkëpunim me Doganën e Polonisë dhe u themelua kontakt qendror për polici dhe bashkëpunim doganor me Bullgarinë. Përgatitjet në këtë sferë janë në zhvillim.

Për luftën kundër falsifikimit të euros, shih Kreun 32- Kontrolli financiar.

Konkluzion

Mund të vërehet përparim i mirë në sferën e kufijve të jashtëm dhe bashkëpunimit në Zonën e Shengenit dhe bashkëpunimit doganor. Policia kufitare ende nuk ka pajisje adekuate teknike dhe mjete buxhetore. U arrit përparimi i caktuar në sferën e migracionit, politikës së vizave, bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar. Zbatimi i reformave në polici vazhdon. Në të njëjtën kohë, ende ekzistojnë probleme strukturore, mungesë të personelit dhe dispozitave buxhetore. Ende nuk është vendosur baza nacionale për të dhëna zbuluese. Zbatimi në sferën e azilit duhet në mënyrë të rëndësishme të përforcohet duke përfshirë edhe dispozitat për ndihmë juridike, interpretimit dhe qasjes për të drejtat sociale. Përgatitjet në sferën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë janë në rrugë të mirë.

4.25. Kreu 25: Shkenca dhe hulumtimi

Mund të vërehet përparim i vogël në sferën e politikës për hulumtim dhe inovacione. U miratua program për aktivitetet shkencore-hulumtuese, zhvillimit teknologjik dhe kulturës teknike për vitin 2011. Ende nuk është vendosur strategjia nacionale për aktivitet shkencor-hulumtues dhe zhvillimor 2011-2020. U zvogëluar buxheti për vitin 2011 për programin për hulumtim dhe zhvillim teknologjik në krahasim me nivelin nga viti 2010. Janë kufizuar mjetet financiare dhe mbeten të dobëta kapacitetet e institucioneve hulumtuese. Përgatitjet në këtë sferë janë relativisht të përparuara.

Përparim i mirë është bërë në pikëpamje të pjesëmarrjes së vendit në programet kornizë. Ka rritje dhe në numrin e kërkesave të parashtruara dhe në numrin e kërkesave të zgjedhura dhe në shumën e mjeteve të mara, sipas Programit të shtatë kornizë të UE-së për hulumtim dhe zhvillim (PK7). Pjesëmarrja në energjetikë, TIK dhe temat për ambientin jetësor është e mirë; megjithatë, pjesëmarrja në aktivitetet "Marija Kiri" dhe përfshirja në MSP qëndrojnë në nivel shumë të ulët. U formua Komiteti i Përbashkët Hulumtues. Komiteti vërejt përparim sipas KP7, nga periudha e shoqërimit, kurse në mbledhjen e tij në shkurt, theksoi se janë të nevojshme hapa plotësues për tu rritur pjesëmarrja në KP7.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e integritimit në Sferën Evropiane Hulumtuese. Në miratimin e ndryshimeve të Ligjit për arsimin e lartë, 40% nga taksat shkollore investohen në hulumtim fundamental dhe të zbatuar dhe në modernizimin e infrastrukturës. Ishte furnizuar pajisje e caktuar për

universitetet dhe laboratoriet. Megjithatë investimi në hulumtim dhe nga sektori publik edhe nga ai privat, ngelin shumë pak (llogaritet në rreth 0,2% nga PVB në vitin 2010). Si plotësim, mungesa e të dhënave të besueshme statistikore e bën implementimin dhe ndjekjen rëndë. Përgatitjet në këtë sferë mesatarisht të përparura. Emërime janë bërë në më shumë trupa drejtues, duke përfshirë në Komitetin Evropian për Sferë Hulumtuese (KESH) DHE Forumi Strategjik për Bashkëpunim Ndërkombëtar (FSBN). Megjithatë, pjesëmarrja në mbledhjet e tyre është e parregullt, për shkak të mungesës së kapacitetit administrativ.

Konkluzion

Mund të vërehet përparim, në lidhje me standardet evropiane për hulumtim dhe inovacion. Ekziston pjesëmarrje e rritur në programet kornizë të UE-së. Ende nuk janë përgatitur strategjitë nacionale për aktivitetin shkencor, hulumtues dhe zhvillimor për politikën për inovacion. Investimet private dhe publike në sferën e hulumtimit janë të vogla. Duhet të forcohet kapaciteti administrativ për mbështetje të pjesëmarrjes në trupa drejtues të PK7 dhe KESH-së. Përgatitjet në sferën e shkencës dhe hulumtimit janë të pamjaftueshme.

4.26. Kreu 26: Arsimi dhe kultura

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e arsimit, trajnimit dhe rinisë.

U miratuan ndryshime të Ligjit për arsimin e lartë, fillor dhe të mesëm. U përcaktua sistemi i klasifikimit të universiteteve. Përparon implementimi i Procesit të Bolonjës në arsimin e lartë. U përcaktua sistemi i këshillimit të prindërve të nxënësve. U vendos mundësia e themelimit të shkollave ndërkombëtare publike me programe mësimore në gjuhë të huaja. Qeveria e miratoi Strategjinë për arsimim të integruar, e cila parashihet futjen e gjuhëve të bashkësive etnike si gjuhë mësimore. Shkolla fillore e dytë e integruar dygjuhësore, e financuar nga donatori, filloi me mësim në Strumicë. Këshilli për arsimim e të rriturve zhvilloi plan operativ për implementimin e strategjisë për arsimin e të rriturve. Vazhdojnë përpjekjet me qëllim të zhvillimit të kornizës nacionale për kualifikime. U bë funksional Qendra për Arsim Profesional. Vendi i përmirësoi rezultatet e veta në raport me lëshimin e parakohshëm të shkollës dhe në arrijtjen e arsimit të lartë, sfera ku ishin përcaktuar vlera referente në nivel të UE-së për vitin 2010.

Megjithatë, janë të nevojshëm hapa plotësues në lidhje me të gjitha vlerat referente të UE-së viti 2020 për arsim dhe shkencë, duke përfshirë edhe arsimin parashkollor dhe pjesëmarrjen e të rriturve në arsimin e përhershëm. Ngelin mjete të vogla të ndara për arsimimin. Ende ka dallime të mëdha rajonale në qasjen e arsimit, posaçërisht në nivel të arsimit parashkollor.

Mbetet sfida rritja e interaksionit ndërmjet anëtarëve të bashkësive etnike në shkolla, si dhe zvogëlimi i shkallës së lëshimit të parakohshëm të shkollës ndërmjet nxënësve romë. Duhet të shqyrtohet nevoja për siguri të trajnimit të strukturuar për mësim. U bënë përpjekje për rivendosje të masave përgatitore për programet "Mësim i përhershëm" dhe "Të rinjtë në aksion". Kuvendi i miratoi ndryshimet e Ligjit për formimin e Agjencisë Nacionale për Programe Evropiane Arsimore dhe Mobilitet, me çka ritet përgjegjësia e Agjencisë Nacionale. Megjithatë, përparimi i bërë nuk e arriti nivelin e kërkuar nga rregullat e UE -së dhe ngeli jo adekuat. Për këtë shkak, masat përgatitore edhe më tutje shtyhen. Në sferën e arsimit, trajnimit dhe rinisë, vendi pjesërisht i plotëson prioritetet e veta.

Ekziston përparim i caktuar në sferën e kulturës. Vendi qëndron edhe më tutje i kyçur në Programin për kulturë dhe Programin Evropian për qytetarët. U miratuan ndryshimet e Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. U ratifikua Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për vlerat e trashëgimisë kulturore për shoqërinë. Vendi mirë ka përparuar në sferën e kulturës.

Konkluzion

Ekziston përparim i caktuar në pikëpamje të Standardeve Evropiane në sferat e arsimit, trajnimit, të rinjve dhe kulturës. Janë bërë përpjekje reformuese në të gjitha nivelet e arsimit. Vendi e përmirësoi aktivitetin e vet në raport të Vlerave të përbashkëta referente për arsim dhe trajnim në vitin 2020, posaçërisht në sferat siç janë lëshimi i parakohshëm i shkollës dhe kryerja e arsimit të lartë. Megjithatë, Agjencia Nacionale për programet "Arsim i përhershëm" dhe "Të rinjtë në aksion", nuk e arriti nivelin e kërkuar nga UE-ja dhe për këtë shkak masat përgatitore ende janë prolonguar. Mbetet sfida rritja e interaksionit ndërmjet bashkësive etnike në arsim. Janë investuar mjete të rëndësishme në projekte kulturore dhe në renovimin dhe ndërtimin e ndërtesave shkollore; Megjithatë, investimet nuk bëhen njëjtë për të gjitha komunat në vend dhe nuk e pasqyrojnë përbërjen multi-etnike të vendit. Përgatitjet në sferën e arsimit, trajnimit, të rinjve dhe kulturës shënojnë përparim mesatar.

4.27. Kreu 27: Mjedisi jetësor

Në sferën e mjedisit jetësor, U arrit përparim i caktuar në sferën e legjislacionit horizontal. U ratifikua marrëveshje multilaterale ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për zbatimin e Konventës për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor në kontekst tejkufitar dhe Protokollin për lirimin e materieve të dëmshme dhe Regjistri për transfer. Transponomi i acquis vazhdoi me miratimin e legjislacionit të caktuar për zbatim. U përmirësuan kapaciteti administrativ për zbatimin e kërkesave për vlerësim të ndikimit ndaj mjedisit jetësor (VNMJ) dhe vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor (VSMJ), por dispozitat për konsultim të opinionit ende në mënyrë përkatëse nuk zbatohen. Përgatitjet në këtë sferë përparojnë.

Mund të vërehet përparim i caktuar në sferën e kualitetit të ajrit. Transponomi i acquis-it vazhdon me miratimin e ligjeve të caktuara për zbatim. U ratifikuan edhe tre protokolle të KDPZV-së.. U arrit përparim i caktuar në zhvillimin e sistemit për ndjekje të kualitetit të ajrit. Kapaciteti administrativ mbetet i pa mjaftueshëm në nivel qendror dhe lokal. Përgatitjet në këtë sferë janë mesatarisht të përparuara.

U arrit përparim i caktuar në sferën e menaxhimit me hedhurina. Sipas konsultimeve gjithëpërfshirëse, U miratua Ligji për menaxhim me bateri dhe akumulator dhe bateri dhe akumulator të hedhur . U miratuan ligje të caktuara për zbatim në sferën e planifikimit të menaxhimit me hedhurina, dhe në sferën e menaxhimit me paketim të hedhurinave. Vazhdon procesi për dhënien e koncesioneve për deponi rajonale për ruajtjen e hedhurinave të forta në katër regjione. Kapaciteti administrativ ende është i pamjaftueshëm në nivel qendror dhe lokal. Investimi në këtë sferë është larg nga e mjaftueshmja dhe duhet të rritet. Sistemi për grumbullimin e të dhënave, regjistrimi dhe paraqitja ende nuk është në fuqi. Përgatitjet në këtë sferë përparojnë ngadalë.

Mund të vërehet përparim i vogël në sferën e kualitetit të ajrit. Riorganizimi administrativ në këtë sektor është në rrjedha. Procesi i transponimit të acquis-it në këtë sferë nuk ka përparuar shumë. U miratua legjislacioni i caktuar për zbatim me qëllim të harmonizimit të mëtutjeshëm me direktivën për ujëra të zeza dhe direktiva kornizë për ujëra. Kapaciteti administrativ është ende i pamjaftueshëm në të gjitha nivelet. Mungesa e koordinimit të mjaftueshëm ndërmjet organeve kompetente në sektorin për ujëra e pengon zbatimin e legjislacionit. Është vërejtur përparim shumë i vogël në përkushtimin e vëmendjes mangësive të rëndësishme të sistemi për ndjekje të ujërave. Mbetet planifikimi dhe përgatitja e investimeve për infrastrukturën, kurse financimi është shumë i ulët, në krahasim me nevojat e sektorit. Nuk ka përparim në zbatimin e principit "ndotësi -pagan". Kjo krijon probleme për mirëmbajtjen e investimeve në këtë sektor. Ngelen përgatitjet në këtë sferë.

U arrit përparim i caktuar në sferën e mbrojtjes së natyrës. Procesi për transponimin e acquis-it lidhur me vendbanime natyrore dhe florën dhe faunën e egër vazhdoi me miratimin e ndryshimeve të Ligjit për mbrojtje të natyrës. U miratuan disa ligje për zbatim në këtë sferë. U arrit përparim i mirë në vendosjen e sistemit nacional për informim për biodiversitet. Mund të vërehet përparim i caktuar në zhvillimin dhe zbatimin e disa planeve për menaxhim me territore të mbrojtura, por ende mund të sigurohet financim i qëndrueshëm . Ende nuk janë kompletuar strategjia nacionale dhe plani aksional për mbrojtje të natyrës. Kapaciteti administrativ ende është i pamjaftueshëm, në nivel qendror dhe lokal. Palët e interesuara ende nuk janë përfshirë në mënyrë të mjaftueshme. Përgatitjet në këtë sferë kanë përparuar mesatarisht. Në fushën e pylltarisë, Programi për riprodhim të zgjeruar të pyjeve për vitin 2011 u miratua dhe filloi me zbatimin e tij.

U arrit përparim i vogël në sferën e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimi me rreziqe. Procesi i transponimit të acquis-it vazhdoi me miratimin e ligjeve të caktuara për zbatim. Megjithatë , harmonizimi i plotë vazhdon të paraqes sfidë të rëndësishme për vendin. Procesi nuk lejon në masë të madhe të mbetet pas. Kërkesat për konsultim të opinionit në lidhje me sistemin për lëshimin e lejeve për PIKN nuk zbatohen çdoherë në mënyrë të drejtë. Kapacitetet administrative duhet në mënyrë të rëndësishme të forcohen, posaçërisht për aktivitetet e provave. Përgatitjet në këtë sferë janë ngadalshme.

